

STUBLLA

MONOGRAFI



2005

STUBLLA

MONOGRAFI

Editor
Don Fatmir Koliqi

Zyra Famullitare e shën Jozefit – Stubëll
2005

Lektor

Prof. Prend Buzhala

Botues

Zyra Famullitare e shën Jozefit – Stubëll

**Monografia botohet nën kujdesin dhe
përkrahjen e meshtarëve të Stubllës**

Përmbajtja

Parathënie (*Don Fatmir Koliqi*)

I. Historiku i Stubllës

1. Historiku (*F.K.*)
2. Martirët - dëshmitarë të fesë dhe të kombit (1846-1848) (*F. K.*)
3. Origjina e toponimit Stubëll (*Prof. dr. Shefki Sejdiu*)

II. (Mikro)toponomia dhe gjeografia (*Qeshk Ukaj*)

III. Arsimi në Stubëll

1. Stublla me shkollën e parë legale shqipe në Kosovë (1905) (*Prof. Isak Ahmeti*)
2. Manifestimi shkencor e multikulturor “Takimet e Don Mikel Tarabulluzit” (*Prof. Sarë Gjergji*)

IV. Famullia e shën Jozefit (*Don Rrok Gjonlleshaj*)

V. Sociokultura stubllase

1. Zhvillimi shoqërisë stubllase dikur dhe sot (*Dr. don Lush Gjergji*)
2. Penat e Stubllës (*Ndue Ukaj*)
3. Tiparet e etnografike të Stubllës (*Prof. Dr. Drita Halimi – Statovci*)
4. Arkitektura dhe mjeshhtëritë (*Pjetër Gjoni*)

VI. Thirrjet shenjte në Stubëll (*Mr. don Agim Qerkini*)

VII. Stubllasit në mërgatë (*Albert Ramaj dhe Zef Ahmeti*)

PARATHËNIE

Pas sa e sa shkrimesh në shqip e në gjuhë të huaja, nga aspekte të ndryshme të kulturës, arsimit e të historisë, të paraqitura në pëlhura të ndryshme: në libra, buletine, revista, gazeta, simpoziume e tribuna; tani është koha e volitshme që lexuesit ta kenë në dorë përmbledhtas një monografi për Stubllën. Kjo është monografia e parë që ka për qëllim një paraqitje panaromike e informative nga të gjitha sferat e kulturës dhe të jetës në përgjithësi për fshatin e Stubllës. Materiali që po ia dhurojmë lexuesit, është i zgjedhur, veçanërisht për miqtë e Stubllës. Në tërësi, monografia konceptohet nga një frymë respekti e admirimi, dashurie të lidhur hallkë-hallkë e që dëshiron të mos këputet kurrë. Prandaj, brenda materialeve do të gjindet thelbësorja e tërë kulturës së lashtë stubllase, historia e ditur dhe e dëshmuar mirë e kësaj ane, që nga shekulli pesëmbëdhjetë e deri në ditë tona. S'ka pretendime për të thënë çdo gjë për Stubllën dhe për rolin e saj, sepse kjo do të kërkonte vëllime të tëra dhe punë disavjeçare. S'ka dyshim, Stublla do ta meritonte një punë të tillë. Porse koha që po e krijojmë ne vetë, na e kufizon të bëjmë hapa të tjerë, më të përshtatshëm me kohën dhe hapsirën e sotme. Realiteti është ai që ne krijojmë dhe që na krijon. Njeriu i sotëm ka dëshirë të informohet shkurt dhe shpejt. Tek ata që lind dëshira dhe kureshtja për ta njohur më thellë e më gjerë Stubllën në lëmi të ndryshme, mund t'i gjejnë në libra të ndryshëm. E ata që ende nuk e njohin kulturën stubllase dhe jetën e saj, kjo monografi i ofron një paraqitje gjithëpërfshirëse për vendin dhe popullin e tij. Madje, për Stubllën dhe stubllasit nuk është lehtë të shkruhet, nga vetë fakti se për të ka shumë gjëra për të thënë. Mendoj se askush nuk do ta kuptojë Stubllën dhe banorët e saj vetëm nëpërmes librave, po nuk u takua me të (ta) drejtpërdrejtë, qoftë edhe një kohë të shkurtër. Ai që ka lindur në Stubëll, mban në peshën e jetës një histori të rrallë, të

ngulitur thellë në historinë e gjithëmbarshme kombëtare e të krishterë, një histori përplot „paradokse“ që ndeshen njëra me tjetrën në ecurinë e jetës së rëndomtë njerëzore. Vend i vogël bregor, e rrezatimin e tij s’mund t’ia ndalë askush! Tokë e egër, por plot ëmbëlsi e përbutësi! I fshehur mes kodrash e malesh, i „harruar“, e njëkohësisht oazë e pashterrur kulture e qëndrese heroike. Aty, vend i vogël për sa i përket pozitës gjeografike dhe popullatës, gjenden gjurmë të arsimit shekullor evropian, që datojnë në shek. 16; qëndresa dhe heroizmi i pashoq në mbrojtjen e vlerave të kulturës – kombëtare e fetare – përplot gjak e lot, rënie e ngritje, vdekje e ringjallje; Shkollën Shqipe zyrtare në Kosovë, kur shkronjat shqip në mbarë tokat tona kërcënoheshin e persekutoheshin; dhe kohën e fundit, reformat në kulturën e të jetuarit dhe të menduarit. Stublla mban në vete pjesë të pashlyera që kanë qenë dhe mbetin si gjurmë të patejkalueshme për qenësimin e trojeve tona. Kjo të bën të habitësh; si është e mundur që popullata e këtij fshati të shndërrohet në fortesë qëndrese e kujtese, dëshmitare të kohërave të egra, të vërsulura në qenien e stërlashtë të Gadishullit Ballaknik. Përgjigja, pa mëdyshje, do të gjindet në thellësitë e shpirtit të qenies stubllase, që me shekuj ka kultivuar krishterimin, përshpirtërinë e tij dhe vlerat morale ungjillore. Sakrifica e vazhdueshme, e përjetuar dhe e dëshmuar – në këtë vend dhe rreth tij – janë shenja të të krishterëve dhe të shqiptarëve.

Përveç rëndësisë historike-kulturore dhe të krishtera, Stublla është vend shumë piktoresk dhe i ndërtuar me përkushtim. Vizitorët e shumtë s’ngurrojnë ta emërojnë me llojlloj emrash, cilësi kjo që e gjejmë vetëm në vendet me kulturë të lashtë evropiane. Ajo është si Gjirokastra (thonë miq nga Shqipëria), mu duk se hyra në një vend të bukur të Zvicrrës (thonë shumë kosovarë), Stublla është krejt e veçantë në Kosovës (thanë trupat e KFOR-it), - janë këto reagime krejt spontane të vizitorëve të nderuar të Stubllës.

Në fund, dua të falenderoj të gjithë bashkëpunorët e mi në përpilimin e kësaj monografie. Në rend të parë i falenderoj autorët e shkrimeve, që me përkushtim e dashuri kanë paraqitur dijet e tyre për Stubllën, të vështruara nga aspekte të ndryshme. Po ashtu falënderoj dhuruesit e fotografive, pa të cilat gjithë materiali do të mbetej i thatë. Bashkëpunimi i mirë, shpresojmë, të ketë krijuar punë të mirë.

Don Fatmir Koliqi





I

STUBLLA
HISTORIKU I STUBLLËS

I Historiku i Stubllës

I. HISTORIKU

Stublla është njëra ndër fshatrat më të mëdha, e vendosur në rrafshnaltat e harkut të Maleve të Karadakut. Për Stubllën dhe rolin e saj në shumë fusha, si në aspektin e arsimit-shkollimit, si në ruajtjen e kombësisë në ato vise, si në qëndresën e saj përballë hordhive historike të vërsulura në këtë popullatë, dhe, së fundi, edhe për ruajtjen e krishtëritimit, është shkruar shumë edhe nga historianët shqiptarë edhe nga të huaj. Ata përherë Stubllën e përmendin me respekt e admirim të jashtëzakonshëm, kur kemi parasysh një vend të vogël e kodrinoro-malor të kësaj hapësire.

Stubllën për herë të parë e hasim të përmendet në vitin 1477. Në të vërtetë, në një hartë topografike të Shkupit, përmendet fshati Caravajka në verilindje të Stubllës (Khs. Monumenta Turcica 2/1. Sarajevo 1972, fq. 1279). Stublla u muar si vend orientimi për Caravajkën, e cila ende ekziston në verilindje të Stubllës. Pra, Stublla ishte vend me rëndësi dhe i njohur nga të gjithë. Pastaj, po në të njëjtin vit përmendet Stublla në rrethin e Moravës (Ibidem, fq. 130, 158).

Fshati i Stubllës në të kaluarën është i përmendur më së tepërmi në raport me arsimin apo hapjen e shkollave shqipe në Kosovë. Këtë të vërtetë



*Panoramë e Stubllës
(1970)*

historike na e lanë të shkruar disa misionarë katolikë në relacionet e tyre që ia dërgonin Selisë së Shenjtë në Vatikan – Romë. Stublla, theksohet në ato relacione, si vend kodrinoro-malor dhe larg qyteteve, ishte vend i përshtatshëm për hapjen e shkollës shqipe në ilegalitet dhe i mbrojtur, sepse atje vështirë depërtonin osmanët. Prandaj, s'është për t'u habitur nga fakti se shumë historianë gjurmues të atdheut, konsiderojnë se në atë kohë (circa 1584) Stublla kishte edhe një shkollë të lartë teologjike ose më së paku një konvikt për studentë „In forma cholleghi“ (Khs. G. Gjini, Ipeshkvia Shkup-Prizren nëpër shekuj, Drita, Ferizaj 1992; J. Rexhepagiqi, Zhvillimi i arsimit dhe i sistemit shkollor të kombësisë shqiptare në territorin e Jugosllavisë së sotme deri në vitin 1918, Prishtinë 1970). Në favor të kësaj të dhëne, na flet edhe ekzistimi i kishës kushtuar shën Lukës ungjilltar në varrezat e sotme të fshatit. Për këtë flasin edhe disa gërmadha dhe njashtu edhe tradita e gjallë në popull.

Edhe topografia ndihmon në këtë drejtim, se, përbri kishës së shën Lukës (ngjitas me varreza), një livadh i lënë quhet „Arakishës“. Kjo do të thotë se ekziston „aty për bri“ një kishë mjaft e madhe me pasuritë e veta të mëdha të palëkundshme. Gjithashtu edhe varrezat e sotme quhen „Varrezat te ara e kishës“, kurse varrezat e vjetra quhen „varrezat e Demajve“, ku doherësh i varrosnin vetëm laramanët e Stubllës.



*Vërreztat e Stubllës
sot. Në këtë vend
supozohet se ka qenë
Kisha e shën Lukës
dhe një shkollë e lartë
teologjike (rreth vitit
1584).*

torike, sikur edhe për disa fshatra rreth Stubllës, janë të mangëta për një pasqyrim të konsiderueshëm të këtij rajoni që nga fillimi i ekzistimit të saj e deri sot. Ne nuk do të futemi për të gjetur shkaqet e mungesës së dokumenteve, por do të mundohemi me atë çfarë posedojmë të ndriçojmë për Stubllën si vend tanimë të njohur, jo vetëm në Kosovë por edhe në trevat mbarëshiptare.

Edhe pse në kohët e më hershme, përkatësisht në shekujt e XV-XVIII, Stubllën e gjejmë vetëm se përmendet në dokumente të atëhershme si vend strategjik dhe të rëndësishëm; në shek. XIX e deri më sot, ajo (Stublla) do të jetë e pranishme më shumë se kurrë në rrjeshtat e historisë në këto troje të Karadakut dhe më gjërë.

E kemi fjalën për gjysmën e parë të shek. XIX, kur mbarë trojet tona shqiptare janë nën okupimin dhe administrimin e Perandorisë Otomane Tuke dhe në një proces të dhunshëm të konvertimit në fenë islame. Në këtë rrjedhë Stublla dhe disa fshatra përreth do të spikasin heroizëm të lartë kombëtar e fetar dhe qëndresë të vazhdueshme në ruajtjen e këtyre vlerave tejet të çmueshme. Po ashtu, shumë burra trima e bujarë dhanë shumë në lëvizjet kombëtare për çlirimin e trojeve tona nga Perandoria Osmane. Pa dyshim, një kontribut të madh do të kishin dhënë edhe në përgatitjen e Lëvizjes më të madhe shqiptare, në Lidhjen e Prizrenit. Gjithsesi, iu mbetet gjeneratave të reja që hulumtojnë e studiojnë edhe më për ngjarjet e këtyre viteve dhe rolin e Stubllës dhe stubllasve në këtë Lëvizje.

II, MARTIRËT E STUBLLËS – DËSHMITARË TË FESË DHE TË KOMBIT (1846-1848)

Periodha e martirëve të Stubllës konsiderohet koha më e lavdishme dhe në tërësi koha që më së tepërmi pse Stublla do të njihet në arenën jo vetëm kombëtare, por edhe në atë ndërkombëtare, si vatër e qëndresës, e flijimit dhe e sakrificës për vlerat e patjetërsueshme fetare e kombëtare. Tradita e shenjtë e shqiptarëve stubllas të trashiguar nga të parët shqiptarë katolikë, do të ruhet si sytë e ballit përballë çthurësve osmano-turq.



Pikturë, Jeroslav Čermak, "Të pëndjekurit shqiptarë në Anadoli" (1868)
(Justice Place, Bruxelles)

GJENDJA E SHQIPTARËVE KATOLIKË DHE TANZIMATI

Në fillimin e shek. XIX Perandoria Osmane feudale që me shekuj kishte pushtuar Gadishullin Ballkanik dhe trojet shqiptare, kishte filluar të përjetojë dekadencë të paparitur. Pashallarët bejlerë, administratorë në krahina të ndryshme ishin bërë si „vetë sulltani“ dhe sulltanin e konsideronin si „të sëmurin e Bosforit“. Porta e Lartë, me qendër në Stamboll, dërgonte vazhdimisht trupa shtesë për të nënshtruar pashallarët e saj në viset e Shqipërisë. Në vitin 1831 e mposhti edhe të mbramin – pashën e Shkodrës, dhe të gjithë i zëvendësoi me pashallarë të rinj që ishin besnikë, lojalë dhe servilë ndaj Sulltanit. Po ashtu, këto vite Porta e Lartë do të bëjë një ndarje të re administrative të këtyre trojeve, me të cilën nuk ishin të kënqur as muslimanët e aq më pak të krishterët, sepse represioni dhe përbuzja vazhdonin të jenë të pranishme. Për këtë shkak, në mbarë Perandorinë do të shpërthejnë kryengritje të të krishterëve për lirin nga haraçi i madh dhe nga represioni fetar anadollak (kryengritje të shumta që do të kurorëzoheshin me Lidhjen e Prizrenit). Pas sulltan Mahmutit, në vitet 1839-1861 do të vijë në fron sulltani Abdyl Mexhidi, i cili përpiqet ta rimëkëmbë Perandorinë, e cila kishte përjetuar sëmundje në themelet e saj. Veziri i madh, Mustafa Reshid Pasha, për të zbutur marrëdhëniet e acaruar me popullsinë e krishterë të Perandorisë, por edhe për t’iu shpëtuar ndërhyrjes së Ruisë, si dhe e nxitur nga Anglia dhe Franca, të cilat kërkojnë një Turqi më të konsoliduar, më „demokratike“, hartoi një projekt, sipas të cilit do të rregullohej jeta e Perandorisë.

Më 3 nëntor 1839 sulltan Mexhidi i shpalli në mënyrë solemne këto parime në formë të një dekreti, i cili mori emrin HATI-SHERIF I GJYLHANËS (Dekret i shenjtë i Gjylhanës). Ky dekret, që njihet me emrin turko-arab TANZIMAT (shq. = rend, rregull, reformë), hapi një periudhë të re të reformave në Perandori. Dekreti premonte garanci për jetën, nderin dhe besimin e të gjithë shtetasve pa dallim feje, organizimin e ushtrisë në bazë të rekrutimit të detyruar e të përgjithshëm, pa shpërblim. Po ashtu, garantohej liria fetare, që në praktikë këto liri e të drejta nuk respektoheshin, madje në mënyrë flagrante shkeleshin, si nëpër qytete ashtu edhe nëpër fshatra. (Khs. Troveyrlot, P. CM, „L’Histoire del Albanie“, Constantinopole 1884, dorëshkrim) Dekreti de facto nuk u zbatua kurrë, ai mbeti vetëm në letër si mbeturinë historike. Sepse klasa feudale turke (dhe jo turke, lex.

shqiptare të turqizuar/ islamizuar, nënvizimi F.K.) që ishte mësuar të jetë e privilegjuar kundrejt popullatës së krishterë, nuk pati as dëshirë të privohej nga ky komoditet. Dhe ndonëse në kodet e reja ishte hequr dënimi me vdekje për ata që e mohonin islamizmin, shkëputja nga feja zyrtare vazhdonte të dënohej shumë ashpër. Në këtë kohë po zbatoheshin reformat edhe në trojet shqiptare, d.m.th. kishte filluar të zbatoheshin Tanzimati, që ishte një plagë e re për popullatën e krishterë, sepse në dekretet të Hati-Sheerifin e Gjylhanës shpallej shërbimi ushtarak i detyruar, i a.q. NAZAMI (5 vjet shërbim ushtarak dhe 7 vjet shërbim si rezervë). Në rajonin e Gjilanit administrator i Portës së Lartë ishte Maliq Beg Gjinolli. Popullata e krishterë e këtyre viseve me vite kishte përjetuar nënçmim dhe përbuzje nga Maliq Beg Gjinolli dhe nga nënpunësit e tij. Shumica e tyre, nga dhuna e madhe, ishin detyruar të pranonin dukurinë e të krishterëve të fshehtë, kriptokatolikë, apo siç i quan populli larmanë, sepse nuk guxonin të



Prangat e të përndjekëve - martirëve

deklaroheshin publikisht se ishin katolikë. Publikisht njiheshin si myslimanë, duke përdorur edhe emra tuq, kurse fshehtas e mbanin fenë e të parëve, fenë katolike. E njëjta ngjante edhe në aspektin kombëtar. Me shpalljen e Tanzimitit popullata stubllase mori guximin që para beut të Gjilanit të deklarohen se janë shqiptarë katolikë. Me siguri ata i njihnin kodet e Tanzimatit që iu garanotnin shtetasve të Perandorisë lirinë fetare. Sipas këtij garancioni ata nuk do të dënoheshin me vdekje. Të organizuar nga Don Gaspër Krasniqi „organizator i vërtetë shqiptar kundër Turqvet“ dhe apostull i Karadakut me At Anton Marojeviqin, stubllasit, 25 kryefamiljarë në krye me Ndre Markun, shkuan në Gjilan dhe deklaruan se: „Jemi shqiptarë dhe katolikë, si të tillë duam të vdesim“. Beu i Gjilanit, Maliq Beg Gjinolli tentoi që me fjalë të buta, duke iu premtuar privilegjet


e mëdha që do t'i kenë, nëse do mbesin në fenë islame, me qëllim që t'i zbrapsë nga kjo deklaratë publike. Porse stubllasit, së bashku me bashkëkombasit e tyre nga Binça, Vërnakolla dhe Terzijajt, mbetën këmbëngultësisht të vendosur në atë që kishin thënë para tij. Kur beu pa se këta kryefamiljarë ishin të paluhatsëm në pohimet e tyre, e lajmëroi pashën në Shkup. Pasha i Shkupit urdhëroi që të arrestohen të gjithë. Stubllasit u arrestuan dhe i futën në burgjet e Shkupit, deri sa të mos vinte lajmi nga Sulltani që të gjithë të shpërnguleshin në viset e Mudanisë, përtej Bosforit. (Khs. Troveyrlot, P. CM, „L'Histoire del Albanie“, fq. 365.). Me pëlqim të pashallarëve e bejlerëve të Vilajetit të Kosovës, beu i Gjilanit kishte sjellë vendim që së pari këta 25 kryefamiljarë të dërgoheshin para Sulltanit në Stamboll, por edhe atje këta heronj shqiptarë u shpallën si katolikë. Mbas katër muajve në burgjet e Stambollit, sulltani i liroi, pasi tek ai ndërhyjnë fuqitë e mëdha evropiane. Njëpër Selanik e Manastir u kthyen në atheun e tyre. Me qenë se këta 25 kryefamiljarë u pranuan si katolikë nga vetë Sulltani, të tillë u shpallën në atdhe edhe shumë familje tjera. Përkundër kësaj, kryefamiljarët e Karadakut posa u kthyen në vendlindje, në atdhe, u gjetën në burgjet e Maliq Beg Gjinollit në Gjilan. E kjo ndodhi, pse kishin frikë se me pranimin e këtyre katolikëve, do të shpallen katolike gjithë Karadaku dhe Shqipëria. Këshilli i Kavasë në krye në krye me Maliq Begun, vendosën që këta të internohen në Azi të vogël.

MËGRIMI I DHUNSHËM NË ANADOLL – MUHALIQ (AZIA E VOGËL)

Vendimi i Këshillit të Kavasë u zbatua në tërësi. Sipas disa dokumenteve, Maliq Beu i Gjilanit i burgosi 25 burra të atyre familjeve. Të lidhur dhe me keqtrajtime të llojllojshme i dërgoi prej Gjilanit, njëpër Prishtinë, për në Shkup. Aty i futën në burg të ashpër dhe siç shkruan At Anton Marojeviq, famullitari i Malit të Zi të Shqipërisë (Monenegro di Albania), me datë 9 e 16 të muajit nëntor 1845, shkoi me ata dëshmorë që në ndonjë farë mënyre t'iu vinte në ndihmë. Disave u kishin lidhur cunga në këmbë dhe ashtu i detyronin ta fshinin qytetin; të tjerëve u kishin ndaluar ushqimin; u kishin mohuar deri edhe të drejtën e korrespondencës private si dhe të asaj zyrtare, pra, qoftë edhe ndonjë ankesë apo lutje me shkrim drejtuar pashës. (Khs. Haus – Hof U., Staatsarchiv, Wien. Administr. regist. 27/2, fq. 86-87).


Sipas gojdhënës dhe rrëfimit tradicional që ka mbetur në Stubëll, mërgimi

*Vërreza e martirëve
shqiptarë në
Muhaliq (Turqi)*



masiv me të rinj dhe të reja, fëmijë, pleq e plaka, ka ndodhë natën e Shën Kollit të vitit 1845 (05. XII), kurse sipas dokumenteve të gjetura, mërgimi i këtyre kryefamiljarëve ndodhi më 1 nëntor 1845. (Khs. Arkivi i Kongregatës, De Propaganda Fide, Acta , vëll. 212, fq. 366r). Sidoqoftë, më 1 shkurt 1846, të gjithë do të gjenden në burgjet e Selim Pashës në Shkup... njëri prej tyre kishte vdekur nga vuajtjet dhe nga sëmundjet e marra në ato burgje të ngushta, pa bukë e pa veshmbathje, ... vdekje që rrodhi për shkak se Akcili nuk desh të bëhet turk e ta mohojë fenë e Krishtit, vdekje që edhe në kohën tonë ringjall idenë e përlartësisë së martirizimit. Dëshmori i parë, i cili më 1 shkurt 1846 ra për fe e atdhe, se nuk desh të bëhej turk, quhet Andre Stublla, alias Augustini i Zefit nga Stublla, i cili, duke qenë i lidhur me pranga në këmbë, në qafë dhe në duar, dha shpirt në burgun e Shkupit.

Martirizimi i stubllasve nuk do të marrë fund në burgjet e Shkupit. Rruga e Kalvarit do të vazhdojë tutje drejt Manastirit për në Selanik, e mandej do të pasojë rruga e gjatë (nëpër det me anije) e mërgimit për në Azi, në Muhaliq. Gjithë ky rrugëtim ishte i stërmundimshëm dhe në kushte jonjerëzore. Dhe vendet, përkatësisht burgjet ku ata gjatë rrugës janë ndaluar, ishin në gjendje të mjerueshme, e shpesh herë edhe vdekjeprurëse. Bisedat e mërgimtarëve martirë, që i sollën shumë dokumente, janë shumë të dhimbshme, por edhe tejet heroike. Fjalët e tyre plot fe në Jezu Krishtin, jepnin shpresën dhe fuqinë e fundit, nëse jo më tepër, bile së paku t'i falin turturuesit për hirë të Dashurisë së kryqëzuar.



Kryqi përbetues i martirëve, me të cilin ata u kthyen në atdhe. Ky kryq është dhuratë e J.M.Hillereau-s dhe tani ruhet në Stubëll.

UDHA E KRYQIT NGA SELANIKU DERI NË MUHALIQ

Pas qëndrimit tri javësh në Selanik, erdhi urdhëri që të mos dërgoheshin në Stamboll, por të vendoseshin në vend tjetër në Anadoll. Në këtë mënyrë shqiptarët nuk kishin mundësi që të binin në kontakt me përfaqësuesit diplomatikë të fuqive evropiane; pra të tretej çdo gjurmë e tyre dhe të mbuloreshin ngjarjet, të mos iu dihet filli! Vendi i caktuar ishte Muhaliqi, qytezë në afërsi të Brusës, ku kishte shumë të krishterë të kombësisë armene. Rruga për në Muhaliq u bë me anije nëpër det. Nga qëndrimet disajavore nëpër burgjet e Shkupit dhe të Selanikut, dëshmorët shqiptarë ishin shumë të lodhur, kurse shumë prej tyre qenë sëmurë prej kushteve të jetës të papërshtatshme. Në këto burgje vdesin afër 50 dëshmorë.

Rruga nëpër det ishte një kalvar i vërtetë. Banorët e trojeve

të Karadakut dhe stubllasit që nuk kishin parë kurrë detin me sy dhe nuk e kishin përjetuar klimën detare, fituan sëmundje të pashërueshme. Disa të sëmurë edhe nga burgjet e mëparshme, nuk mundnin t'i rezistonin edhe kësaj torture. Të sëmurët u hodhën në det nga torturuesit e tyre. Po ashtu edhe shumë femijë u bënë ushqim peshqish. Udhëtimi nga Selaniku e deri në Mudania zgjati plot 16 ditë. Me të mbërrirë atje, njëmbëdhjetë të vdekur i hudhën në ndyrësirat e Mudania-s. Aty pranë, ku i hudhnin të

vdekurit, u gjet një shqiptar me emërin Mic. Ai është bërë një dëshmitar i gjallë i asaj ngjarjeje të tmerrshme. Mici i kishte përcjellur deri në Muhaliq me barkën e vet, kur e kuptoi se ata ishin shqiptarë të Kosovës. Sipas dëshmisë së tij, kuptojmë se Muhaliqi është një vend i rrethuar me kënetë dhe shqiptarët sëmuren rëndë, sepse ata janë mësuar të jetojnë në vende të thata e të shëndosha.

GJENDJA E MËRGIMTARËVE NË MUHALIQ

Gjendjen e mërgimtarëve dëshmorë të kombit dhe të fesë, na e dëshmojnë e tregojnë vetë ata, të cilët iu erdhën në ndihmë kur të gjithë i kishte kapluar agonia e vdekjes. I pari njeri që iu kishte ardhur në ndihmë martirëve tanë, ishte delegati apostolik imzot Jean – Marie Hillereau në Stamboll. Ky, i lajmëruar nga At Antoni dhe nga famullitari i Selanikut At Leonard Vakondio CM, shkon në vendin ku ndodheshin.

Nga dëshmia e tij mësojmë për gjendjen e mjerueshme të këtyre fatosave martirë të Stubllës dhe të fshatrava përreth të Karadakut. Vendi moçalor i Maliqit, sëmundjet e malarjes, të ftohtit e acartë, pickimi helmues i insekteve, i kishin shndërruar këta njerëz në një grumbull mizerjeje, rrallë të ketë ngjarë gjatë historisë së kishës shqiptare e madje edhe kishës së përgjithshme. Gjendje e mjerueshme që Hillereau nuk mund ta përshkruante me fjalë. Tek rrëfen Hillereau, në të njëjtën kohë ai edhe mrekullohet, mbasi në përshtypjen e parë vëren, kur gra e fëmijë, pleq e plaka, mezi e hapnin gojën, deklaruan që janë shqiptarë katolikë dhe si të tillë duan të vdesin dhe kërkuan sende devocioni, kryq e rruzare, sepse ishin të etur për



*Vári i dikurshtëm
i At Anton
Maroeviqit*



*Qelësi i varrezave
të të përndjekurve
shqiptarë në
Muhaliq*

gjësende shenjte. Kur iu dhuron një kryq, me buzët e çara e të etura e mbanin kryqin e Krishtit, duke qarë e ofsha. Në mesin e të gjallëve dëshmitarët takuan edhe të vdekur që i mbanin në kasollat e afërta. Ata vdekja i kishte marrë para disa ditësh. Nga numri 180, sa qenë nisur për në Muhaliq, tani kishin mbetur gjysmë të gjallë e gjysmë të vdekur 86. Hillereau këtyre të shtrirëve për vdekje, iu ndan sakramentit e vajimit, kurse të vdekurit i varros.

Dëshminë e gjallë At Hillereau ua dërgon konsullit të Francës z. Crépin dhe konsullit të Anglisë z. Sadiisson në seli në Brusë. Mandej këta konsuj u raportojnë ambasadorëve të tyre në Stamboll. Pas informatave të sigurta, z. Comt De Stürmer – ambasador i Austrisë, z. Lord Carming – ambasador i Anglisë, z. De Bourquency – ambasadori i Francës, dhe z. Wellesley, delegat i posaçëm dhe ministër fuqiplotë i Prusisë, shkojnë personalisht te ministri i Punëve të Jashtme të Portës së Lartë, për t’iu paraqitur zyrtarisht protestat e

tyre dhe rastin barbar. E shtërnguar nga fuqitë e mëdha evropiane, Porta e Lartë iu vjen në ndihmë shqiptarëve të rajonit të Karadakut në Muhaliq. Mbas kësaj ndërhyrjeje të fuqive evropiane, At Hillereau dhe At Antoni, së bashku me motrat e Shën Vinkit Paulit (Vinçencianët) nga Franca dhe Gjermania, iu ndihmuan shqiptarëve; ata që ishin të sëmurë të mjekohen, kurse për të vdekurit t’iu ndërtohet një varr i denjë, të cilin e meritonin martirët. Kryetari i asaj krahine e dhuroi një truall të vetin, pasi atë vend e kishin zgjedhur murgeshat vinçenciane, në të cilin mund t’i ngritnin varrezat. Pas përgatitjes së materialit ndërtimor, filluan ngritjen e murit të Varrezës. Mbi derë, në qendër të Kapelës, vendosën një kryq prej mermeri të bardhë, mbi të cilin e kanë shkruar epitafin, me fjalë të tilla, me të cilat duhej t’ua shpjegonin historinë e përmallshme gjeneratave të ardhshme. Ja epitafi: „MARTIRËT E BINÇËS DHE TË STUBLLËS. GJATË JETËS SË TYRE ISHIN ANALFABETË. PO, POR MIRË E KANË NJOHUR J. K. PËR KRISHTIN VDIQËN.“

Ceremonia e varrimit të këtyre shqiptarëve martirë ishte shumë e prekshme. Varrimi i tyre u bë ditën e të kremtes e Të Ngjiturit të Krishtit në Qiell, të vitit 1846. Kurse Kapela e Varrezave garantohej me një ferman, nga guvernatorët e vendit dhe obligoheshin edhe pasardhësit e tyre të kujdeseshin për këtë Kapelë – Varrezë, duke e marrë për detyrë që ta ruanin nga çdo rrënim. Dhe falë kësaj, Kapela është ruajtur deri në ditët tona.

TRANSFERIMI NË FILADORA DHE KTHIMI NË ATDHE

Të gjallët e mbetur në Muhaliq, i transferuan në Filadora, sepse rajoni i Muhaliqit ishte shumë i papërshtatshëm; vend moçalor dhe klima me-larrike, që po të qëndronin aty të gjithë do të vdisnin. Përsëri me ndërhyrjen e autoriteteve diplomatike të Perëndimit, autoritetet vendase anodol-lako-otomane, dhanë urdhër që shqiptarëve t'u gjendet një vend malor në rrethin e Brusës. Vendi i zgjedhur ishte Filadora. Këtë vend malor e zgjodhën për dy arsye: 1) sepse ishte në periferi të Brusës, ku ishin konsujt e Francës dhe Anglisë që të kujdesoheshin për ta, dhe 2) sepse ishte vend i ngjashëm për nga klima me vendlindjen e tyre.

Në Filadora shqiptarët kishin liri të plotë. Ndihmë iu dhanë edhe Qeveria Krahinore dhe nga ajo Qendrore Otomane. Në mesin e tyre e kishin edhe At Antonin, i cili ishte caktuar At shpirtëror i tyre në mërgim. Përkundër të gjitha këtyre „privilegjeve dhe përkujdesit“ mërgimtarët dëshironin në ktheheshin në atdhe.

Por Porta e Lartë nuk dëshironte t'i kthente në atdheun e tyre, në Karadak, por në Trikallë dhe Llarisë, në afërsi të Janinës. Por, mërgimtarët shqiptarë deklarorin: Ose të kthehem në atdhe, në trojet tona, ose të gjithëve na e prisni qafën, sepse më mirë është për ne të vdesim për Atdheun e Krishit, se sa të na transferoni në Trikallë e Llarisë.

Pas negociemeve të mundimshme, ambasadorit të Francës i kishte rënë në dorë, nga Sulltani, një ferman në të cilën thuhej: „Mërgimtarët shqiptarë me liri të plotë fetare dhe kombëtare, mund të kthehen në vendlindjen e tyre, ndërsa të gjitha dëmet do t'u shpërblehen!“ (Arkivi i Kongregatës De Propaganda Fide, SC. Albania, vëll 23.fq. 317-318). Sipas raporteve të të mërguarit At Anton Marojeviqit OFM, më 25 tetor 1848, numri i gjithëmbarshtëm i mërgimtarëve (syrgjynëve, kështu i quan populli) të mbetur gjallë dhe të përgatitur për eksod (kthim) nga dheu i mërgimit, arrinte në 86 veta, prej të cilëve në vendlindje arritën, më 20 nëntor 1848, vetëm 76 mërgimtarë bashkë me At Antonin.

MARTIRËT JANË KRENARIA JONË

Gjatë shtjellimit të lëndës që iu kushtua paraqitjes së mërgimtarëve të Stubllës, Binçës, Vernakollës dhe Terzijajve, përkatësisht Karadakut, i kemi quajtur ata dëshmorë dhe martirë, edhe pse ata ende nuk janë të shpallur zyrtarisht nga Kisha Katolike. Megjithatë, dëshmitë e fshatarëve pasardhës

të të përndjekurve i quajnë martirë. Por edhe raportet e (krye)ipeshkvive të Kishës Shkup – Prizren dhe letrat e famullitarëve të Famullive të Karadakut, posaçërisht të famullisë së Letnicës dhe Stubllës, shprehen decidivisht, se shqiptarët katolikë të këtyre fshatrave janë pasardhës të Martirëve të mërguar në Anadoll, në vitin 1846. Edhe kryeipeshkvi Dario Buccarelli shkroi „Mërgimi i shqiptarëve të Malit të Zi të Shkupit“, me qëllim që t’i dërgojë Kongregatës Propaganda Fide dhe t’iu propozojë fillimin e beatifikimit zyrtar të atyre që kishin vdekur gjatë persekutimeve dhe gjatë mërgimit. Të njëjtën gjë e ka pohuar edhe At Gjergj Fishta. Dëshmi të këtilla kemi gjatë gjithë kohës deri në ditët tona, nga (krye)ipeshkvijtë dhe nga meshtarë të famullive të këtyre trojeve. Kjo do të thotë që këta ipeshkëv e meshtarë, ngultësisht kanë besuar, se të përdsekutuarit e Karadakut janë martirë të kishës dhe të kombit. Edhe në ditët e sotme stubllasit i quajnë martirë të parët e tyre që kanë vdekur në Anadoll, apo që vdiqën të persekutuar gjatë rrugës nëpër Shkup, Selanik e deri në Muhaliq. Stubllasit me pietet dhe dashuri të madhe i përkujtojnë këta fatosë, që me jetën e tyre mbetën përmendore e gjallë e të ardhmes stubllase. Në 125-vjetorin e kthimit të të mërguarve në Stubëll, Famullia e Stubllës u përbetua, se do ta festojë dhe do ta përkujtojë Ditën e Martirëve. Dita e përkujtimit u caktua 18 marsi, nata e të krenatës së shën Jozefit, pajtorit të famullisë. Në rastin e këtij përkujtimi „in perpetuum rei memoria“ u shënua testamenti përkujtimor.

(Arikulli u përgatit nga editori. Materiali i tërë u muar nga: Dom Quidvultdeus GASHI, STUBLLA, në: DRITA, revistë fetaro-kulturore e Ipeshkvisë Shkup – Prizren, Viti X 2 (70) 1979, fq. 12-1 dhe 13; Gjergj Gjergji – GASHI, Martirët shqiptarë gjatë vitit 1846-1848, Drita, Ferizaj 1994.)

Në ëmen të Krishtit !



DËSHMI

Sot, ne besimtarët e Stubllës, tuj e ripërtri përkushtinë ndaj të parëve tonë MARTYRË, betohemi dhe bājmë kusht se në ditën sotit, natën e sh'Jozefit, për çdo vjet do të shtektojmë në Letnicë varri i dëshmitarit

Atë Anton MAROEVIQ-IT
dhe se në këtë ditë do të përkujtojmë dhe kremtojmë

FESTËN E DËSHMITARËVE TË STUBLLËS

qi dhanë jetën për Krishtin, të persekutuem prej turqvet dhe të iriternuem në Anadulli (Muhaliq) në vitin 1846 dhe të kthjem gjallë n' Atëdhë disa prej tyne në vitin 1848.

Besimtarët e Stubllës me famullitarin iau lāmë këtë dëshmi mbasardhësave të vet qi t'a përkujtojnë dhe kremtojnë këtë ditë përgjithmonë.


Besimtarët e Stubllës

Famullitari : Janez OSVALD

Dëshmitarët : Gjergj GJERGJI

Zef GERKINI

125 VJETORI I TË KTHYEMIT E
MARTYRËVE NË ATËDHË.



Stubëll, më 18 mars 1973

III. ORIGJINA E TOPONIMIT STUBËLL

Fshati Stubëll dhe Stubull (e Vitisë) dhe emri i tij kanë zgjuar kureshtjen time prej arsimtari dhe hulumtuesi, për dy arsye: e para, këtu mësuesi dhe kleriku Don Mikel Tarabulluzi hapi shkollën e parë shqipe në hapsirën kosovare, dhe tjetër është se si shenjë gjuhësore apo toponimi Stubëll (Stubull apo Stublla) shënon pesë fshatra që qenden brenda një hapësire relativisht të ngushtë të Dardanisë antike: 1) Stublla e Vitisë, 2) Stublla e Gjakovës, 3) Stublla e Medvegjës, 4) Stublla e Lebanës dhe 5) Stubllina e Gjilanit. Këtu më poshtë do të përqëndrohesh në toponimin Stublla e Vitisë.

Emri i këtij fshati, si evidencë ojkonomike del që në Defterin e vitit 1455 të Vuk Drashkoviqit, me forma Stuba dhe Stubol, kurse në vitin 1566, në Defterin e Sanxhakut të Vushtrrisë, del në formën Stubla.

Kureshtjen time hulumtuese e shtoi edhe „heshtja“ e etimologëve ballkanologë. Edhe vetë Skoku (kroat), romanist, sllavist e ballkanolog, etimolog autoritativ i hapsirës ballkanike, që shkroi shumë studime në fushë të onomastikës dhe autor i një fjalori etimologjik (katër tonësh) të gjuhës kroate, toponimin Stubla, sa di unë, nuk e ka trajtuar në mënyrë të veçantë. Megjithatë, në fjalorin etimologjik, te zëri stuba, që siç thotë ai, haset në Kosmet (emër i inponuar nga serbet për Kosovën – Kosovo i Metohija, vër. e editorit), përdorët në kuptim të „ljestva od deble, koje nije sasvim okresano, rozga, penjača“, por edhe „merdevine“, pra shkallë e levizëshme. Në të njëjtin vend, te zëri stubao, Skoku, për Risen të Malit të Zi, sjell edhe trajtat stubal dhe stublina, në kuptim „šuplje veliko drvo koje se meče u zemlju gdje voda izvire, pak se iz nje voda hvata“, pra është fjala për një trung të trashë e të gërryer, që mbanë ujin që buron nga gurra dhe ku bagëtia pi ujë. Aty jep edhe trajtën stumbol për trevën e Vareshit të Bosnës, në kuptim të „od dasaka sašita, u četvrto napravite polica poviše bunara“, që në Kosovë quhet rreth i bunarit. Këtu sjellë edhe toponimet Stubište te Valeva e Serbisë dhe Stubica e Kroacisë. Skoku në Fjalor, pranë këtyre trajtave mbi bazën stub-ve sjell edhe toponimin iliro-liburn Stolpona të transferuar në Stupin, toponim në Dalmaci. Po ashtu ai sjell edhe trajtën sllave të vjetër kishtare stublr „puteus“, për të cilën thotë se Mikloshiqi e konsideron „vocabulary obscurum“, që le të kuptohet se nuk është e sigurtë të jetë e origjinës sllave.

Pra, siç po shihet as te Skoku nuk u gjet sqarimi i etimologjisë së toponimit Stubëll apo Stublla.



*Panoramë.
Qendra e fshatit
(vitet e 70-ta)*

Siç thashë edhe më sipër, te Stubëll, Stublla unë shihja një struktur kontekstuale shumë komplekse, prandaj vazhdova hulumtimin e strukturave të ngjashme e të përafërta formale dhe semantike. Të REW-i i Mayer – Lübke-s u përqëndrova në më të ngjashmën formë të saj, te fjala latine STABULUM, gjerm. „Stail“, rum. „staul dhe staur“ (shtallë), ital. „Stab-bio“, frëngj. „éstable“, në kuptim të shtallë, fjalë kjo shqipe me proviniençë latino-romune. Kjo STABULUM që haset në leksikon baritor (stabulum ovium, stabulum boum, stabulum apium etj.), në kuptimin e shtallës haset edhe në rumunisht, madje edhe në irlandisht si, stabla dhe britonisht staul, etj.

Në DEL, SRABULUM është „endroit où on s’arrête“, pra vendqëndrim, si arkisemanturë që inkludon semantemat „etapë, ndalje, vendbanim, banesë, han“, por edhe „stallë apo ahur“ në leksikon rustik dhe baritor.

Mbi bazë të paradigmës formale të rrafshit sufiksial, këtyre evidencave, do të mund t’u afroreshin edhe toponimet Surdull, Konçul, Murgullë, madje edhe Magurë, që i hasim në hapsirën e Kosovës e më gjërë. Këtu mund t’i shtonim edhe toponimet Surdulica, Stublenica, Stubište, ku hetohet një dyfishim sufiksesh, njëri rumun e tjetri sllav.

Në të gjitha këto struktura formale (si të rrafshit të temës dhe të atij të sufiksit), qofshin ato iliro-dardane apo edhe iliro-liburne, latino-vllahe apo edhe sllave, nga aspekti zhvillomor fonetik, nuk do të mund të largohet as trajta stubula. Në rrafshin morfologjik e kategorial do të mund të rekonstruktohet një stubula, përkatësisht stubla (me rrugë asimilimi dhe



*Panoramë
e vjetër e fshatit*

pastaj sinkopjimi) nga një shumës (më vonë i singularizuar) i stubulum. Mirëpo, përkrye të gjitha këtyre posibiliteteve, dalin edhe vështirësi të tjera si në rrafsh të temës, gjithashtu në rrafsh të sufikseve, vështirësi dalin edhe në rrafshin referencial e onomastologjik. P. sh. format shqipe Stubëll apo Stublla (si trajtë e shquar) vetëm në Kosovë e afër saj shenjojnë pesë fshatra, ku edhe nuk përjashtohet mundësia, që temat e tyre të jenë në raporte homonimike, si rezultat i zhvillimit fonetik. Pra, vështirësitë gjithnjë mbeten të pranishme në rrafshin e brendshëm gjuhësor, përkatësisht tek format e formës dhe te format e përmbajtjes, andaj imponohet nevoja e hulumtimit dhe të rrethanave e faktorëve jashtëgjuhësorë, që për rastin tonë do të duhej kufizuar vetëm te rrethanat, që kanë motivuar krijimin dhe formësimin e toponimit Stubëll a Stublla, përkatësisht Stublla e Vitisë.

Shikuar nga aspekti kontekstual gjuhësor, përkatësisht të kodit, ky toponim mund të jetë origjinë iliro-dardane (për shkak të kontekstit hapsinor e etnik), iliro-romune, por edhe sllave (për të njëjtat arsye), edhe kontestet gjeo-morfologjike, kulturore e civilizuese çojnë kah bota referenciale që fshehet sidomos te trajta stubulum.

Kontestet civilizuese dhe kulturore të shprehur e të ruajtur në mikro-

toponiminë e fshtatit, si: Lagja katuni, Lagji e qeshmeve, Kroni i kalasë, Varrezat e Kishës, Kisha e shën Lukës, shtojnë shkallën e probabilitetit se etimoni primar i ojkonimit Stubëll gjendet në njërin nga bazat stubl – „puteus“, që Miklosiq e konsideronte „vocabulary obscurum“ apo te baza stalp – që haset edhe te toponimi iliro-liburn Stalpona, përkatësisht stopl, trajtë e greqizuar e të njëjtit toponim Stolpon.

Sipas mendimit tim, e në sajë të shumicës së faktorëve dhe rrethanave onomastologjike, etmonin primar duhet kërkuar te forma e shprehjes dhe forma e përmbajtjes së shenjës gjuhësore stabulum. Këtu mund të vijë në konsiderim edhe gërshëtimi i disa motiveve e cakteve emërtuese ku, shikuar nga aspekti semik, mund të vërehen edhe raporte interseksioni semik.

(Kjo pjesë është mbajtur si ligjeratë në manifestimin „Takimet e Don Mikelit“ në Stubëll (2001) dhe është botuar në Buletinin e të njëjtit manifestim.)





II

STUBLLA

(MIKRO)TOPONOMIA
DHE GJEOGRAFIA

II

(Mikro)toponomia dhe gjeografia

I. PËRKUFIZIMI TPONOMASTIK

Përkufizimin toponomastik të Stubllës do ta fillojmë nga pika lindore, me majën e Stubllavaqës, e cila, sipas ekspertëve të ekspeditave të ndryshme hulumtuese (minerale), që kohë pas kohe i bënin grupe të ndryshme nga vitet 1959-1969 e deri tani; kjo majë duhet t'i kalojë 1000 metra lartësi mbidetare. Në vazhdim, gjatë emërtimeve mikro – dhe mini të mikrotoponimeve të Stubllës, nuk do të ndjekim rradhitjen alfabetike, por do ta përshekruajmë përkufizimin e tyre. Në pikat përkufizuese të toponomastikës së Stubllës, e cila për çudi në disa vende me kilometra largohet, p. sh. nga pika Shtruzh – Lagjja e Qeshmeve – dhe pikërisht nga qeshmet e deri rrugës kah veriu – te kufiri me fshatin Goden i Vogël, nuk ka më shumë se 400 metra! E diku-diku hynë në thellësi të fshatrave tjera, Gërçar, Stançiq – sot kufi i dhunshëm serbomaqedonas, pastaj edhe më në thellësi, në disa fshatra tjera përreth. Për habi, pronarët e sotëm të Stubllës, të disa rajoneve, nuk e dinë lashtësinë e pronave të veta, si, bie fjala, arat te Kisha e Gërçarit dhe mullinjtë e dikurshëm të stubllasve që janë të lashtë, supozohet, të lashtë sa edhe vetë Stublla.

1. KUFIJTË TOPONOMASTIKË TË STUBLLËS

1.1. GASHTICA

Gashtica – veri – lindje është pika më lindore e Stubllës. Edhe pse është e ngjitur me Gashticën, është kodra e madhe që shkon më në lindje, por nga lagja fillestare: Shtruzh – Lagja e Qeshmeve – që merret si pikë e orientimit në këtë punim, shtrihet më në Jug. Gashtica ishte dikur mrizi kryesor i barinjve tanë e kjo dëshmohet edhe nga barinjte e vjetër stubllas. Gashtica është vend ku grumbullohen shumë përroje të kodrave dhe është lugaja më e madhe në lindje të fshatit tonë. Por ajo shënon edhe kufirin me Fushën e Madhe apo me Godenin e Madh.

Livadhi i Gjonit. Livadhi i Gjonit – i Hutës, kufiri vazhdon nga veriu. Në mes të Gashticës dhe Livadhit të Gjonit ka pak mikrotoponime.

Lugu i Grejzve. Del përtej Rogës (e madhe – e vogël). Rogat kanë shumë mikrotoponime, që „kryefjalë“ e kanë Rogën e Madhe, ku gjenden dy antena të PTT. Lugu i Grejzve përfundon te antenat.

Shpatet. Shpatet

janë përtej Lugut të Grejzve, mbi Gashticë e deri te antena e madhe.

Selishta. përfshin tokën përtej L. të Grejzve dhe përgjatë lugut të bregut të antenës së madhe, së bashku me shpatet.

Lugu i dardhës së butë. I takon Stubllës (ishte kullosë), por jo edhe pronë private. Në përdim të antenës është Lugu i Dardhës së Butë dhe nën antenën e madhe është antena e vogël, ku përgjatë rrugës, Stublla kufizohet me Kodrat e Zhegrës, për të mos shkuar deri te Kroji i shelnjës (këso



*Kroni i Struzhit
(i katunit)*

toponime kemi edhe në Stubëll), por për të dalë te Rrasat dhe te Lugu i Gjinocit. Nga Lugu i Gjonocit vazhdon deri te Kroj i Hajdarit.

Kroj i Hajdarit dhe Stubllavaqa e vogël njihen si të Godenve.

Çirica. Është 500 metra larg qeshmeve, mal i të dy fshatrave, Stubëll dhe Goden, pronë private, ndërsa godenasit në rrëzë të saj i kanë varrezat e veta.

Lugu i Buçecit (buçet, ushton, jehon). Është rrëzë Çiricës, afër lagjes godenase Mursylovyt. Shumica e këtij lugu është pronë e stubllasve. Aty dhe në breguncat e saja, janë zbuluar shumë varreza antike.

Nga Buçeci kalohet te Ara e Brahimit për të dalë te Përroi i Shillocit.

Arat e stubllasve shtrihen deri te kufijtë të Lagja e Therralive, për të dalur deri te Guri i Bardhë (Gjylekari), ku toponimi më i madh është Kodra e Beqës.

Ara e Gërçarit. Janë ato në mes të Kodrës së Beqës, Kalasë e deri te kisha e Gërçarit – prona shumëshekullore të stubllasve. Aty stubllasit kishin shumë mullinj, kurse arat, shumica e tyre, i posedojnë edhe sot, që deri tash askush nuk ua di lashtësinë.

1. 2. MULLINJTË – KUFIJTË MË TË DOKUMENTUAR HISTORIKISHT

Mulliri fillestar i stubllasve ishte ai në Gërçar. Pronar të tij ishte Lagja e Sedajve. Për një gjak serbët e grabitën këtë mulli. Më kënde, kah Stublla, radhiteshin varg e vij mullinj të stubllasve deri te rruga e Vërnakollës. Mulliri i përmendur quhej Mulliri i Vidhit (viti 1926).

Nga Gërçari e kah Stublla ishin këta mullinj: Mulliri i Beçarit, Mulliri i Gjonit (i gurit), Mulliri i Ukaj-Bekaj, Mulliri i Gjonit-Demaj-Prenkovyt, Mulliri i Godenëve. Pastaj vinte Mulliri i Tadorit, pra kënde Kalasë, Mulliri i Serafinit, aty ku kryqëzoheshin Lumi i Letnicës dhe përroi i Shillocit. Mandej vinte Mulliri i Gjemës – i Gjergjit Nocit, përballë përroit të Magjupit, Mulliri i Bacit Nue, afër te përroi i Pikonit, vazhdon Mulliri i Ballabanëve në udhëkryqin Viti, Letnicë, Stubëll, Mulliri i Puturëve dhe në qendër të Letnicës, Mulliri i Pashalisë. Pronat e stubllasve ndalen te Përroi i Babinocit, kah lindja dilet në Rrezinë, Rakoc, Petriq, te Kryqi, Lugu i Ahishtes së Avdytit, apo Djegësina e Vogël, dilet te Pusi i Drumit, kufijë me Vërnakollën. Mbas pusit dilet në Drumë ku vazhdon rruga për Kumanovë. Në të majtë nga lindja janë një varg mikrotoponimesh me emrin Resulë (ra Sula), gjatë rrugës për në Llokme, haset te Kryqi i Llokmës. Kufiri vazhdon deri te Guri i shpuar (afër Çelikeve, kthehet pastaj te fshati Vërrçevicë dhe zbresim në Gashticë rrëzë Kodrës së Madhe.

2. LAGJET E STUBLLËS

Stublla, për nga gjinia e gjakut, është fshat heterogjen. Degëzimet e lagjeve në Stubëll janë të nduarnduarta dhe lokacionet ku banojnë banorët e lagjeve të ndryshme janë të përziera - heterogjene, varësisht nga posedimi i pronave dhe

relievit., Për nga gjinia e gjakut lagjet e Stubllës kanë pasur ndryshime e degëzime të ndryshme. Kështu p.sh. një lagje degëzohet në nëndegë, ca shpërngulen e ca shuhen etj.

Përafërsisht mbi

70 % të popullatës stubllase janë të origjinës së lashtë. Popullata ka ruajtur pak lagje fillestare. E gjithë popullata i takon fisit Gash i Gurit (përeç një familje e fisit Berishë), janë shqiptarë dhe të gjithë katolikë.

Lagjet e Stubllës janë: Lagja RAMAJ, Lagja HY-SENAJ, Lagja ZEKAJ, Lagja ZENELAJ, Lagja SEDAJT, Lagja DEMAJ me mahallat e veta, Lagja e BALLABANËVE, lagja e KOLIQËVE, Lagja MUNISHI – PUTUR



Lagja Ballaban



Lagja Koliq



Lagja e Prenkovitëve



Lagja e Tomovitëve



Lagja Putur



Lagja Koizak

3. KUFIJTË DERI KU SHTRIHEN MIKROTOPONOMET DHE MASMIKROTOPONIMET

Mikrotoponomia e Stubllës shtrihet brenda këtyre kufijve toponomastikë: fillojmë nga veriu e rrotull kah Lindja: Godeni i Vogël, Kodrat e Zhegrës, Selishta, Godeni i Madh, Vërrçevica, Shurdhani, Pidiq, Çelik, Stanqiq, Vërrnez, Vërrnakollë, Lumica e Vërrnezit, Letnicë, Zagraxhë (lagje e Shoshares, Podgorc, Gërçar, Gjylekar, Therrali, Stublla e Poshtme dhe prapë Goden.

Regjistrimi i mikrotoponimeve po fillojmë me toponimin *Stubllavaqa*: Te Kryqi, Nën Kryq, Kalanicat, Rrasa e Madhe, Pehartë, Roga e Madhe, Roga e Vogël, Dardhat e Bacit Nue, Qershiat e Prenkit, Qershiat e Zekës, Vorri i Dom Nikollës, Qeshmet, Shtruzhi – Katuni, Kroni i Botës, Blini, Kroni i Rogës Drumit, Roga e Drumit, Podina, Shkozet, Bregu i Vogël, Lugu i Vogël, Lugu i Pirreve; nga *Qeshmet* kah veriu fillojnë Udha e Vogël, Udha e Madhe, Qershiat e Nocit, Gjolltë, Madeni, Lugu i Gjollëve, Bregu i Vogël, Bregu i Udhës Vogël – i Udhës Madhe, Ahishta, Lugu i Gjinocit, Livadhi i Gjinocit, Bregu i Lisit Sedës, Rrafshi i Kodres Gjylekarit, Udha e Kodrës Shkurt, Kroni i Kodrës Shkurt, vazhdon Udha e Kodrës Gatë, Bregu i Drenit, Lugu i Kodrës Gatë, Kroni i Kodrës Gatë, Kodra e Gatë, Rrezja e Kodrës Gatë, Lithija e Egër, Kroni i Lithisë Egër, Rrezja e Kodrës Gjylekarit, Udha e Hijeve. *Përgjatë udhës së Drumit*: Livadhi i Zefit, Bregu i Vogël, Djegësina e Madhe, Kroni i Kodrës Madhe, Rrafshi i Kodrës Madhe, Rrezja e Kodrës Madhe, Lugu i Drenit, Lugu i Madh, Livadhi i Bjaramit, Gashtica – Mizat. *Udhës Vogël nga Bregu i Lisit Sedës*: Udha, Bregu dhe Livadhi i Gjonit – Hutës, Tuma, Grejzit, Udha e Mrizeve – Gashticë. Po nga e filluam këtë përkufizim: Rogat, Antena e Madhe, Livadhi i Verdhë (Kodra e Zhegrës).



Nga Gjolltë: Udha e Gjinocit, Kroni i Balës, Lugi i Gjinocit, Rrasat, Lugu i Rrasave, Lugi i Dardhës But, Kroni dhe Pusi i Gjinocit, Stubllavaqa e Vogël, Pusi i Gjanë, Kroni i Hajdarit.

Shpatet, Kungulluri (Kumulluri), kufi me Selishtën dhe Fushën e Madhe (Godeni i Madhë).

Kisha e Vjetër, Hysenovyt, Kroni i Mrikës, Qërshiat e Koliqëve, Ara e kishës, Zabeli i Kishës, Varrezat e Reja (ku ishte shkolla e vjetër), Udha e Kumanovës, Bregu i Çarrit, Ahishta e Avdulit, Kodra e Llative, Pusi i Drumit, Vorri i Muhaxherrit, Zabelet e Stubllanve shtrihen shumica mbi Vërrnez e deri në Stanqiq. Mandej vijjnë:

Ballabantë, Koliqtë, Rrezja, Te Kryqi i Rakocit, Prroni i Kristës, Bregu i Çarrit, Djegësina e Vogël, Rakoci, Ara e Bacit Sebë, Rrafshi i Ahishtës, Livadhi i Haskit, Rrezina e Madhe, Livadhi i Prenkit, Babinoci, Rrushit i Palës Gapit, Livadhi i Gapit, Udha e Letnicës, Livadhi i Keq, Rrnica, Arat e Anres, Te Bunari, Udha e Katunit, Arat e Epra, Trolli, Udha e Drumit – Kumanovës.

Ara e Micit, Fusha, Bregu i Gjergjit, Shemet, Ara e Mates, Ara e Gatë, Glizet, Prroni i Glizeve, Kroni i Matës, Bregu i Varrëve, Vorret e Vjetra, Kisha e Re, Livadhi i Poshtëm – i Epër, Jaruga, Livadhi Zenelit, Prroni Palës Gapit, Arat e Puturëve, Putur, Çirica, Laura, Udha e Gjollëve.

Prroni i Tonit Jozës, Ara e Vogël, Ara e Martës, Arat nën Shpi, Buqeci, Livadhi i Palës Gapit, Shpati i Buqecit, Qershijat e Brahimit, Udha e Shillocit.

Lamtë, Lugi i Rogës Madhe, Kroni Dushkut, Kroni Therrave, Roga e Madhe, Ara e Shakut, Rrezet, Kryelisa, Rogëza, Koliba e Tonit Dodës, Rrafshi i Shillocit, Shilloci i Epër dhe i Poshtëm, Prroni i Shillocit, Arat e Brahimit, Lugi i Firit, Shpatë mbi Rekë, Arat përtej Prronit (të Shillocit), Guri i Gjylekarit, Kodra e Beqës, Arat në Gërçar, Kalaja, Përtej Reke, Shkozina, Ahishta, Prroi i Ahishtës (ka edhe shumë minimakrotoponime





Lugu i fjerit dhe Shpatmerek



Rakoci



Rogza

në këtë pjesë), Kujzak, Rrezja e Kujzakut, Kujzaku u Vogël, Zabeli i Kishës, Dejkoci, Prroni i Maxhupit. Ara e Rrënjëve, Birat (e ujkut, e vjedullës), Guri i Hutit (mesi i Kalasë), Vorri i Gjarprit.

Llokme – paralgje e Stubllës, kah lindja 5 km larg. (Emërtimet i tregoi Shin Idrizi – më 1994, ishte 41 vjeç): Kllaçet, Shullani, Roga e Leprit, Lugu i Mollës, Te Therrat, Livadhi i Nikollës, Kroni i Ahit, Kroni i Hajdukut, Te Lamtë, Lugu i Kllaçit, Dushqet, Vorret, Te Kryqi, Lugu i Hijes, Lugu i Madh, Blinishta, Serrishtë, Zabeli i Shullanit, Ara e Gjonit, Ku Ka Cofë Thiu, Kodra Cullak, Ara – Kodra e Llatinis, Kodra e Shkurt, Kodra e Kronit Hajdutit, Të Pusat e Smajlovyqve, Zabeli i Boshnjakut, Të Guri i Mixhës Sadri, Guri i Shpum, Ara e Gjorës, Kroni – Bregu, Ara dhe Baqja e Nikollës, Furra e Gatë, Vjosa, Bregu i Xhemishtës, Tuk Janë Vrat' Bjijtë e Canit, Te Mrizet (Çelik).

Emërtimet përtej Lumit të Letnicës i tregoi Palë Seferinë Toma (1994). Disa nga ato: Kalaja, Lugi Kalas, Kroni Kalas, Lugi i Shijakut, Kroni Lugit Shijakut, Rovina, Kroni, Shpati i Rogave, Shpati i Rogave, Udha e Rugave, Vija e Hollë, Rogat e Poshtme, Birat e Ujqërve, Rogat e Epra, Drumi i Zagraxhës, Mbi Kronin e Manës, Në Qafë, Rrafshina, Lugu i Madh, Te Rogat e Lugut Madh, Lugu i Rrafshinës, Tri Vijat, Udha Gjanë, Udha e Rogave, Bashqja e Mullitit, Udha e Plepave, Te Mullini i Jozës (Ballabanit), Lugi Rrasave, Kroni Rrasave, Te Kalanicat e Shinit, Te Kroni Manit, Shpati i Llative, Te

Vorret (sot Filteri i ujit), Te Birat e Thive, Guri i Gërçarit (sot Gurëthyesja), Udha e Maqinës etj.

4. INTERESANTE

Në Stubëll çdo toponim apo mikrotoponim ka edhe shpjegimin e vet – mbulesën e vet. Sa për ilustrim, po i marrim vetëm tre shembuj, përkatësisht mikrotoponime.

1. *Të Kryqi*. Aty me shekuj kanë qëndruar dhe vazhdojnë të qëndrojnë kryqat.

2. *Vorri i Muhaxherrit*. Gjendet te Pusi i Drumit. Për këtë flitet se ai njeri i panjohur kishte qenë diku larg ushtar dhe po kthehej nga lufta. Ai kishte menduar se është duke u kthyer në vendlindje. Kishte qenë shumë i lodhur. Barinjte stubllas i japin bukë dhe ujë dhe menjëherë ndërrojnë jetë. Varri është edhe sot në atë vend dhe stubllasit herë pas here e rregullojnë dhe lutën për shpirtin e tij.

3. *Glizet apo edhe Prroni i Glizeve*. Stubllasit në mendësinë e tyre e kanë ruajtur si simbol të së keqës, vend në të cilin shpesh u dëgjua zëri i Ikeqit, Djallit, dhe sa herë që ai bërtiste, në fshat ndodhnin tragjedi. Edhe sot kjo legjendë është e ruajtur në Stubëll. Kur dikush dëshiron ta etiketojë për të keq dikend, thotë: „Mos bërtit si me kanë i Glizeve“.

II. GJEOGRAFIA

Për ta paraqitur gjeografinë e një vendi, një rajoni, do të duhej punë paksa më e gjerë, një paraqitje me fakte e shifra nga të gjitha lëmitë që përbëjnë një vend. Kur e kreuva punën për Mikrotoponominë e Stubllës, atëherë nuk kisha mundësi të bëja edhe një paraqitje për gjeografinë e Stubllës. Me qenë se mikrotoponomia është interdisiplinë e gjeografisë dhe me kërkesë të editorit, këtu shkurtimisht po e paraqesim edhe portretin gjeografik të Stubllës, duke përfshirë elementet e shumtë që e mbajnë gjallë Stubllën këtu e një shekull më parë, e ndoshta edhe në të kaluarën e largët.

Gjeografinë e çdo vendi e përbëjnë katër elemente kryesore:

1. Natyra, 2. Popullsia, 3. Ekonomia, 4. Perspektiva – vizioni.

1. NATYRA

Natyrën e një vendi e përbëjnë disa elemente: relievi, klima, resurset natyrore dhe shtrirja gjeografike.

Stublla shtrihet në pikën ku kryqëzohen shkallët 42, 18 të gjerësisë gjeografike veriore me shkallën 21, 30 të gjatësisë gjeografike lindore, thënë ndryshe, në pikën më juglindore të Kosovës. Është pjesë përbërëse e maleve Rodope të Ballkanit. Relievi i Stubllës është kodrinor – malor dhe ka lartësi mbidetare nga 400 – 1000 metra te Stubllavaqa. Relievi është valor, ku ka lugina, përkatësisht fusha pjellore, ku rriten të gjitha bimët kryesore

si, gruri, misri, elbi, e pemë të shumta. Pjesët malore përbëhen prej gurëve gëlqerorë, që janë të njohur për ndërtimin e shtëpive (ndonëse një institut fqinj pohon se gurët kanë radioaktivitet). Luginat janë pjellore prej tokës humësore e deltinore.

Klima është e mesme kontinentale, d.m.th. që të katër stinët janë të shprehura. Kur Stublla veshet me lule e gjelbërime në muajtë prill dhe maj, natyra duket si parajsë e vërtetë. Stublla është e njohur për pemtari, si qershiat, mol-lat, dardhat, kumbullat, etj. Resurset natyrore të Stubllës janë të llojllojshme: toka pjellore, kullosat, pyjet dhe pasuritë nëntokësore. Në vitet e 60-ta nga Instituti i Londrës dhe nga ai i Beogradit, janë bërë hulumtime gjeodezike në këtë trevë dhe atëbotë kanë ardhur supozimet nëpërmjet organeve komunale të Vitisë së Bregu i Çarrit është krejt Uran dhe nëse kjo xeherore hapet, gjysma e Stubllës, pjesa e epërme, duhet të shpërngulet.

2. POPULLSIA

Në regjistrimin shtetëror të vitit 1981 (prill) Stublla kishte 2405 banorë dhe 205 familje (Statistički kalendar Jugoslavije 1983, Bograd, svibanj 1983, fq. 19. 36). Po e parafrazoj dorëshkrimin e Don Mikel Tarabulluzit të datës 5 shkurt 1905, që thotë se, Stubllasit janë të gjithë shqiptarë katolik dhe janë të fisit Gash.

Kur është themeluar Stublla si vendbanim, nuk kemi të dhëna të sakta. Dihet se lagjia amë është quajtur Çungur përkatësisht Ramaj. Përveç lagjeve Koliq, Ballaban dhe Putur, të gjitha lagjet tjera rrjedhin prej një barku, prej një nëne. Për shembull, lagjia Putur ka ardhur në Stubëll nga Vërrnakolla në vitin 1925, fshat afër Stubllës, që ishte krejtësisht me banorë shqiptarë. Këtë na e vërteton edhe Arkivi i Famullisë së Shën Jozefit – Stubëll.

Popullsia e Stubllës ka filluar të shpërngulet shekuj më parë; në Amerikë (gjatë kohës së Luftrave Ballkanike), mandej në Austri, Maqedoni, Kroaci, Slloveni, por edhe nëpër vende tjera brenda Kosovës. Gjithsesi duhet të përmendet edhe mërgata e 4 decenieve të fundit, e cila për shkaqe ekonomike e politike e ka lëshuar vendin dhe sot frymojnë anekënd botës, në SHBA, Kanada, Gjermani, Itali, Zvicërr, Austri etj.

Sot Stublla ka mbi 300 familje dhe mbi tre mijë banorë. Populli stubllas ka vetitë heroike dhe lirisdashëse, arsimdashëse. Stubllasit janë puntorë të paepur në çdo lami të jetës. Para së gjithash janë atdhetarë të flaktë; me djersën e vet Stubllën e kanë bërë të duket qytezë e bukur.

3. EKONOMIA

Në të kaluarën stubllasit kishin „ekonomi natyrore“, d.m.th. jetonin nga puna e duarve të veta dhe nga natyra, sidomos nga bujqësia e blegtoaria, por edhe nga pemëtaria. Vetë i prodhonin mjetet (veglat) e punës. Femrat, vajza e gra, punonin në vektari, të njohura jo vetëm brenda fshatit, por edhe më gjerë.

Qendra tregtare, me të cilat stubllasit bënin tregti, ishin: Presheva, Kumanova, Shkupi, Gjilani dhe Ferizaji. Stubllasit shitnin raki, pemë, vezë dhe prodhime tjera, po dhe bagëti (lopë, dhi e dikush edhe dele). Po ashtu stubllasit ishin edhe mjeshtrë të mirë; ndërtonin hambarët për drithë, e në veçanti dalloheshin në tërë rajonin e Karadakut dhe të Gjilanit për ndërtimtari.

4. PERSPEKTIVA – VIZION

Për nga pamja e jashtme Stublla i përngjan një qyteze. Ka plot shtëpia të reja dhe moderne. Të gjitha ish lagjet janë bërë gati si një, sepse me kalimin e kohës janë ndërtuar shumë shtëpi, që i kanë lidhë lagjet mes veti. Shumë vizitorë na nderojnë kur na thonë: „Stublla i përngjaka Gjirokastrës“. Gjithë kjo e arritur është fryt i djersës së vetë stubllasve: kisha, shkolla, rryma, asfaltimi i rrugës dhe ndërtime tjera moderne. Përkundër këtyre ndërtimeve dhe zhvillimit infrastrukturor, stubllasit e kanë ruajtur natyrën të paprishur. Sepse tek stubllasit është e ngulitur thellë vetëdija ekologjike dhe dashuria e theksuar për bukuritë e natyrës.

Stubllasit, kudo që jetojnë, duhet të bashkohen dhe të kontribuojnë për perspektivën e Stubllës, të vendlindjes së tyre. Perspektiva parësore dhe urgjente e Stubllës dhe stubllasve do të ishte rregullimi i ujësjellësit të fshatit. Pa ujësjellës Stublla nuk mund të zhvillojë jetë. Ujësjellësi do t'i japë gjallëri dhe gjelbërim të paparë këtij vendi piktoresk. Mandej, me perspektivë për këtë qendër të rëndësishme, do t'ishte ndërtimi i një poste, ngritja e rrjetit të telefonit kabëllor, si dhe mjetet tjera komunikuese, që do ta lehtësonin komunikimin më modern të stubllasve me botën e qytetëruar dhe me bashkëkombasit e vet nëpër botë.

Tomii Nout martinit
Kolicia
of ~~Tomii~~
Kaha: Makit

Muži Jonji
Luk:

Lefit

Markit

Molly Nr

Faint handwritten text in a cursive script, likely from a historical document. The text is mostly illegible due to fading and bleed-through from the reverse side of the page. Some words like "Hoc" and "Sancti" are partially visible.



STUBLLA

ARSIMI NĚ STUBĚLL

III

Arsimi në Stubëll

I. STUBLLA ME SHKOLLËN E PARË LEGALE SHQIPE NË KOSOVË (1905)

Shkolla shqipe e Stubllës ka një traditë pesëshekullore. Edhe atëherë kur persekutimi i arsimit shqip nga autoritetet osmane ishte ngritur në sistem, në Stubëll, fshat i Malësisë së Karadakut, që shfaqet me 1455 në një teftër osmano-turk, më 1584 fillon tradita e arsimit shqip, i pari dhe i vetmi rast atëherë në Kosovë, kur edhe kishte funksionuar Shkolla e parë shqipe. Kjo shkollë siç shkruan edhe studiuesi i njohur Dhimitër Shuteriqi, ishte në formë kolegji, i rangut të një instituti të lartë çfarë ishin zakonisht kolegjet fetare të asaj kohe në Evropë e ku, përveç teologjisë, mësohej edhe filozofia dhe studioheshin klasikët (Shih. Dh. Shuteriqi, Marin..., fq. 92).

Tradita e Shkollës Shqipe, e filluar pra që në vitet 1584 (shek. XV), do të vazhdojë të përforcohet dhe të pasurohet veçanërisht në periudhën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, kur në disa qendra më të njohura të Kosovës, si në Prizren, Pejë, Gjakovë, Zym, Janjevë dhe Stubëll, pranë Kishave Katolike, do të hapen dhe rihapen Shkolla Shqipe duke u bërë vatra të njëmendta jo vetëm të arsimit shqip, por edhe edhe të lëvizjes sonë kombëtare.

Edhe në vitin 1846, pra në kohën e persekutimit masiv të stubllasve për në Turqi, funksionon Shkolla Shqipe e Stubllës, për të cilën vetëm në Arki-



*Objekti i
shkollës së parë
shqipe*

vat Shtetërorë të Austrisë ekzistojnë mbi 6 000 (gjashtëmijë) dokumente, që tashmë konsiderohen të zbuluara dhe vetëm pjesërisht të studiuara. Ndonëse në kohën e këtij persekutimi dhe martirizimi (1846-1848), i bërë për shkaqe fetare dhe kombëtare: për Fe e Atdhe, ajo mbyllet, përsëri do të rihapet dhe do të funksionojë më 1872, 1888, 1891, 1896, kohë kjo, e frymëzuar edhe nga Lidhja e Prizrenit (1878), kur do të intensifikohen tendencat për çlirimin nga Turqia.

Ç'është e vërteta, Shkolla Shqipe e Stubllës, nga studiues dhe autorë të



*Objekti i
shkollës së parë
shqipe nga ana
tjetër*



*Busti i
Don Mikelit në
oborrin e kishës së
vjetër dhe të shkollës
së parë*

Don Mikel Tarabulluzin, pishtar i arsimit shqip në Kosovë. Ndonëse kjo shkollë ishte pengesë për pushtuesit, ajo vazhdoi punën e vet, ndërsa Don Mikeli, prift, mësues dhe patriot i dalluar, vazhdoi të jetë i përndjekur. Nga hulumtimet që janë bërë do të konstatohet në mënyrë më të plotë veprimtaria dhe vuajtjet e Don Mikel Tarabulluzit, e burgosjes dhe e persekutimit të tij. Megjithatë, duhet thënë se edhe deri në vitin 1924 ai ishte i përndjekur dhe për këto shkaqe kishte angazhuar të vëllanë, Jakë Tarabulluzin, me profesion mësues, që ta zëvendësonte në shkollë, por edhe që ta strehonte në Stubëll, sepse, si patriot që ishte, Jaku kishte marrë pjesë në Vlorë edhe në shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë (1912).

Dihet se shkollën katërklasëshe të Don Mikelit do ta kenë ndjekur disa gjenerata dhe se shkolla do të punojë, ndonëse me ndërprerje, deri në vitin 1924, mbase edhe më vonë. Sipas hulumtimeve që kemi bërë, të gjeneratës së parë kanë qenë: Toni Simonit, Lushi Sebës, Toni Ndout Martinit, Lluki Zefit Markut, Lushi Gjonit etj. Të gjeneratës së dytë ishin këta nxë-


ndryshëm shqiptarë dhe të huaj, përmendet në data të shumta, si 1880, 1888 (Shih. A. Nikić, Stanje na Kosovu..., fq. 21-22). Por ajo përmendet edhe më 1905, datë kjo shumë e rëndësishme, kur Imzot Pashk Trokshi themeloi Famullinë e Stubllës dhe famullitarin e atëhershëm të Famullisë së Letnicës, Don Mikel Tarabulluzin e emëroi famullitar në Stubëll, ndonëse veprimtarinë e tij të gjithanshme Don Mikeli do ta ketë zhvilluar në Stubëll dhe në gjithë Malësinë e Karadakut që nga viti 1896, kur qe emëruar nga Imzot Andre Logoreci, famullitar në Letnicë. Mirëpo, ç'është e vërteta, në fillim të shek. XX, po edhe më vonë shkolla shqipe kemi edhe në Gjakovë, Pejë, Stubëll, Ferizaj e Zllakuqan, ndërsa si shkollë e parë legale shqipe, dhe zyrtarisht e pranuar dhe e ndihmuar nga Austro-Hungaria dhe nga Imzot Pashk Trokshi, është ajo e Stubllës e vitit 1905, me mësuesin



*Portret i Don
Mikel Tarabulluzit*

nës: Jak Sedaj, Tade Ballabani, Mark Lorenci, Pal Koliqi, Gjon Andreu me shokë, kurse nxënës të mësuesit Jak Tarabulluzi ishin: Toni Kolecit (Ramaj), Gjergj Ramaj, Zefi Tomës Uka, Luzi Bozhës, Shini Ndout Uka, Agëja e Sebës Gjergji, Zinë Demaj, Tovi Tomës Sedaj, etj. Natyrisht, më të dalluarit prej tyre do të kenë qenë: Lorenc Koliqi dhe Zef Ramaj, që më vonë do t'i kryejnë studimet e larta për filozofi dhe teologji. Në këtë shkollë kanë mësuar edhe nxënës nga katundet e tjera të Malësisë së Karadakut. Kështu, për shembull, aty do të ketë mësuar edhe Gjergj Berisha nga Terzijajt, kurse sipas burimeve të shumta, del se Don Mikeli udhëtonte nëpër katundet e Malësisë së Karadakut, jo vetëm për t'i kryer punët pastorale, por edhe për t'i përhapur shkëndijat e arsimit shqip si dhe idetë e Rilindjes Kombëtare Shqiptare dhe për të kërkuar nga fshatarët që t'i dërgonin nxënësit në shkollë.

Duke u bazuar në dokumente dhe hulumtime del se nxënësit e shkollës së



Don Mikelit mësonin jo vetëm gjuhën shqipe, por edhe lëndët tjera si: matematikën, historinë, besimin katolik dhe muzikën, gjithashtu në gjuhën shqipe. Kuptohet vetvetiu se lënda e gjuhës shqipe përsëri ndahej në këndim (lexim) dhe bukurshkrim, kurse muzika ishte një prej lëndëve më të pëlqyera, sepse që në fillim të punës së shkollës u organizua jo vetëm kori i shkollës dhe i kishës, por edhe shoqëria kulturore për recitim dhe shfaqje teatrale.


Është me rëndësi të veçantë të theksohet edhe fakti se Don Mikeli përdorte në shkollën e tij disa libra



shkollorë, që edhe sot ruhen në Muzeun e Shkollës, Kisha e Vjetër kushtuar shën Gjergjit, që është shpallë monument i kulturës shqiptare me aktvendimin nr. 02-258, të datës 13. 06. 1978 nga Enti Krahinor për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës i KSAK në Prishtinë. Madje me urtinë e një strategu të provuar, ai kishte organizuar, nëpërmjet motrës së tij, Ages, virgjëreshë në Shkup dhe me ndihmën e Kate Cakolit me prejardhje nga Shkodra, furnizimin me tekste shkollorë nga Shqipëria. Kështu, sipas Prof. Jakë Mitës, në vitin 1923, një kontingjent librash kishte arritur nëpër Qafë Thanë, Strugë, Dibër – Stubëll, kurse më vonë edhe nëpër Selanik, Manastir, Shkup – Stubëll. Ndërsa furnizimi me li-

Librat e parë të nxënësve të shkollës shqipe në Stubëll

bra dhe tekste rridhte nëpër këto kanale, duket se andej nga mbarimi i vitit 1924, një kontingjent librash i ra në dorë policisë së Jugosllavisë së Vjetër. Dhe për këtë „shkelje“ të ligjit Don Mikeli u arrestua dhe u burgos dhe 18 muaj u mbajt në burg. Për më tepër, Shkollën Shqipe të Stubllës, krahas asaj të Prizrenit, Gjakovës, Pejës dhe Janjevës, e përmend edhe historiani i njohur anglez Noel Malcolm (Shih. N. Malcolm, Kosova, fq. 195). Në të vërtetë, dokumentet dhe autorët, që flasin dhe shkruajnë për këto dhe data të tjera vetëm sa tregojnë dhe dëshmojnë për vazhdimësinë e kësaj Shkollë, që nga viti 1584 e deri në ditët e sotme, kur funksionon shkolla fillore „DON MIKEL TARABULLUZI“. Ndërsa në vitin 1969/1970, falë mirëkuptimit dhe përkrahjes së pakursyer të Esat Kamberit, atëherë drejtor i shkollës (amë) fillore „Emin Duraku“, në Gjylekar, hapen tetë klasë. Ndërkaq, me insistimin tim, Kuvendi Kumunal në vitin 1982 merr vendimin për pavarësimin e shkollës së Stubllës dhe për drejtor të saj e emëron



Isak Ahmetin. Më pas këtë shkollë do ta udhëheqin (si drejtor): Gjon Ballabani, Marjan Ukaj dhe Qeshk Ukaj, të cilët përmes një angazhimi dhe kontributi të çmueshëm, ndonëse me sakrificat të mëdha të kuadrit arsimor-edukativ, edhe në kohën e okupimit klasik serb, do ta mbajë gjallë këtë shkollë – vatër e arsimit dhe edukimit të gjeneratave të reja.

Krahas shkollës fillore „Don Mikel Tarabulluzi“ në Stubëll, gjithnjë në objektin e shkollës fillore, funksiononte edhe SHM

– Gjimnazi „KUVENDI I LEZHËS“ – punkti në Stubëll, që është themeluar më 1991 me Aktvendim të Ministrisë së Arsimit të Republikës së Kosovës, kurse përgjegjës emërohet Prof. Llukë Pera, detyrë që e kryen edhe sot.

Ndonëse me sakrificat të mëdha të kuadrit arsimor, pa ndonjë përkrahje të mjaftueshme morale dhe materiale, SHM- Gjimnazi „Kuvendi i Lezhës“ – punkti në Stubëll, vazhdoi së funksionuari edhe pas Luftës së fundit në Kosovë (1998/99). Ç’është e vërteta,



Shkolla fillore „Don Mikel Tarabulluzi“ sot



ky gjimnaz në vitin 2001 do të përballtet edhe me rrezikun e mbylljes nga autoritetet vendore. Mirëpo, falë angazhimit të pakursyer dhe aktualizimit të kësaj çështje prej disa personaliteteve të Stubllës që vazhdimisht kontribuojnë për arsim, problemi arriti të shtrohet deri në instanca më të larta tek vendorët dhe ndërkombëtarët. Kështu që më 02. 10. 2001, pas një takimi zyrtar me z. Naim Rrustemin, atëherë bashkëdrejtues në Departamentin e Arsimit të Kosovës, me një urdhëresë-vendim special të nënshkruar nga z. Ed Brucke, u konformua edhe njëherë vendimi për ekzistimin dhe funksionimin e mëtejme të SHM – Gjimnazit „Kuvendi i Lezhës“- punkti në Stubëll, prej nga deri më tash kanë dalë 15 gjenerata maturantësh. Për më tepër, në Shkollën Shqipe të Stubllës, vatër e arsimit dhe edukimit ndër shekuj, kanë mësuar nxënës, disa prej të cilëve, më vonë, do të bëhen personalitete dhe emra të njohur jo vetëm në rrafshin kulturor kombëtar, por edhe në rrafshin kulturor ndërkombëtar.

2. MANIFESTIMI SHKENCOR E MULTIKULTUROR “TAKIMET E DON MIKELIT”

Kishte shumë arsye për organizimin dhe mbajtjen e një manifestimi shkencor e multikulturor, i cili do të prekte anë të ndryshme të fushave të shumta të shkencës, artit, letërsisë, shkollës-arsimit, kulturës, por edhe të politikës e të vetë jetës në Kosovë.

Me rrënimin e autonomisë së Kosovës, në vitin 1989, pushteti serb jep sinjalin më bindës për zhbërjen e Kosovës. Dhe rrënimi i autonomisë nuk nënkuptonte vetëm zhveshjen e shqiptarëve nga pushteti, por ajo prekte të gjitha institucionet, shtrihej në të gjitha segmentet e jetës shoqërore, duke përfshirë këtu edhe arsimin, shëndetësinë, kulturën... Të zhveshur kështu deri në palcë, njeriu sikur humb kuptimin e të jetuarit, humb dinjitetin e tij.

Manifestimin “Takimet e don Mikelit”, është vështirë ta quash vetëm manifestim shkencor e multikulturor. Është më shumë se kaq, po patëm parasysh gjithë botën që manifestonte dhe mesazhin që transmetonte: është një sistem i tërë i një filozofie të re i injorimit të pushtetit të pushtuesit, i vetëdijësimit dhe i bashkimit të popullit dhe mbrojtjes përmes formave më demokratike e më të avansuara, është një sistem vlerash që sforconte ndjenjën dhe përkushtimin për kulturën, shkollën, arsimin.

E ngritur kështu në shkallën e një sistemi, ky manifestim mbledh njerëz të shtresave, kategorive e profesioneve më të ndryshme dhe nga të gjitha



Pamje e pjesëmarrësve në "Takimet e Don Mikelit"

trevat shqiptare, si: Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi e Kosova Lindore.

Për më se një dekadë ky manifestim ka qenë për njeriun tonë, shprehje e dijes, e moralit, e urtësisë, e kujtesës kombëtare, ka qenë arkivi, kronika e historia e jetës së tij, mesazhi i qartë për vendosmërinë dhe synimet tona, ka qenë vetë shpirti ynë. Ndonëse nën kërcënim të tanksave të pushtuesit dhe përkundër shumë arrestimeve të organizatorëve të këtij manifestimi (më 1990), ky manifestim nuk druhej e as që tërhiqej përpara kësaj makinerie. Për më tepër, manifestimi jepte përgjigje të qartë përballë problemeve politike, sociale e historike dhe si rrjedhim pati bashkimin e shqiptarëve rreth një kauze drejt realizimit të synimeve tona dhe, mirë e mirë propagandonte e trasonte rrugën e drejtë që duhej të bënte Kosova. Shih për këtë, manifestimi, si të thuash, konceptonte jetën në kundërshtim të plotë me shoqërinë zyrtare, pushtetin e pushtuesin serb. I gjendur kështu, në situatën e mospajtimit, manifestimi "Takimet e don Mikelit", polemizonte në mënyrë të shkëlqyeshme, përmes artit, kulturës e shkencës me klasën pushtuese, duke sinjalizuar njëkohësisht edhe dritën në fund të tunelit. Dhe jo vetëm kaq. Manifestimi mbante një qëndrim aktiv e shumë kritik



ndaj realitetit dhe asaj që kishte ndodhur, është prezent në zhvillimin e ngjarjeve dhe, duke vepruar si një organizëm i gjallë, ky manifestim u kthye në një institucion organizues të psikikës kosovare. Akademia shkencore, ku trajtoheshin tema të ndryshme historike, filozofike, etnografike, sociale, letrare, politike e çka jo tjetër, arti poetik, figurativ e skenik, kënga dhe mesha e shenjtë ishin vlerësimi dhe shqyrtimi më i lartë i realitetit të kohës dhe i gjendjes së përgjithshme në Kosovë, një kronikë e llojit të vet, një protokol i vetë popullit, një laborator, në të cilin zienin revolta e papërmbajtur e synimi për të ardhmen... (Të përkujtojmë këtu se pikërisht në këtë manifestim, më 1990, publikisht u këndua për Kosovën Republikë, ose thënë më mirë, ajo u promovua para masës së gjerë, edhe pse, siç thamë më lart, pjesëmarrësit e manifestimit ishin të rrethuar nga makineria policore e ushtarake serbe).



*Pamje nga
"Takimet
e Don Mikelit"*


"Takimet e don Mikelit" me gjithë dinamikën e saj brenda kohës dhe hapësirës, duke ligjëruar identitetin kombëtar (edhe në raport me të tjerët), do të dëshmojë se forca e kulturës është e pakontestueshme, e pathyeshme, që nuk njih kthim prapa. Këto takime edhe pas luftës sonë çlirimtare, vazhdojnë të provojnë nevojën e funksionimit dhe forcën e shkencës, artit, kulturës, politikës parimore, të dijes në përgjithësi për efektin që ushtron në natyrën dhe edukimin e qenies sonë.

Të mos harrojmë se në këtë manifestim morën pjesë figura e personalitete të shquara të shkencës, artit e të kulturës nga hapësira mbarëshqiptare,

duke krijuar në njëfarë forme edhe një model të ri të një konkurrence të heshtur në fushë të dijes. Vetë fakti se kemi një numër të madh ligjëruesish për fusha të ndryshme të shkencës (në Akademinë Shkencore), një numër shumë të madh të krijuesve, poetëve (në Orën e Madhe Letrare), shumë artistë të tjerë të artit pamor e skenik, është një dëshmi e mjaftueshme se ku qëndron niveli i këtij manifestimi dhe ku konsiston rëndësia e tij. Të shtojmë, se Këshilli Organizativ i këtij manifestimi, përmes çmimit “Agim Ramadani”, që ndan për poezinë më të mirë, një çmim ky pa konkurrencë në Kosovë, ka ndikuar që krijuesit të jenë më të kujdesshëm në krijimet e tyre të reja; në manifestim merren në shqyrtim vetëm poezitë e pabotuara.

Një tregues tjetër i seriozitetit të këtij manifestimi është edhe botimi i Buletinit të Takimeve të don Mikelit., pa harruar këtu edhe publicitetin që i japin masmediat e shkruara dhe ato elektronike, këto të fundit edhe me programe dokumentare mbi manifestimin.





III

STUBLLA

FAMULLIA E SHËN JOZEFIT

IV

Famullia e shën Jozefit

Stublla është famulli e pavarur që nga viti 1905. Para këtij viti Stublla ishte filialë e Famullisë së Letnicës. Me dekretin e Imzot Pashk Trokshit, ipeshkëv, të vitit 1905, shpallet famulli më vete (me përkujdesje pastorale që përfshin disa fshatra: Dunav (filial), Llokme, Stublla e Poshtme dhe fshatrat tjera, ku ka pasur një numër të vogël besimtarësh katolikë apo kriptokatolikë/larmanë). Famullitar i parë emërohet i njohuri don Mikel Tarabulluzi (Khs. Missae pro populo et Legata, Paraeciae Filialis S. Josephu Sponsi B.V. Mariae, Stublae 1906-1913, fq. 63.). Shkaqet e themelimit të famullisë, sipas vetë dëshmisë së don Mikelit, të shkruar në librin e përmendur, ishin: kushtet e volitshme, numri i konsiderueshëm i (kripto)katolikëve, përkatësisht banorët e shumtë të këtyre trojeve kërkonin pastorizimin e vazhdueshëm dhe kujdesin e një meshtari, sepse kohët e vështira shoqërore-politike bënë copëtimin dhe shthurjen e ndjenjës fetare dhe kombëtare. Po ashtu, popullata ishte e paarsimuar dhe për shkaqe të kësaj injorance vuanin edhe më tepër. Me qenë se don Mikeli disa kohë shërbente në famullinë e Letnicës dhe e njihte mirë këtë rajon, atëherë ipeshkvi Pashk Trokshi e emëron pikërisht atë për t'iu dalë në ndihmë besimtarëve katolikë, të lënë pa përkujdesje të përshtatshme fetare dhe kombëtare. Me këtë qëllim don Mikeli do ta hapë shkollën e parë shqipe në Kosovë, të pranuar dhe të financuar nga Austro-Hunagaria dhe Imzot Pashk Trokshi.

Dokumenti origjinal i shkruar nga Don Mikeli, që tregon se Famullia e Stubllës është themeluar më 1905 nga Imzot Pashk Trokshi. Po ashtu në dokument tregohet se stubllasit janë të gjithë shqiptar të fshatit Gash dhe gjithmonë kanë qenë katolik

Notizie sulla fondazione della parrocchia di Stubla.

Stubla, uno de' villaggi componenti la parrocchia di Bernagora, rimase per la cura spirituale sotto di quella sino al Febrajo del 1905, cioè fino a che per decreto di S. E. Mgr. Pasquale Trohsci, staccata da essa, le venne assegnato il proprio parroco. Causa principale ne fu il Consolato Austro-Ungarico di Scopia, che, bramando fondere in quel paese una scuola d'insegnamento albanese, assegnò a mezzo del Ministero degli Esteri un convenevole sussidio pel sacerdote che in uno all'ufficio di parroco dovesse avere anche quello di maestro. Con l'aiuto di quel Consolato e con altre elemosine raccolte in Austria si comperò la casa parrocchiale e gli arredi per la cappella.

Gli abitanti di Stubla, tutti di sangue albanese, appartengono alla tribù di Gashi. Si religionè sempre cattolici, dal timore de' turchi dominanti in questi paesi, mantennero la fede occultamente fino al 1844, quando, costretti dal governo di Ghillane ad apostatare o ad esulare, fra mille stanti uomini e donne e bambini furono condotti prima a Salonicco e poi a Brussa in Anetolia, donde, dopo quasi tre anni, per l'intervento di Francia, furono mossi in libertà e fatti tornare nel proprio paese.

Michel M. Parabulluzi
Parroco di Stubla.

Ai me dashuri dhe përkushtim e pranoi këtë detyrë tejet të rëndësishme. Dëshironte ta zgjonte popullin nga gjumi i paditurisë. Me dituri, shkollim, arsimim dhe qytetërim ia mundësoi këtij populli që ta njohë Zotin dhe të vërtetën, vetveten.

STATISTIKA E STUBLLËS

Nga librat që posedon Arkivi i famullisë, statistika e Stubllës del me sa vijon:

Në vitin 1872 Stublla i kishte 126 banorë.

Pas luftës së Parë Botërore: ajo kishte 261 banorë.

Në vitin 1937 ka 703 banorë.

Në vitin 1975 janë të lindur 75. Vdiqën 17. Në këtë vit kishte 1563 banorë.

Në vitin 1990 ka gjithsej 220 shtëpi më 2130 banorë.

Në vitin 2005 ka 317 shtëpi më 2756 banorë.

Amza
e të pagëzuarve
të laramanëve
të territorit të
Karadakut,
nga viti 1893

No. Nr.	Kod. Nr.	Mj. ceto rrotunja	Dokumente		Lum i parime			Kastitij	
			Lum detyrë	rrotunja	kr. tynja	Lum i parime oca	mogte		Lum i parime kuma
1		Lipacii	Nikola (Fox)	24. 10. 1892	29. 10. 1893	Çorolja e Mles	Çelbija Limes	Kish. J. Knaic	
2		Lefer	Zef (Shqip)	?	30. 11. 1893	Çorolja e Jasharit	Kradisha e Kallit	Kisha Karavano - Detunia	Petar Bica
3		Stublla postiter	Ena (Bartija)	6. 11. 1893	7. 11. 1893	Sylyman i Deltimit	Ajeta Pravi Pannikut	Mina e Joxes - Stublla	
4		-	Gjon (Jahi)	23. 11. "	14. 11. "	Çorolja e Kufit Mles	Çorja e Mles Kambosit	Leha e Gjergj Dokes	A. Tarabata Lumi
5		Prisale	Anna (Bajron)	6. 11. 1892	20. 11. "	Nolom Prisale	Çorja Kufit Mles	Tuna Mate Dolen - Leha	
6		Lefer	Marija (Kelia)	29. 11. "	26. 11. "	Mushini i Prashmit	Ola e Shirit	Marta Pal Shirotes (Prives) P. Bear	
7		Shahite	Role (Bajdine)	26. 11. 1893	27. 11. "	Kalimi i Abazit	Putra Kallit	"	"
8		Stancii	Marta (Bamide)	28. 11. "	29. 11. "	Norri i Kaly Dufit	Çorhanja Liron Depes	Marija Maria Tami Huse	
9		Dunov	Cjeronj (Sah)	21. 11. "	22. 11. "	Polom Sahit Syla	Lihja e Shiroteshit	Lola Kristin - Detunia	
10		Shohme	Leta	13. 11. "	29. 11. "	Lumini i Kallit Stublla	Marija e M. Leferit	Marija Pali Shirotes Huse	Mikel
11		Dunov	Mate (Beahop)	13. 11. "	14. 11. "	Bajcani i Ferat Dunavit	Leha e Kallit Kallit	Pjeter Perri Gjores	
12		Prisaj	Marta (Kam)	20. 11. "	29. 11. "	Stani i Mselit	Jara Mles	Mina Tomes	
13		Prisaj	Dila (Kromicini)	15. 11. "	29. 11. "	Bashija i Sejdis	Ysa e Kufit	Marija Pali Shirotes	
14		Prisaj	Jon (Abaz)	4. 11. "	2. 11. "	Prashini i Abazi	Çorhanja e Selmanit	"	
15		Stancii	Loren	1891	6. 11. "	Çelja i Salla hit	Masa e Kallit Stublla	Cjeronj i Kufit Stublla	
16		Stublla e postiter	Marija	1893	6. 11. "	Morchi i Lendris	Stigma e Legirit	Marta Hote Ramaj	
17		Stancii	Marija	1883	6. 11. "	Çelja i Salla hit	Masa e Kallit Stublla	Bibi Doki Pallabanit	
18		Prisaj	Petar	1869	19. 11. "	Ademi i Prashmit	Cjylla e Pririt	Lef Prisija	
19		Prisaj	Pal	1871	19. 11. "	Ademi Prashmit	Cjylla e Pririt	"	
20		Shahite	Zef (Cjeronj)	14. 11. 1892	2. 11. "	Cjiti i Kamit	Marija e M. Mles	Çorja i Miti Dokes	
21		Shahite	Mate (Anyl)	8. 11. 1893	2. 11. "	Leta i Kallit Stublla	Ola e Kallit Mles	"	Mikel Jona Kallit i Tami Huse

FAMULLITARËT E STUBLLËS

Don Mikel Tarabulluzi (01. 02. 1905 – prill 1933) ishte nga Prizreni. Prej vitit 1893 këtë prift e hasim në Karadak. Ishte famullitar në Letnicë dhe pasi Stublla ishte filiale e saj, ky e kishte në kujdes. Me siguri, që nga ardhja e tij në Letnicë, kishte punuar në arsimimin e këtyre trojeve, kurse me themelimin e famullisë së shën Jozefit ka hapur shkollën me 1905 e njohur si “Shkolla e Don Mikelit”. I veshur në tirq galan dhe i pajisur si gjuetar ka përshkuar tërë Karadakun, i ka njoftuar me të vërtetat e fesë dhe i ka pagëzuar. Për tridhjetë vjet e ka arsimuar popullatën e Karadikut. Atëherë kur don Mikeli ishte i penguar, qoftë për shkaqe shëndetësore, qoftë për shkaqe të burgosjes, mësimi nuk është ndërprerë, sepse e ka zëvendësuar i vëllai, Jak Tarabulluzi.

Don Dedë Ramaj (02. 11. 1933 – 15. 08. 1936). Ishte nga Stublla. Është veçuar si predikatar i shquar dhe tejet i dalluar. Ende populli nëpër famullitë e Kosovës ku ka punuar, i kanë në mend dhe në zemër predikimet e tija. Po ashtu prioritet i ka dhënë arsimimit të brezit të ri.

Dr Don Knaus Fr. CM (16. 08. 1936 – 02. 01. 1938). Ishte nga Sllovenia. Prioritet pati jetën shpirtërore në Stubëll.

Don Rrok Mateu (6. 01. 1938 – 19. 03. 1939). Ishte me prejardhje nga Gjakova, i rritur në Shkup, pedagog i shkëlqyer, prift i cili për së tepërmi i deshi fëmijët dhe rininë. Në atë kohë bënte shetitje – ekskursionet me ta nëpër Kosovë. Ishte edhe trim i madh. Njësoj, si don Mikeli, i veshur si gjuetar, e përshkonte Karadakun dhe ungjillonte.

Don Pjetër Berisha (Pashkë 1939 – 24. 03. 1940). I lindur në Terzijaj, prift i butë, trim dhe njeri shumë i vendosur. E udhëhoqi famullinë në një kohë shumë të vështirë, në kohën e Luftës II Botërore. Më vonë edhe ky ka qenë i përndjekur dhe i burgosur i komunizmit – i regjimit ateist.

Don Nikolla Sharbanov (01. 11. 1943 – 25. 12. 1943). Rumun. Shërbeu shumë shkurt, sepse, duke e kryer detyrën meshtarake, ndarjen e sakramentit të vajimit njërit që lëngonte nga tifusi në Terzijaj, edhe vetë u infektua dhe pas tri ditëve vdiq. Konsiderohet martir i Eukaristisë – Meshës së shenjtë.

At Bllagoje Neumoff (25. 03. 1944 – 15. 08. 1946). Bullgar. Veprimi në periudhën më të vështirë, gjatë Luftës së II Botërore. Në Karadak gjendej ushtria okupuese bullgare, e cila pa mëshirë i rrahte dhe keqtrajtonte popullin. Ky prift, me angazhimin e pasqorë i shpëtoi banorët e kësaj ane nga barbaria bullgare. Ishte mjaft i afërt me njerëz, shumë i thjeshtë dhe bamirës. Edhe sot banorët e Stubllës e përkujtojnë si një prift që i ka dashur shumë stubllasit.

Don Dedë Ramaj (01. 11. 1948 – 08. 12. 1960). Emërohet për së dyti familjar. Është angazhuar për blerjen e truallit të kishës së re, ka filluar themelet, por komunizmi – ateist ia montoi aktakuzën, kinse ky kishte organizuar vrasjen e kushëririt të tij, David Sh. Ramaj. Është burgosur dhe dënuar me dymbëdhjetë vjet burg. Pas gjashtë vitesh burgimi është liruar si i pafajshëm. Shumë fëmijë të Stubllës i ka dërguar në shkollë, në mesin e tyre ka priftërinj, profesorë, doktorë shkence, shkrimtarë e poetë.

Don Luka Cirimotiq (25. 12. 1960 – 01. 11. 1972). I lindur në Janjevë, prift shumë i devotshëm dhe diplomat i madh. Pasi që e burgosën Don Dedë Ramaj, në Stubëll mbretëronte një gjendje shumë e rëndë. Ky prift me një shkathtësi të pasqorë e përmirësoi gjendjen, bëri pajtimin e të gjitha familjeve dhe e caktoi festën e Zojës së Lurdit. Ndërtoi kishën e re të shën Jozefit, e cila është përfunduar në vitin 1970. Ai ka organizuar ndërtimin dhe hapjen e rrugës kryesore për në Stubëll.

Don Janez Osvald (08. 12. 1972 – 23. 04. 1973). Slloven. E fliste bukur gjuhën shqipe. Ishte dashamirës dhe edukator i madh i fëmijëve. Me ta e kalonte të shumtën e kohës, si apostull dhe edukator i vërtetë, në lojë, në lutje, në mësim... Për shkaqe shëndetësore është larguar brenda një viti.

Don Jakë Prenku (23. 05. 1973 – 20. 09. 1989). I lindur në Ferizaj. Prift i veshëm dhe punëtor i madh. Ai i vazhdoi punimet në kishë të re, sidomos prezbiterin dhe këmbanaren, bëri rindërtimin e kishës së vjetër. Së bashku me Don Gjergj Gjergji-n e themeluan Muzeun e Martirëve dhe të Shkollës së Parë Shqipe dhe arritën që kisha e vjetër së bashku me Muzeun, që nga viti 1976 të jenë si monument kulture nën mbrojtjen e shtetit. Po ashtu bëri rrethimin e oborrit të kishës së re, të kishës së vjetër, të varrezave, asfaltoi rrugën kryesore për në Stubëll dhe kaldërmin e rrugës nëpër fshat. Ishte edhe bamirës, duke i ndihmuar shumë familjet e varfëra.



*Don Luka me
disa besimtarë të
Stubllës*

Don Rrok Gjonlleshaj (20. 09. 1989 – famullitar i sotshëm). I lindur në Velezhë. Erdhi në një kohë të transferimeve të mëdha në Kosovë. Me ardhjen e tij në famulli, ai ripërtin dhe gjallëron banorët e në mënyrë të veçantë rininë. Ka punuar shumë në formimin e thirrjeve shenjta. Nga vitet e 90-ta kur mësimi shqip nëpër Kosovë ishte ndaluar të mbahet nëpër objekte shkollore, si atë shpirtëror iu ndihmoi nxënësve, që shumicën e kohës ta kalojnë në objektet e kishës. Aty u organizuan, nën udhëheqjen e tij, shumë aktivitete kulturore dhe sportive. Është inisiator i manifestimeve kulturore “Takimet e Don Mikelit” dhe deri më sot i ka udhëhequr shkëlqyeshëm së bashku me besimtarët e vet. Ka bërë renovimin e Kishës së re të shën Jozefit. Ka ndërtuar sallën rinore me përmasa të mëdha, për aktivitete të të gjitha llojeve: kulturore, sportive, argëtuese, animuese etj. Ka ndërtuar ambulancën e re të fshatit “Shën Vinçeni”, ku punojnë motrat vinçenciane. Shquhet për bashkëpunim të mirë me stubllasit.

THIRRJET SHENJTE

Famullia e Stubllës është e njohur në ipeshkvinë tonë për thirrjet shenjte. Shpesh herë dëgjohet të thuhet se ky fshat, me kulturë të lartë, është si minierë e meshtarëve dhe e rregulltarëve e rregulltareve. Mbas Luftës së Dytë Botërore, por edhe më parë, kemi numër të madh të meshtarëve dhe motrave të nderit, të kualifikuar me shkallë akademike dhe punëtorë të veshëm në disa vende të botës.

Deri sot Stublla i ka gjithsej 29 meshtarë dhe mbi 50 motra të nderit. Prej tyre 7 meshtarë kanë kaluar në amshim. Të tjerët janë në shërbim të Zotit dhe popullit nëpër vende të ndryshme. Në mesin e tyre është një françeskan, At Marjan Lorenci OFM dhe një jezuit, At Shtjefën Dodes SJ.

Besimtarët e Stubllës kanë një cilësi të veçantë në raport me meshtarët. Me sa duket, këtë ndjenjë të lartë respekti dhe admirimi e kanë trashëguar nga syrgynët (martirët) e tyre, që e dhanë jetën për Jezu Krishtin. Gjaku i atyre burrave heronj të kishës së Stubllës dhe popullit të Karadakut, është farë e vdekur në dhé që jep shumë frytë. Është nderë për një familje stubllase që njërin apo disa nga fëmijët t'ia dhurojë Kishës dhe popullit. Madje, mund të themi se nuk ka lagje që nuk ka meshtarë apo murgeshë/motër nderi, e disa kanë 2 e më tepër, p.sh. lagja Koliq ka 6 meshtarë (dy françeskanë e 4 meshtarë dioçezanë).

STRUKTURIMI DHE PASTORIZIMI I FAMULLISË

Në të kaluarën strukturimi dhe pastorizimi i famullisë ka qenë në formë klasike. Famullitari ishte ideatori dhe ekzekutuesi i të gjitha gjërave e bëmave në famulli. Ai, jo vetëm që ka qenë udhëheqës shpirtëror i famullisë, por njëkohësisht ishte edhe udhëheqës i fshatit. Sepse meshtari respektohej në mënyrë të jashtëzakonshme, konsiderohej më i shkolluar dhe më i sinqert.

Sot, me ndryshimin e pastoralit në Kishën Katolike botërore, me modernizimin e saj, me hapjen ndaj laikëve në veçanti mbas Konkilit II të Vatikanit, edhe famullia e Stubllës ka ndryshuar pozitivisht administrimin e saj veprues (pastoralin).

Stublla ka Këshillin e Kishës prej shtatë antarëve, që janë bashkëpunëtorët më të afërt të famullitarit në udhëheqjen e famullisë. Ka këshillin e fshatit, këshillin e rinisë, shoqërinë kulturo-artistike “Zëri i Karadakut”. Të gjithë i kryejnë angazhimet e detyrat e veta me përgjegjësi dhe me përkushtim

të plotë. Në këtë mënyrë famullia funksionon shkëlqyeshëm, si një qeveri e mirë, ku secili e kryen detyrën e vet në seksionet e veta.

Nga administrimi i tillë i ditëve tona, sukcesi është evident në secilën fushë, që nga ngritja e vetëdijes fetare- kulturore, rregullimi infrastrukturor, vetëdija ekologjike e deri te kultura sportive, kultura muzikore e teatrale. Të përmendim se djemtë dhe vajzat e famullisë me shfaqjet e tyre muzikore (Grupi “Zëri i Karadakut”) dhe teatrale kanë marrë pjesë në disa manifestime kulturore, kanë dhënë shfaqje e koncerte në shumë qytete të Kosovës dhe janë cilësuar si artistë të vërtetë.



MOTRAT VINÇENCIANE

Në Famullinë e Stullës shërbejnë Motrat Vinçenciane. Ato në famulli mbërrijnë në vitin 1961.

Qysh atëherë e deri sot janë të palodhshme në punët e famullisë. Të njohura për punën me të sëmurë e të varfër, sipas themeluesit të tyre shën Vinçenc Paulit, hapin ambulancën dhe kujdesen për shumë të sëmurë, të cilët çdo ditë e vizitojnë këtë objekt, si edhe të varfërit të cilët trokasin dhe kërkojnë ndihmë. Në fillim ambulanca ishte në oborr

të kishës në një objekt të vogël, kurse kohën e fundit është ndërtuar ambulanca e re me pajisje moderne, me emrin “Shën Vinçenci”. Përveç që rregullisht punojnë motrat vinçenciane, herë pas



here vjen edhe mjeku nga Vitia, për kontrollime mjekësore më të rënda. Ambulanca e Stubllës “Shën Vinçenci” është degë e Shtëpisë së Shëndetit “Nënë Tereza” të Vitisë.

Në këtë ambulancë rregullisht kërkojnë shërim të sëmurët, banorët e Stubllës dhe të të gjitha fshatrat përreth. Kohë pas kohe vijnë nevojtarë për t’u shëruar, edhe nga vendet tjera (30-40 km larg), sidomos të varfërit.

AKTIVITETET

Në Stubëll gjithmonë janë zhvilluar aktivitete të ndryshme. Stubllasit njihen si aktivistë të mëdhenj. Gjithnjë dëshirojnë të bëjnë më tepër se është e nevojshme, e kjo është cilësi shumë e mirë!

Në mënyrë të veçantë në Stubëll është zhvilluar dhe janë shfaqur drama me tematika të ndryshme. Tekstet e dramës janë shkruar nga vetë stubllasit. Po ashtu, edhe artistët janë vetë stubllas. Po i përmendi vetëm disa teskte dramatike: “Qëndresa”(tematikë e martirëve të Stubllës), “Fshehtësia e rrëfimit”(tematikë përshpirtërie), “Të gjithë më duan, vetëm babai jo”(tematikë e jetës – për rini). Mandej janë shfaqur shumë programe kulturo-artistike, me këngë, valle dhe humor burimor.

Të gjitha këto aktivitete kulturore janë mbajtur në një kohë kur në gjithë Kosovë nuk është guxuar të mbahen gjëra të tilla nga serbet, kurse për një fshat të vogël – në krahasim me qytetet e Kosovës – siç është Stublla ngjarje të tilla kulturore janë shfaqur rregullisht. Madje, s’guxohet të harrohet se shpeshherë stubllasit për këto gjëra kanë qenë të kërcënuar nga policia serbe,

*Grupi muzikor
“Zëri i Kara-
dakut” gjatë
“Takimeve të
Don Mikelit”*

dhe ishin vazhdimisht në shënjestër. Porse, dashuria e fortë për fenë dhe kulturën autoktone ka ngadhënjyer. Rregullisht mbahen “Takimet e rinisë” të cilat janë mujore, kurse në një periudhë para luftës ishin javore. Aty janë trajtuar tema të ndryshme fetare, kulturore, edukative, të nevojshme për rini. Çdo vit mbahen kuize nga dituria, ndonjë herë edhe më tepër, në pesë lëmi:



*Aktivitetet
sportive të të
rinjëve*

Bibël, histori, gjeografi, gjuhë e letërsi, kulturë. Çdo ditë (prej të martës deri të premten) mbahet mësimi i fesë apo besimi, edukimi në fe për të gjitha klasat. Çdo të shtunë është takimi me ministranta të famullisë.

Po ashtu organizohen turne sportive, tradicionalisht në futboll të vogël me emrin “Engjëll Zefi”. Mandej në këtë kuadër të aktiviteteve hyjnë edhe shëtitjet dhe shtegtimet me të gjitha moshat nëpër Kosovë dhe gjetiu.



PËRSHPIRTËRIA

Stubllasit janë njerëz të përshpirtshëm. Pos meshëve të rëndomta, që janë çdo ditë, në famulli janë të pranishme edhe përshpirtëri tjera popullore: lutja e rregullt e rruzares, nëntëditëshja dhe kushtime të ndryshme ndaj Zotit dhe shenjtërve, çdo të premte të muajit adhurim me T’Shenjtënuashmin Sakrament, ndërsa për çdo të shtunë të muajit një orë lutje.

Gjatë tërë Kreshmëve besimtarët shtegtojnë në Stubllavaqë te Kryqi. Së paku njëherë në mënyrë të organizuar, me pjesëmarrje të besimtarëve të Stubllës dhe të famullive të tjera.

Me rastin e festave të Zojës fetarët tanë shtegtojnë në Letnicë (traditë është të shtegtohet zbathur), si dhe në famulli tjera të rrethit. Për Korpin e Krishtit organizohet proce-



*Pamje nga
procesioni me të
Shenjtënuashmin
Sakrament*



*Fëmijët gjatë
Procesionit*

*Truporja
e Zojës Lurdit*

*Kisha e vjetër e
shën Gjergjit*



Festa e Zojës së Lurdit në Stubëll është festë që nga famullitari Don Lluca Cirimotiq. Ai, duke parë se stubllasit, besimtarët e vet, ishin të përçarë dhe në ngatërresa me njëri-tjetrin, pse komunizmi kishte futur rrënjët në shpirtat e tyre (shumë prej tyre kundërshtonin rreshtë ndërtimin e kishës së re), thirri të gjithë besimtarët në përkushtim ndaj Zojës së Lurdit dhe ndaj Shejtnueshmit Sakrament. Dhe u përбетua para Saj, se nëse do të pushojnë ngatërresat në famulli, e gjithë famullia do ta festojë Zojën e Lurdit, kurse natën e festës do të jetë procesion me të Shenjtnueshmin Sakrament dhe adhurimi gjatë gjithë natës. Zoti bëri mrekulli dhe Zoja ndërmjetësoi, kështu që stubllasit ranë në pajtim. Qysh atëherë Zoja e Lurdit është

një ditë e jashtëzakonshme e lutjes dhe e adhurimit për të gjithë besimtarët, pleq e plaka, të rinj e të reja.

Në Famullinë e Stubllës ekzistojnë tri Kisha:

1. *Kisha e Vjetër* (e ndërtuar në vitin 1896) i kushtohet shën Gjergjit. Stubllasit aty i kanë kryer shërbimet fetare deri në ndërtimin e kishës së re. Sot në këtë kishë kremtohet mesha një herë në javë (të mërkureve). Njashtu, kjo kishë ka shërbyer edhe si shkollë. Tani është muze dhe monument kulture.

sioni nëpër fshat me të Shenjtërueshmin Sakrament.

Për festat e ndryshme të famullisë organizojmë rregulisht treditëshin përgatitor. Është karakteristike që në Stubëll kremtohen tri festa: Festa e shën Jozefit me 19 maj (festë e pajtorit të famullisë), festa e Zojës Lurde më 11 shkurt, festa e shën Gjergjit më 23 prill (pajtori i Kishës së Vjetër) dhe festa e Shna Prenes më 26 korrik në Dunav (filiale e famullisë).

Festa e Zojës së Lur-






Kisha e re e shën Jozefit dhe truporja e shën Jozefit



2. *Kisha e re* (e ndërtuar në vitin 1969) kushtuar shën Jozefit pajtorit të Famullisë. Kjo është kisha qendrore e Famullisë , e cila është e përshtatshme për shërbimet fetare.

3. *Kisha e Shna Prenes në Dunav*. Është filialë e Stubllës. E ka ndërtuar ipeshkvi Gnidovec. Tani me shpërnguljen e banorëve të Dunavit kisha ka mbetur bosh dhe është e shpallur monument kulture nën mbrojtjen e Komunës së Gjilanit. Më 26 korrik stubllasit për çdo vjet shtegëtojnë, shumica këmbë, dhe atje kremtohet mesha shenjte.



Kisha e shna Prenes në Dunav dhe truporja

TRADITA QË VAZHDON – 100-VJETORI

Sivjet Famullia e Stubllës e përkujton 100-vjetorin e themelimit të saj. Është përvjetor i një rëndësie të madhe, që tregon për një traditë të vjetër kishtarë në këtë vend. Krishterimi i këtyre trojeve është i përshkuar përplot martirizime e me gjak, krishtërim që në mënyrën më intime i përngjan Jezu Krishtit. Një traditë e gjakut. Një histori e shëlbimit e shkruar me gjakun e besimtarëve.

Kjo traditë e lashtë e Stubllës, jo vetëm 100-vjeçare – sepse edhe më përpara jeta e krishterë është jetuar dhe dëshmuar në Stubëll e përreth – është e pranishme edhe në ditët e sotme. Madje, kjo traditë është e ruajtur si visar i çmueshëm, i pajisur me devocion e përshpirtëri të ndryshme siç dijnë stubllasit.

Gjatë gjithë këtij viti jubilar, famullia ka organizuar takime të ndryshme të përshpirtërisë dhe të lutjes, meshë triditëshe dhe procesione me të Shenjtërueshin Sakrament, takime me fëmijë, takime me rini, takime me pleqë; të gjitha këto kanë pasur një qëllim: 100 vjetë famulli në lavdërim të Zotit dhe në shërbim të shpirtërave.

Shtegtimi i besimtarëve të Ipeshkvisë Shkup-Prizren në Romë, në mesin e tyre edhe besimtarë nga Stublla (1967)









IV

STUBLLA

SOCIOKULTURA STUBLLASE

V

Sociokultura stubllase

I. ZHVILLIMI I SHOQËRISË STUBLLASE DIKUR DHE SOT

1.1. FAMILJA SHQIPTARE DIKUR DHE SOT

Familja shqiptare historikisht ishte kryekëput tradicionale, patriarkale dhe mbështetëj në këto parime: të mbledhun gjymtyrësh (njerëzish) që jetojnë nën një kulm dhe si qëllim kryesor e kanë shtimin e njerëzve (lindjen e fëmijëve) nëpërmjet martesës si dhe zhvillimin e tyre trupor dhe mendor.

Nga përshkrimi dhe definimi që u dha këtu, kuptohet në mënyrë të qartë, se familja patriarkale mbështetet në bashkësi të gjerë njerëzish e jo vetëm në marrëdhënie ndërpersonale burrë-grua-fëmijë, kurse qëllimi kryesor ishte shtimi i numrit të anëtarëve të ri të familjes dhe vetëm pastaj i kushtohej kujdes zhvillimit të tyre trupor dhe mendor.

Familja shqiptare patriarkale ishte një lloj “kolektivizmi” mjaft burimor, ku, përpos burrit, gruas dhe fëmijëve, kishte edhe shumë pesëtarë të tjerë si: gjyshi, gjyshja, kunetet, kunatat, hallat, nipat, mbesat... Burimi i këtij botëkuptimi ishte ky: krijimi i bashkësisë. Sepse në botëkuptimin tonë tradicional personi i pavarur vetvetiu nuk ekzistonte, por vetëm në kraharorin e familjes, në solidaritet dhe bashkëpunim, në bashkëjetesë me të. Kjo psikologjikisht domethënë se njeriu në kontekstin familjar shqiptar

Familje tradicionale e Stubllës



nuk është individ, person, i ndarë dhe i dalluar prej të tjerëve, por më tepër trajtohet si pjesë përbërëse, një lloj fuzioni apo shkrirje në bashkësi, kuptohet nën udhëheqjen apo sundimin e një autoriteti, zoti dhe zonje të shtëpisë.

Familja stubllase dikur, si edhe të gjitha familjet shqiptare, ishte e karakterizuar me tipare patriarkale, ku rolet ishin të caktuara dhe të fiksuara gati në mënyrë natyrore. Rëndësia e parë ishte gjinia, ku mashkulli kishte rol aktiv në punë dhe në organizim familjar, si për shembull për shitje-blerje, tregti të vogël të pemëve, kryesisht të qershive, mollave dhe dardhave për të blerë gjërat ushqimore, grurë apo misër, vajguri për ndriçim, kripë dhe sheqer. Përpos kësaj, burrat ishin krah dhe fuqi pune për bujqësi dhe për blegtori. Toka ishte e pakët dhe jopjellore, malore, shpeshherë e dëmtuar edhe nga thatësia, nga shiu apo breshëri që shkatërronin punën dhe mundin e bujkut. Fusha lavrohej së pari me parmendë, më vonë edhe me plug, vetëm kohëve të fundit edhe me traktor, kurse tash ka mbetur gati në tërësi e shterrpë, djerrinë apo livadhe.

Familjet me gjendje të rëndë ekonomike e sociale nuk kishin bagëti, ndërsa pak familje kishin lopë të vogla malore dhe tufa dhensh, të cilat mbaheshin me kullosë të lirë nëpër male dhe roga, pas korrjeve dhe nëpër fusha.

Ushqimi sigurohej kryekëput nga prodhimet e qumshtit dhe nga prerja e thive, si për mish ashtu edhe për yndyrë. Lëkura e derrave terej dhe përdorej për opinga. Delet, përpos qumshtit dhe qengjave, ishin të rëndësishme



*Jeta e dikurshme
në Stubëll*

edhe për lesh, sepse veshmbathja punohej kryesisht me punë veku apo punë dore; kuptohet se këto punë i bënte bota femërore. Për këtë arsye thuhej se po e mban familjen me “kërrabza apo me gjylpanë” për gratë e vyeshme, sepse mungonin tërësisht shtofi, bezi, rrobot.

Lopët ishin të dobishme po ashtu në mënyrë të shumëfishtë: sigurohej qumshti, për shtimin e viçave (apo vjeta, si i quan populli), për punë në “zgjedhë”, si lavrimi, bartja e druve, prodhimeve të tokës. Kali apo gomari ishin i vetmi mjet udhëtimi. Njerëzit udhëtonin më së tepërmi këmbë edhe me orë apo ditë të tëra, deri në Kumanovë, Shkup, Gjilan, Ferizaj, Prishtinë, Prizren..., si për tregti, ashtu edhe për punë.

Stubllasit e kanë shfrytëzuar maksimalisht prodhimin natyror të Stubllavaqës, gurin, si për ndërtimin e shtëpive dhe objekteve tjera familjare, ashtu edhe për mjeshtri dhe punë jashtë fshatit. Dikur muratorët e Stubllës ishin shumë të njohur dhe të kërkuar gjithkund, si njerëz edhe si mjeshtrë të mirë dhe të shkathtë. Në Karadak dhe në rajonet përreth vetëm stubllasit dinin ta përdornin gurin dhe të ndërtonin shtëpia. Kjo punë tejet e mundimshme ua mundësonte, së paku, kafshatën e gojës për mbarë familjen. Puna e ndërtimitarisë ishte shumë e vështirë: që nga nxjerrja e gurit, bartja, përpunimi e deri te muratimi. Shpeshherë orë të tëra, mos të

themi tërë ditën, udhëtonin për të arritur deri te punishtja, nëpër fshatrat e Karadakut dhe më larg, kuptohet me veshmbathje dhe ushqim të dobët. Pas punës së mundimshme prej feksi drite e deri te muzgu i mbrëmjes, ata „pushonin“ duke fjetur nëpër pleme, pojate, pozllome... Kështu e kalonin pjesën dërmuese të pranverës, verës dhe vjeshtës, ndërsa dimrit kujdeseshin për nevojat shtëpiake dhe sadopak pushonin.

Të dielave dhe festave muratorët tanë kurrsesi nuk kanë punuar, duke dhënë shembull dhe dëshmi të bindjes dhe të jetës së krishterë. Për çdo të diele kanë ardhur në Stubëll për t'iu bashkuar familjes, dhe çka ishte më e rëndësishme “*për të parë meshë*”, si thuhej para Koncilit të Dytë të Vatikanit. Më kujtohet kisha e vjetër si fëmijë ministrant, tani kisha e Shën Gjergjit, ku s'kishte më vend as për gjilpërë, sa që kishëza dhe muret “djerësitëshin”, ndërsa nga dritaret avullohej, sepse kishte shumë njerëz krye më krye. Ishin shumë të kujdesshëm dhe të përsipirtshëm rreth Sofrës së Zotit.

Stublla ishte e njohur për të mirë për tri gjëra: *për qershia të mira, si shqiptarë dhe katolikë të mirë dhe besnikë dhe si mjeshtrë muratorë të mirë*. Pas Luftës së Dytë Botërore disa punëtorë gjetën punë në ndërmmarrjet ndërtimore shtetërore, sidomos në “Pellagoninë” e Shkupit. Muratorët tanë udhëtonin gati për çdo javë këmbë prej Stubllës e deri në Gërlicë dhe anasjelltas për ta marrë trenin për Shkup. Banimi ishte i dobët, nëpër baraka, si dhe ushqimi, mirëpo së paku kishin një lloj sigurie në punë, rroga, sigurimin shëndetësor, invalidor dhe pensional. Ky ishte një hap apo “kalim” ndryshimi cilësor, sepse iu mundësonte përmirësimin e kushteve të jetës dhe të punës. Për shkak të rrugës së largët dhe të mundimshme, herë-herë edhe të rrezikshme, disa familje muratorësh nga Stublla u shpërngulën në Binçë, më vonë edhe në Kabash, si dhe për arsye të tokës më pjellore dhe të jetës më të lehtë.

Stublla si vend malor ishte mjaft e izoluar, pa rrugë, pa rrymë eletriike, pa shkollë (ishin vetëm katër vitet e ulta të tetëvjeçares), pa komunikim me botën. Më kujtohet përjetimi i “ngjarjes” së tranzistorit të parë (radios), apo si thoshin atëherë e “kutisë e cila fliste dhe këndonte”, që ishte një lloj mrekullie e kohës. Brezat e parë për të vazhduar shkollimin e mëtejshëm, viteve të gjashtëdhjeta, kanë udhëtuar këmbë Stubëll-Viti, më vonë Stubëll-Zhegër. Nga kjo gjeneratë janë edhe meshtarët dhe intelektualët e parë të Stubllës. Këto rrethana shkaktonin një pasiguri të plotë, mbyllje dhe mbrojtje gati edhe instiktive dhe intuitive, sepse ishte i vetmi vendbanim me shqiptarë dhe katolikë, të kërcnuar dhe të rrezikuar në vete dhe nga të tjerët, sidomos nga përndjekjet e egra të policisë famëkeqe të Aleksandër Rankoviqit. Mjafton ta përkujtojmë vrasjen e David Ramaj-t, burgimin



*Panoramë e
Stubllës në
qershor*

e famullitarit të atëhershëm Don Dedë Ramaj-t, ndalimin e ndërtimit të kishës së re të Shën Jozefit, rrahjet dhe keqtrajtimet sistematike të fshatarëve. Stublla jetonte në ankth dhe në tmerr kolektiv...

Rrathanat e tilla shoqërore, kulturore, fetare dhe kombëtare i detyronin stubllasit të fejuheshin dhe të martoheshin në katund, ndonjë herë edhe në Vernakollë edhe me Binçë, e cila atëherë kishte vetëm disa familje të mëdha shqiptare katolike. Fejesat

dhe martesat ishin tradicionale, familjare, edhe pse njiheshin gati të gjithë si një familje. Vajza “nën unazë”, e fejuar ruhej që mos të shihej prej të tjerëve, sidomos prej familjes së të fejuarit, sepse kjo trajtohej si kori, mosnderim, sfidë për të keq, provokim. I vetmi vend ku shkohej lirisht edhe pas fejesës ishte kisha, kremtimet fetare. Martesat bëheshin rregullisht të hanën, kurorëzimi kishtar bëhej në mëngjes me meshë, pastaj ktheheshin te shtëpia, dhe në orët e pasditës krushqit shkonin për ta marrë nusen me kali dhe me duvak (mbulojë të tërësishme të trupit). Dasma zgjaste tri ditë me kremtime të ndara gjinore. “Miqtë” trajtoheshin sa më mirë, me pije të rakisë dhe me meze, gjëra ushqimore, me muzikë me çifteli, ndonjë herë edhe me kavajë, me bisedime dhe ndejë të qetë dhe vëllazërore. Gratë po ashtu argëtoheshin në mënyra të ndryshme, me imitime, si pjesë të vogla teatrale, këndime dhe vallëzime të përcjellura me def. Gratë ishin kryesisht amvise, punonin shumë me vek dhe punëdore tjera, tjerre, qendisje; merreshin edhe me bujqësi. Ato ishin të detyruara të jenë zot dhe zonjë shtëpie, sepse “burrnimi” ishte në punë jashtë shtëpiake, dhe si të tillë ishin gati mysafirë në familje.

Karakteristikë e familjes shqiptare katolike e Stubllës ishte jeta familjare e ngrohtë, përkujdesja për fëmijë dhe për të moshuar, të sëmurë, përsheptëria dhe urata e përbashkët mëngjesore, sidomos mbrëmësore, pjesëmarrja e rregulltë në jetën sakrametale, bujaria për të varfër dhe të mjerë. Stublla deri në vitet 70-të ishte një lloj kuvendi i hapur, ku njerëzit jetonin prej fesë dhe me fe

Në jetën dhe traditën e atëhershme rëndësi të veçantë kishire mulliri. Prej Letnicës e deri në Gërçar ishin dhjetra mullira, si sot ndonjë fabrikë e

vogël, sepse ishte burimi i sigurt i fitimit, bukës, por edhe vend takimi, bisedimi, ngjarjeje, përjetimi, me një fjalë vend ku ndodhte gjithmonë diçka, ruhej dhe kultivohej tradita. Populli mullirin e citonte si burim të saktë të informative, si p. sh. kam parë apo dëgjuar te mulliri, jam takuar te mulliri...

1. 2. EDUKIMI

Përpara edukimi ishte shumë më i lehtë, si për prindërit, ashtu edhe për fëmijë, sepse mjaftonte mësimi i traditës, Kanunit, me zbatimin e tyre sa më të përpikët, dhe kjo ishte e qartë për të gjithë. Dikur të jesh i mirë domethënë t'i përmbahesh traditës, kulturës, fesë, rrethit, një lloji bontoni të bashkësisë. Sot edukimi është një sfidë e vazhdueshme për të gjithë, sepse na mungojnë pikat e sigurta orientuese dhe përcaktuese dhe ne disi duhet ta gjejmë mënyrën për edukim dhe vetedukim.

Edukimin mund ta shqyrtojmë nga këto këndvështrime:

Njeriu vërtet është vlerë, ka vlera, dhe si i tillë është i edukueshëm dhe edukator gjatë tërë jetës së tij. Nga kjo rrjedh pasoja e qëndrimit pozitiv ndaj vlerave dhe edukimit dhe atë duhet ta mbështesim në kërkimin e të vërtetës apo të së mirës dhe të së bukurës në jetë. Edukimi familjar i ka këto veçori: është i pazëvendësueshëm, qendror dhe shembullor. I

*Besimtarët në
oborrin e kishës
së vjetër*



pazëvendësueshëm – sepse në familje lind jeta e re, fëmija, duke i mësuar hapat e parë të jetës në çdo pikëpamje; qendror – sepse çdo edukim duhet të jetë në një mënyrë në stilin e familjes, duke u mbështetur në edukimin familjar dhe duke e zgjeruar atë për jetën e mëvonshme, për shkollë, punë, shoqëri; shembullor – sepse pa shembull të mirë në familje s’ka edukim të mirë dhe të suksesshëm.

Familja është bartëse dhe dhuruese e jetës dhe e vlerave të edukimit. Sot edukimi trajtohet më tepër si proces i vazhdueshëm dhe gjithëdimensional i fëmijës, të riut, njeriut, e jo si dikur kur trajtohej ndaras edukimi intelektual, fizik, moral, fetar... si “sektorë” të posaçëm, duke e humbur unitetin e personit njerëzor. Njeriu është “unitas complexa” – njësi e ndërlidhshme: trup, psikë dhe shpirt, e kaluara, e tashmja dhe e ardhmja, “prodhim” kohe dhe hapësire, dhe vetëm kështu si njësi duhet të edukohet dhe vetedukohet gjithnjë.

Për një edukim sa më të mirë sot nevojitet:

- Krijimi apo formimi i personalitetit bazor, sipas mundësive të njeriut. Për këtë duhet të punohet rreth njohjes, pranimi dhe zhvillimit të vetvetes, si parakusht për marrëdhënie të mira ndërnjerëzore

- Edukimi për liri dhe për përgjegjësi, për vlera dhe virtyte dhe me orientime dhe përcaktime të qarta, jo për ligje, rregulla, ndalesa, norma, apo për sjellje sipas rastit, rrethanave, të tjerëve, sepse ashtu ne do të jemi “mall” në duart e fatit. Liria nuk është çka më pëlqen mua (hedonizmi), çka më duket mua /hamendja/, çka bëjnë të tjerët (populizmi masiv), çka më ndihmon mua për pasurim dhe për sukses), materializmi dhe karrierizmi), por çka është e mirë, e drejtë dhe e vërtetë.

- Edukimi për komunikim, për takim, afrim, bashkim, për bisedë, dialog si kërkimi i të mirës së përbashkët, sepse nga aftësia për marrëdhënie dhe komunikim mvaret kryesisht jeta jonë.

Sot edukimi duhet ta aftësojë njeriun të që jetë vetvetja, t’ua mundësojnë edhe të tjerëve që të jenë vetvetja për të kaluar prej fazës UNË kah TI; dhe UNË dhe TI së bashku për krijimin e ndjenjës së përbashkët në NE. Kjo vlen sidomos për jetën bashkëshortore dhe për edukimin familjar.

Në Stubëll për edukim të gjithmbarshëm, në veçanti atë moral, kulturor dhe shpirtëror kujdesohej vetëm famullia, si zemër dhe qendër ndikimi dhe formimi. Famullitari ishte personi kryesor për çdo familje dhe për mbarë bashkësinë. Pa të s’bëhej asgjë, sepse njerëzit kishin aq besim të fortë në të sa që e pyetnin dhe këshilloheshin për çdo gjë, shitje-blerje, fejesa-martesa, rregullime dhe veprime në fshat, për marrëdhënie ndërfamiljare, me fshatrat e rrethit, për mosmarrëveshje dhe konflikte të ndryshme, për të gjitha dhe mbi të gjitha. Fjala e famullitarit ishte përfundimtare,

nuk diskutohej fare, por pranohej dhe zbatohet, duke krijuar kështu një kompaktësi dhe bashkësi vërtet unike. Sikurse çdo familje e ka të zotin e shtëpisë, nga i cili varej çdo gjë në rrethin familjar, ashtu mund të themi se famullitari ishte zoti i të gjitha shtëpiave, i tërë famullisë, me përkujdesje dhe përgjegjësi për të gjithë.

Shkolla fillore, katër klasët e para, në stilin komunisto-ateist mundoheshin nëpërmjet mësuesve të jenë antagonistë dhe kundërshtarë të famullisë dhe të famullitarit, duke sulmuar atë haptas si person, si institucion, autoritet, por edhe fenë me anë të ideologjisë antifetare, sidomos antkrishtere dhe antikombëtare kinse nën petkun e internacionalizmit komunist. Mirëpo ky “dualizëm” ishte pa konkurrencë, sepse stubllasit e kishin të thadruar në shpirt dhe në zemër fenë e të parëve, krishtërimin lashtësor dhe martir, sa që nuk kishte lëkundje apo dyshime. Besimi në Zotin dhe në Kishën, në famulli dhe në priftin ishte i plotë dhe jetësor. Vetëm kështu ishin ruajtur si shqiptarë dhe si të krishterë gjatë shekujve, sidomos nën sundimin e egër shekullor turko-otoman, sa që binomi për Fe dhe për Atdhe ishte përvojë historike dhe aktuale.

Meshtarët në përgjithsi, sidomos Don Dedë Ramaj, kontrastin kisha – shkolla e zbuti me shumë urti dhe strategji. Më kujtohet fare mirë se si gjatë meshës së mëngjesit gjatë ditëve të shkollës dhe punës, ai e vinte orën e xhepit në alter, dhe kur ishte koha për të shkuar në shkollë, përkohësisht e ndërprente meshën duke i ftuar të gjithë fëmijët që të shkojnë në shkollë. Po ashtu Don Dedë Ramaj që ai që i bindi prindërit tanë që t’na lejonin dhe mundësonin vijimin e shkollimit në Viti dhe në Zhegër për klasët e larta të tetëvjeçares. Me kënaqësi përkujtohet kujdesi i tij atëror ndaj nesh. Herët në mëngjes, së pari shkonim në kishë për t’u lutur dhe për t’u kunguar, e atëherë së bashku udhëtonim për në shkollë me bekimin dhe udhëzimet e tija. Rrugës së bashku e përsëritnim mësimin, apo luteshim, rruzarën e Zonjës apo ndonjë lutje dhe këngë kishtare. Po ashtu edhe pas shkollës, 24 km këmbë, të stërlodhur dhe të uritur, prapë së bashku shkonim në kishë për të falënderuar Zotin për ditën e kaluar e pastaj secili shkonte të shtëpia e vet. Don Dedë Ramaj e dinte përmendësh orarin tonë shkollor, sa orë i kishim, dhe na priste në oborr të kishës, na pyeste si kishim kaluar në shkollë, gjatë udhëtimit, na bënte ndonjë pyetje nga historia, gjeografia, letërsia shqipe... Kur ishte ndonjë festë na dhuronte ndonjë petëll apo ëmbëlsirë, që për ne ishte risi dhe kënaqësi e madhe. Kështu na përkrahte në shkollimin dhe udhëtimin tonë të vështirë dhe të rrezikshëm, na përgatiti për jetën e mëvonshme, një pjesë edhe për thirrjen meshtarake. Ai e dinte fare mirë se shkolla e atëhershme ishte e “kriposur” me ideologji kundërfetare, por kishte besim në ne, në familjet tona, në edukimin tonë

familjar dhe famullitar. Shpeshherë na mësonte kështu: “Nëse ju pyesin a e doni Kishën apo shkollën?”, ju do t’iu përgjigjeni: “Ne e duam edhe Kishën edhe shkollën”. Ata, mendonte në mësimdhënësit, do t’ju pyesin ndoshta edhe këtë: “A e doni më shumë familjen apo shkollën?”. Ju prapë do t’ju përgjigjeni: “Edhe familjen edhe shkollën”. Antagonizmi Kisha-shkolla për të, nëpërmjet tij edhe për ne, nuk ishte pa zgjidhje me qëndrime të matura, të shëndosha dhe larpamëse që janë dëshmuar të suksesshme. Kështu Stublla e vazhdoi traditën shkollore, ndërsa don Dedë Ramaj me sukses veproi si mësues dhe meshtar sipas shembullit të Don Mikel Tarabulluzit.

Edukimi sot në Stubëll bëhet nëpërmes familjes, Kishës, katekizimit dhe shkollës, si dhe me anë të mjeteve pamoro-dëgjimore. Hallka familja-famullia-shkolla funksionon mjaft mirë dhe përbën një përvojë dhe bashkëpunim të vazhdueshëm. Por dukuritë negative të kohës së sotme e “sulmojnë” dhe rrezikojnë edhe këtë “oazë” apo “rezervatë” të çmuar të traditës dhe të kulturës sonë kombëtare dhe fetare. Kisha, famullia, bëjnë përpjekje të vazhdueshme për t’i ruajtur dhe mbrojtur fëmijët dhe rininë nga tjetërsimi dhe nga ndikimet negative, kuptohet në bashkëpunim me familjen dhe me shkollën. Dhe frytet e këtij bashkëpunimi janë të dukshme dhe mjaft konkrete.

1. 3. FAMILJA – SHKOLLË JETE DHE DASHURIE

Sipas Koncilit të Dytë të Vatikanit familja është qeliza e parë jo vetëm e shoqërisë, por edhe e edukimit në fe, pra, e Kishës, apo “kishë shtëpiake.” Në këtë Kisha, e cila mund të quhet edhe familjare, prindërit duhet të jenë për fëmijtë e tyre me fjalë dhe me shembull lajmëtarët e parë të fesë” (*shih. LG nr. 11; GS nr. 47-52; Gjon Pali II, Familiaris consortio, (FC), 1981, nr. 52-55*). Familja mbetet shkolla më e përsosur dhe më e pasur e njerëzimit, ku jetohet përvoja e rendësishme e dashurisë, besnikërisë, ndërimit të ndërsjellët dhe bashkëpunimi. Detyra kryesore e familjes është dhurimi dhe mbrojtja e jetës - trashëgimi i jetës – si dhe edukimi i fëmijëve me anë të virtyteve dhe vlerave për të ndërtuar dhe zhvilluar të mirën e personave dhe të bashkësisë.

Familja pa dyshim se është faktor tejet i rendësishëm për edukimin e fëmijëve dhe të rinisë. Në pedagogjinë moderne është e njohur “teorema e dyfishimeve”, që me fjalë të thjeshta domethënë: suksesi i jetës bashkëshortore kryesisht varet nga përvoja e familjes së prejardhjes, sepse ajo doemos reflektohet dhe përsëritet në jetën e mëvonshme.



Familje stubllase

Prandaj parakusht për sukses në jetën martesore është lindja, rritja, edukimi i shëndoshë dhe harmonik, ose ta themi me terminologjinë pak më shkencore, përplotësimi i roleve babë – nënë, vëllezër – motra, ose mossuksesi i shkaktuar nga konfliktet e roleve familjare.

Përpara me shekuj është folur për përleshjen apo konfliktin e brezave, gjeneratave dhe ky është një proces i natyrshëm. Tani mendoj se kjo është tejkaluar deri diku, sepse më s'ka as konflikte, por më tepër shkëputje mes brezave, që figurativisht mund ta themi edhe kështu: hallka kemi, por jo edhe zinxhirë, lamshin e kemi në dorë, por nuk po ia gjejmë fijen.

Prindërit nuk janë më shpeshherë model kulturor, fetar, shpirtëror për fëmijë, sidomos për rini, e cila kategorikisht dëbon autoritetin prindëror, deri diku edhe atë shkollor, fetar, shoqëror. Rinia e sotme e di një gjë: nuk duan të jenë më si prindërit e tyre, por çka është edhe më keq, nuk kanë ndonjë projekt, ide, edhe më pak ideale.

Kështu figura e nënës dhe e babës dukshëm është zbehur dhe ndoshta përjetohet një krizë e pashoqe në histori pikërisht lidhur me botëkuptimin e familjes.

Shkaqet e kësaj krize janë të shumta, por unë do t'i numëroj vetëm disa, ato që më duken më të rëndësishmet:

1. Privatizimi i lidhjeve afektive, i seksit dhe moralit, si dhe privatizimi i martesës dhe familjes, me parime si: punë për mua, sa më pëlqen mua, sa kemi dobi dhe interes të përbashkët...Për ne shqiptarër gjendja është edhe më e rëndë, sepse dikur martesë paraqitej si qëllim i jetës, prandaj njerëzit mendonin thjesht kështu: mjafton të martohesh mirë, ta gjejsh një burrë apo një grua të mirë, të shëndoshë, të bukur, inteligjente, sot do ta shtonim edhe me vizë... dhe çdo gjë do të jetë në rregull.
2. Familja gjithnjë e më tepër ngushtohet, sepse njeriu modern një pjesë të madhe të jetës e kalon në punë, jashtë shtëpisë, në marrëdhënie me të tjerët, aq sa shtëpia gati shndërrohet në bujtore, ku çiftat martesorë janë të lodhur, të harxhuar, të mërzhitur, dhe, si të tillë, më shumë ndeshen se takohen. Dikur mbarë shoqëria ishte e bazuar në familje, në martesë, në lindjen, rritjen dhe edukimin e fëmijëve, ndërsa sot mbështetet kryesisht në individ, në punë dhe në prodhim, në profesionalizëm, duke rrënuar kështu sidomos martesën dhe familjen.
3. Pluralizmi i mendimeve dhe i qëndrimeve, botëkuptimeve, popujve, gjuhëve, kulturave, feve... është një sfidë e madhe për mbarë njerëzimin. Dyndja moderne e botës i vështirëson bashkëjetesën, mirëkuptimin ndërnjerëzor, ndërfamiljar, ndëretnik, ndërfetar...
4. Fëmijë lindin gjithnjë e më pak, së paku në botën e të pasurve, dhe ajo pakicë kalon nëpër “duar të të huajve” në rritje dhe në edukim, sepse familja është e stërngarkuar me gjithçka, pra, s’ka kohë më për fëmijë.
5. Prindërit e frustruar dhe të porealizuar i ngarkojnë fëmijët me kërkesa dhe me pritje të pamundshme, sepse nëpërmjet tyre mendojnë se do ta realizojnë vetveten.

Familja stubllase sot është e përgjysmuar, e copëtuar dhe mjaft e ngarkuar, sepse gati s’ka më shtëpi dhe familje komplete, pa dike në botën e jashtme. Në fillim të viteve 70-të mërgimi ishte vetëm për ndonjë punëtor, nëpërmjet sipërmarrjeve apo në mënyrë private, për të fituar më tepër dhe për t’ia siguruar familjes jetën. Jeta e vështirë, rrethanat politiko-shoqërore të viteve 80-të, sidomos pas vitit 1989 të heqjes së autonomisë së Kosovës, ndikoi që punëtorëve t’iu bashkangjiten edhe familjet e tyre. Kjo gjendje ka krijuar vështirësi të shumëfishtë për të gjithë, si ambientimi në botën e jashtme, ndarja dhe shpëputja, shpartallimi i familjes, rrezikimi i shkrirjes në botën e huaj, mospërfilljen e botës perëndimore, mallin, mërzinë... Dikush këtë gjendje të mjerë shpirtërore e ka përshkruar kështu: Na mbyti malli dhe pagjumësia!

Lufta e vitit 1999 dhe paslufta shkaktojnë ende tendenca të largimit nga vendlindja. Mërgimtarët tashmë vite të tëra janë në botën e jashtme, kanë

krijuar stilin e jetës dhe të punës perëndimore, janë të përmalluar për vendlindje, për Kosovë, mirëpo fëmijtë e tyre, sidomos rinia, si duket, nuk i ka më këto ndjenja kombëtare, fetare, dhe s'ka dëshirë as mundësi të kthehet më, sidomos për shkak të papunësisë dhe të pasigurisë.

Sot familja stubllase është në krizë të madhe të identitetit. Në Stubëll kanë mbetur kryesisht të moshuarit dhe ata që nuk kanë mundësi të mërgimit, të varfërit, si dhe një pjesë e vogël e atyre që janë të pasur. Për herë të parë hasim në dukurinë e të moshuarve të braktisur dhe të vetmuar, të sëmurëve pa përkujdesje familjare, shpeshherë edhe të varfër. Kjo gjendje shkakton dhembje, mërzë, lodhje, depresion dhe dëshprim, sepse nuk kanë më shoqërim, janë të dëbuar dhe të harruar nga të gjithë. Shpesh dëgjoen këso vlerësimesh dhe vështrimesh: Erdhi koha e keqe për të gjithë, sidomos për fëmijë dhe për të vjetër. Dikur urimi më i bukur për fëmijë ishte: U rritsh dhe u plaksh! Sot më s'është urim por mallkim!

Rinia gati tërësisht është pa punë dhe pa ardhmëri, aq sa ëndërron vetëm perëndimin, punësimin, fitimin dhe nuk zgjedh mjete për të arritur këto qëllime. Kështu tashmë vepron edhe dukuria shëmtuese e martesave “për vizë apo më vizë”, me vajza apo gra europiane. Kjo dukuri tani ka marrë edhe trajta tjera; edhe ndër shqiptarët po bëhen fejesat dhe martesat me “interes”, me viza apo për viza, për t'u larguar nga Kosova. Familja deri diku e çrregulluar, mos të them e shpartalluar, fatkeqësisht nuk e ka më rolin primar dhe vendimtar në edukimin e fëmijëve dhe të rinjve. Shumë prindër sot janë ose permisivë – lejojnë çdo gjë, i kanë lëshuar prej dore “frejtë”, sepse ndihen të paafte dhe të papërgatitur për kohën dhe rrethanat e sotme; ose janë restriktivë – diktatorialë, të rrebtë, ndalojnë dhe pengojnë çdo gjë, deri sa fëmijtë mos t'iu dalin krejtësisht prej dorës. “Diktatorët” e vërtetë në familje nuk janë më si dikur prindërit, i zoti apo e zonja e shtëpisë, por fëmijët dhe rinia, sepse atyre s'guxon t'iu mohohet apo mungojë asgjë. Ky lloj edukimi nuk i përgatit fare për jetën e mëvonshme, për flijime, rregullore, disiplinë, por për anraki dhe papjekuri për tërë jetën.

Largimi i rinisë mashkullore para, gjatë dhe pas Luftës 1999 në Stubëll ka shkaktuar edhe dukurinë e shumë vajzave të pamartuara, një lloj “virgjërie të dhunshme” dhe pa dëshirë për shkak të rrethanave jetësore, sepse harku edhe ashtu i ngushtë dukshëm është përkufizuar. Kjo gjendje pa dyshim shkakton pakënaqësi, mospranim, dëbim, frustrim, mund të jetë edhe burim i jetës së panjerëzishme, sepse edhe ashtu nuk kanë më gjasa për martesë dhe kurorëzim. Kjo dukuri vërehet gjithkund në Kosovë, por ende nuk është studiuar fare, dhe nuk janë marrë hapa për ballafaqim, eventualisht edhe për të kërkuar dhe gjetur ndonjë zgjidhje sa më të përshtatshme. Ndoshta duhet të shqyrtojmë mundësinë e themelimeve të

lëvizjeve të krishtëra, apo të grupeve të ndryshme të uratës, të meditimeve, të bamirësisë, të përkujdesjes për të moshuar dhe të sëmurë, punëtori për punëdore, kurse të rrobaqepsisë apo të kuzhinës... për motivimin sa më të mirë të jetës së tyre. Askush s'mund të jetojë sido, rastësisht, pa bindje dhe motive për jetë dhe për punë, pa planifikim dhe mundësi për realizim, për ardhmëri. Pasi në kulturën tradicionale shqiptare femra kryesisht s'ka pasur rol tjetër përpos fejesës, martesës, jetës familjare, lindjes dhe edukimit të fëmijëve, nëse mungon kjo atëherë jeta duket se s'ka më kurrfarë kuptimi dhe domethënie, mbetet disi e padefinuar dhe e parealizuar, sepse i mungon roli natyror i gruas, nënës. Nëse vajzave iu "imponohet" mosmartesa, atëherë duhet të gjejmë edhe mënyra të tjera për realizimin e jetës dhe të vetvetes. Sigurisht se martesa, jeta familjare, lindja dhe edukimi i fëmijëve është një mision i shenjtë për femrën, për njeriun, por nuk është i vetmi, sepse edhe femra para së gjithash është person, qenie njerëzore, e pastaj familjare dhe shoqërore. Këto janë sfida dhe dukuri të reja dhe të panjohura për ne dhe kërkojnë së paku propozime dhe organizime konkrete, mos të them edhe zgjidhje përkatëse.

1. 4. ATËSIA DHE AMËSIA ME PËRGJEGJËSI

Perëndimi është në një krizë të madhe, sepse jeton në frikë, mos të them në fobi të dyfishtë, e lufton edhe jetën edhe vdekjen, por kuptohet pa sukses. Dëbimi i zanafillës së jetës, fëmijëve, në mënyra të ndryshme, me dështime, mjete kontraktive e deri te absurdi i matesës me kusht: martesa po, fëmijë jo, manipulimi i jetës, klonimi... janë shenja të qarta se jeta ka humbur vlerën dhe shenjtërinë. Perëndimi po ashtu frigohet edhe prej vdekjes, duke i "anësuar" të moshuarit nëpër qendra apo strehimore, sepse e pengojnë jetën aktive, janë vetëm barrë për familje dhe për shoqëri.

Kultura shqiptare historikisht mbështet dhe përkrah jetën sipas parimit: *mjerë ajo shtëpi që s'ka pleq dhe fëmijë, ose: s'ka shtëpi pa pleq dhe pa fëmijë*. Kjo edhe na ka shpëtuar prej asgjësimit dhe asimilimit. "Martesa dhe dashuria martesore sipas natyrës së tyre kanë për qëllim lindjen dhe edukimin e fëmijëve. Pa dyshim fëmijët janë dhurata më e madhe edhe për prindërit..." Dikur atësia dhe amësia ishin pothuaj proces natyror, biologjik, fiziologjik, dhe vetëm më vonë, me kohë shndërrohej edhe në proces psikik, etik, moral, shpirtëror dhe kulturor.

Fëmijët sot kanë shumë kërkesa dhe familja kryesisht mundohet t'ua plotësojë nevojat ekonomike, finansiare, por mungojnë mjaft ato ndërnjerëzore, afektive, morale, fetare, shpirtërore, kulturore. Deri diku

është lehtë fëmijës t'i dhashë diçka, si veshmbathje, ushqim, para, por shumë më vështirë është dhurimi i vetvetes, kujdesi, puna, edukimi, flijimi me dashuri dhe për dashuri. Ky dhurim dhe komunikim s'ka çmim dhe është parakusht për çdo zhvillim dhe edukim. Konsumizmi, hedonizmi, materializmi, standardi jetësor, rrethi e ngarkon, ndoshta edhe e robëron familjen moderne. Erich Fromm-i thotë se kujdesi për fëmijë ka dy aspekte: kujdesi dhe përgjegjësia për jetën e tyre, si dhe dashuria me të cilën fëmijës i dhurohen vlerat, ndjenja e sigurisë dhe e fatbardhësisë, vullneti për jetë dhe për punë.

Pa fuqinë e fesë dhe frymëzimin e dashurisë, Zotin, s'ka atësi apo amësi me përgjegjësi. Përgjegjësinë mund ta ndajmë kështu: ndaj Zotit, burimit të jetës dhe të dashurisë, ndaj të tjerëve, sidomos ndaj fëmijëve, dhe ndaj vetvetes, për ta zbuluar, pranuar dhe zbatuar planin e Zotit në jetën tonë. Gjon Pali II (në FC) e definon rolin e prindërve në edukim si qenësor, burimor dhe primar, të pazëvendësueshëm dhe themelor, pa të cilin s'do të ketë as edukim jashtëfamiljar. Fuqia e këtij edukimi është "dashuria atësore dhe amësore", e cila është në shërbim të jetës, dhe si e tillë është "shpirti, prandaj edhe masa që frymëzon dhe udhëheq tërë mundin konkret rreth edukimit" (FC nr. 36). Prindërit, thënë figurativisht, janë pasqyra në të cilën fëmijët shihen dhe njihen, sepse nëse u mungon ndjenja e dashurisë së vërtetë, atëherë kurrë nuk do të jenë të sigurt në jetë dhe në veprimtari. Bartësit e jetës dhe të vlerave janë prindërit. Dhe vetëm ata mund ta vënë gurthemelin e edukimit personal, familjar, shoqëror, me këtë kuptohet edhe fetar dhe moral. Kjo ngjan në gjirin familjar në mënyrë spontane, natyrore, sepse nëpërmjet prindërve, vëllezërve, motrave, marrëdhënieve ndërfamiljare fëmijët aftësohen, përgatiten, edukohen edhe për marrëdhënie jashtëfamiljare.

"Familja disi është shkolla më e plotë e njerëzimit. Mirëpo, për të zbatuar plotësisht jetën dhe misionin e saj, lypset ndërrimi i sinqertë i mendimeve me shoqi-shoqin, si dhe këshillimi mes bashkëshortëve dhe bashkëpunimi më i kujdeshëm në mes të prindërve dhe fëmijëve" (Gaudium et Spes, nr. 52).

1. 5. ROLI I GRUAS NË FAMILJE

Problematika e gruas nuk është aspak vetëm çështje femërore, por para së gjithash njerëzore, botëkuptimore, pra, e të gjithëve, sepse ndikon në çdo fushëveprim jete: në fe, traditë, kulturë, politikë, ekonomi, shkencë, art... Në të kaluarën jeta dhe puna varej kryesisht prej fuqisë fizike, trupore, ndërsa fitimi apo puna jashtëfamiljare ishte vetëm mashkullore, kështu që

mashkulli kishte dukshëm përparësi dhe privilegje, ndërsa femra trajtohej si e dobët, e pambrojtur, e varur prej dikuj, disi qenie e dorës së dytë.

Shoqëria e sotme moderne është kryekëput mashkullore dhe materialiste, sepse thekson fitimin, punësimin, suksesin, namin dhe femra në këtë “garë” humb pa ia nisur lojës, sepse ose e mohon vetveten duke e imituar mashkullin, ose “shitet” dhe tjetërsohet duke pranuar rolin e nënshtrimit, por pa sukses dhe me plot trauma për të gjithë. Pa vetëdijësim kulturor, botëkuptimor, shpirtëror (fetar), pranim të ndërsjelltë të dy gjinive si mundësi përplotësimi dhe dhurimi, nuk mund të lirohem prej paragjyqimeve, rivaliteteve, luftimeve, animeve dhe skajimeve të dëmshme.

Femra shqiptare është qenie njerëzore, familjare dhe shoqërore, dhe, si e tillë, pjesëmarrëse aktive në jetë dhe në punë, pa tretjen e identitetit dhe personalitetit bazor, si nënë, grua, motër, bijë, si zemra flijuese dhe dhuruese për të gjithë. Mos ta harrojmë parimin: Pa njeri s’ka as familje as shoqëri.

1.6. BASHKËSHORTËSIA – RAST ZHVILLIMI DHE REALIZIMI

Shumë njerëz sot janë të çrrënjësuar prej rretheve të tyre, jetojnë dhe punojnë në rrethe të panjohura dhe pluraliste. Kjo gjendje e harxhon dukshëm energjinë e jetës me përshtatje, punë, pësime, hurxhe dhe pakënaqësi, të cilat pastaj barten edhe në familje.

Lufta për jetë, punë, sukses, fitim, pasurim, garimi në vazhdimësi, i rëndon dukshëm edhe marrëdhëniet martesore dhe familjare, sepse shoqëria bashkëkohore mbështetet më tepër mbi atë çka ke se ajo kush je. Ky copëtim apo disintegrim dhe depersonalizim i njeriut krijon ndjenjën e vetmisë dhe të pasigurisë, të rrezikimit dhe të shqetësimit, ku martesë dhe familja mund të paraqitet si një lloj ikje nga vështirësitë, strehim dhe mbrojtje nga bota anonime, apo një “besëlidhje në dy kundër botës”. Materializmi dhe hedonizmi njeriun e projekton në këtë drejtim: shëndeti, rinia, pasuria, sukcesi... duke premtuar shumëçka, por pa dhënë gati asgjë. Njeriu piqet dhe formohet fiziologjikisht deri në moshën e rritjes, kurse psikologjikisht, moralisht, shpirtërisht, kulturalisht gjatë tërë jetës, si edhe vetë jeta që gjithnjë është vazhdimësi dhe risi. Bëhet gabimi i madh në të edukuar, kur fëmijëria dhe rinia shqyrtohen vetëm si faza përgatitore për jetë, ndërsa martesë si qëllim dhe kuptim jete, fazë përfundimtare e formimit, e jo si rast, mundësi zhvillimi dhe realizimi. Këtë popull e ka thënë bukur: *Rrno e mëso!* Zhvillimi i personit në martesë do ta vështrojme në dy drejtime: ana individuale, të jesh vetvetja dhe ta zbatosh jetën tënde;

dhe kohezioni, lidhjet dhe marrëdhëniet e njeriut me të tjerët, me botën që na rrethon, apo procesi i socializimit. Fëmija lind si një tërësi dhe vetëm me kohë dhe me edukim, “specializohet” për shikim, dëgjim, ecje, të folur... duke e krijuar kështu personalitetin bazor. Ky është procesi i individualizimit dhe harmonizimit në brendinë tonë, pa të cilin s’ka as kohezion, drejtim, orjentim, lidhje me të tjerët.

Deri në rini theksohet më shumë individi, unë, ndërsa me rini nëpërmjet dashurisë njeriu e kërkon vetveten në të tjerët, në partnerizëm. Populli ka thënë qysh moti: *Kush nuk është për veti s’është as për në gjeti!* Nëse nuk jemi vetvetja, në rregull dhe në harmoni të brendshme, atëherë s’kemi guxim, fuqi, siguri të hapemi ndaj të tjerëve, sepse jemi të bllokuar, të paralizuar, të lakuriqësuar. Ja një shembull nga jeta e përditshme: nëse dikush trokit në derë, por s’jemi të veshur dhe të mbathur, shtëpia s’është në rregull, atëherë nuk e hapim derën, nuk dalim përjashta, mundohemi mysafirin ta ndalim te dera, në hyrje, në oborr, që mos të koritemi.

Procesi i harmonizimit mes individualizimit dhe kohezionit, socializimit, ka rëndësi jetësore për unin tonë dhe për integrimin e njeriut me vetveten dhe me të tjerët. Duhet pranuar veten si trup, moshë, pamje e jashtme, brendi, gjini me tipare dalluese, pra, në tërësi, për t’u aftësuar që t’i pranojmë edhe të tjerët, sidomos në bashkëshortësi dhe në familje.

Martesa ndihmon për ta zbuluar tjetrin, çiftin martesor, jo më si fëmija nënën në shërbim dhe në funksion të tij, si objektin e tij, apo edhe si pjesën e jetës së tij, por si subjekt të dalluar dhe të barabartë për krijimin e bashkimit në dallime, në përplotësime mashkull-femër. Kjo është risia e dashurisë së ndërsjellët, e cila nuk harxhohet kurrë. Martesa është fazë e rëndësishme në jetë për arritjen e pavarësisë prej prindërve, për marrjen e përgjegjësisë personale, unë, ndërpersonale, unë dhe ti, shoqërore, unë-ti-ne, për fëmijë, familje dhe shoqëri. Bashkëshortësia mundëson integrimin e individit në shoqëri nëpërmjet familjes. Në martesë mund të arrihet faza e re e individualizimit apo identifikimit të ri në ne, si diçka e përbashkët që është shumë më e madhe se unë dhe ti veçmas apo ndamas. Në matematikë $1+1$ bëjnë dy, në jetë, e sidomo në dashuri shumë më tepër.

Kohezioni në dashuri nuk është një lloj simbioze, bashkimi si ai mes nënës dhe fëmijës, ku fëmija mvaret tërësisht prej nënës dhe ku nëna është plotësisht në shërbim të tij, por më shumë si lirim prej egoizmit dhe egocentrizmit në reciprocitet, në dashurinë flijuese dhe dhuruese, sepse në dashuri dy qenie njerëzore “janë një, megjithatë mbesin dy.” Dashuria nuk është fuzion, shkrirje e dy personave, por kohezion, ku secili mbetet vetvetja, por së bashku janë dhe kanë shumë më tepër se

secili vetvetiu. Në martesë vjen në sprovë UNË – personi, karakteri, natyra, që hapet dhe bashkëjeton dhe dashuron TJETRIN, i cili apo e cila më nuk është rrezikim, por siguri dhe dashuri për diçka krejtësisht të re dhe të panjohur, të papërsëritshme, për ndarjen e tërësishme të jetës me tjetrin me një ndjenjë të thellë të përkatësisë së përbashkët: jemi njëri me tjetri, njëri për tjetrin. Kush nuk i ka kaluar mirë këto dy faza jetësore, të individualizimit dhe të socializimit, në parterin kërkon mbrojtje, siguri, përkrahje, gjë kjo që shprehet në forma të ndryshme, si p. sh. sundimi ndaj çiftit martesor, te shqiptarët kryesisht burrat, ose nënshtrimi i plotë, te grate, si një lloj marrëdhënie primordiale nëna dhe fëmija, mvarësia e plotë dhe patologjike. Nëse faza e kohezionit nuk është plotësuar mirë, atëherë tjetrin nuk e çmojmë, nderojmë ashtu si është, por më shumë e trajtojmë si vegël për nevojat tona, si fëmija i cili e “shfrytëzon” nënën për nevojat jetësore: ushqim, pastrim, kontakt lëkurë me lëkurë. Kush ka mbetur i fiksuar në këto dy faza s’ka aftësi dhe mundësi për partnerizëm, bashkëshortësi, por vetëm për përdorim dhe manipulim funksional me partnerin apo partnerën.

Si mund të zgjidhet ky konflikt bazor mes individualizimit dhe kohezionit, socializimit?

Me njohjen dhe pranimin e gjendjes reale dhe me komunikim të vashdueshëm me sinjeritet dhe me dashuri. Mes burrit dhe gruas duhet të jenë të hapur të gjitha kanalet e komunikimit, sepse përndryshe do të mbesin gjithnjë dy të huaj dhe të panjohur, të cilët komunikojnë me trup, por jo edhe me mendje, vullnet, liri, zemër, me tërësinë e qenies njerëzore. Mendja dhe zemra duhet të lidhen dhe shprehen me gojë apo fjalë, aq sa është e mundshme, por edhe më tepër me komunikim joverbal. Dashuria e vëretë është e mundshme vetëm nëse ka komunikim të vazhdueshëm dhe të gjithanshëm mes partnerëve. Dashuria është fryti i çdo stine, çdo moshe, është kuptimi dhe burimi i jetës dhe i lumturisë, fuqia që na harmonizon në brendi me vetveten, me të tjerët, me TJETRIN, Zotin, i cili është si frymëmarrja dhe pa të cilin s’kemi asgjë. Populli thotë mirë: *Të piqemi e mos të digjemi!* Pjekuria më e madhe e jetës është ekuilibri, drejtpeshimi në ne dhe me të tjerët, si trupi i njeriut, ku gjymtyrët janë njësi të veçanta, por e krijojnë edhe tërësinë që quhet njeri.

Mu për këto arsye shkolla e jetës dhe e dashurisë nuk përfundon kurrë, është sfidë e përditshme dhe nga kjo kryesisht mvaret çdo sukses i jetës dhe i veprimtarisë. Kjo gjendje shtron para nesh shumë pyetje, por shtron edhe shumë detyra dhe mundësi baritore. Gjithnjë e më tepër hetojmë shkëputjen e komunikimit dhe të bashkëpunimit mes familjes, shkollës,

Kishës, shoqërisë dhe pa këtë harmonizim, së paku, familja – famullia, s’ka sukses në edukim, sidomos në edukimin fetar. Kjo gjendje shkakton deri diku dezintegrim dhe dezorientim, si në personin, ashtu edhe në familje, mirëpo familja është më se e domosdoshme dhe ajo nuk ka alternativë, por fill lind pyetja: çfarë është apo duhet të jetë familja sot?

Mundësia e parë do të ishte kjo: t’i kthehemi vetvetes, brendisë sonë dhe të kërkojmë në mes anëtarëve dhe në antarë t’i gjejmë fuqitë e nevojshme për krijimin e drejtpeshimit të ri dhe solidaritetit të thellë.

Vlerat e mirëfillta tradicionale duhet ruajtur dhe kultivuar, si dashurinë dhe nderimin e jetës dhe të familjes, mikpritjen, bujarinë, besnikërinë, kujdesin për të varfër dhe të mjerë...Vlerat e reja të botës bashkëkohore duhet t’i përvetësojmë: edukimin personal dhe ndërpersonal, bashkëpunimin, bashkëjetesën, tolerancën ndëretnike dhe ndërfitare, dialogun, komunikimin, solidaritetin, faljen...Vetëm kështu e vjetra dhe e reja do të gërshetohen dhe begatohen në të mirë dhe në dobi të të gjithëve.

II. PENAT E STUBLLËS

Për Stubllën, për historinë e saj, pozitën gjeografike është shkruar relativisht mirë në kulturën e shkrimit shqip. Veçanërisht, pas shembjes së ish sistemit totalitar, rajoni i Stubllës është bërë objekt i diskutimeve të shumta në kuadër të hulumtive në shumë disiplina brenda etnisë sonë: në historiografi, në arsimimin kombëtar, në muzikologji, etnografi, etnologji. Gjitha këto, duke e pasur parasysh, se ky vend nëpër zikzaket shekullore, atëherë kur etnia jonë ishte pre e orkestrimeve të shumta për shkatërrim, qëndroi stoikisht karshi të gjitha hordhive shekullore.

Stublla, vend në rajonin e Karadakut (apo Mali i Zi i Shkupit), gjatë gjithë historisë sonë nacionale, ka shndritur duke u spikatur në shumë plane. Dimensionet e së cilës kanë pasur rol të rëndësishëm në ruajtjen, forcimin e identitetit shqiptar, duke ndërlidhur në mënyrë zingjirore dy komponentet: të kaluarën dhe të tashmen, për të ndërtuar të ardhmen. Ajo shenjon një precedent në pikëpamje të shkollimit dhe avancimit të dijes. Figurat që dolën e dalin nga gjiri i saj, denjësisht janë të shtrirë në mbarë hapësirën kombëtare shqiptare, madje edhe në arenën ndërkombëtare.

Me qëllim, të paraqites së një pasqyre të thuktë, të penave të Stubllës, synojmë të shkoqisim ato figura, bijë dhe bija, prej gjirit të Stubllës, që shenjuan rezultate në fusha të ndryshme të dijes, shkencës dhe kulturës së shkrimit shqip, traditë kjo e fundit, e cila në Stubëll është e lashtë: kemi parasysh shkëndijat e shkollimit shqip ndër shekuj, si dhe përfundimisht

legalizmin e shkollës shqipe në Kosovë më 1905.

Në Stubëll kemi dy kategori të penave të ndërlidhura me dy komponente: *intelektualët* dhe *shkrimtarët*: këto përkufizojnë dhe vlerësojnë dimension e veprimtarisë së kulturës së diturisë, punës intelektuale dhe kulturës së shkrimit në Stubëll.

Stublla, në shekujt e qenësimit shekullor, ka lënë gjurmë të rëndësishme në momentet e rëndësishme nacionale: si në formësimin e një kulture shkollimi, e cila është e lashtë ndër trojet shqiptare, pastaj në ruajtjen, kultivimin e identitetit shqiptar me gjitha tiparet shenjësuese dhe dalluese (kujtojmë Martirët e Karadakut të kohës së Tanzimatit, 1846- 1848, në të cilën periudhë, nga Stublla dhe fshatrat për rreth u flijuan dhjetëra qytetarë për të ruajtur identitetin shqiptar, kur anë e kënd ndër troje shqiptare, degradimi i identitetit shqiptar ishte në përmasa rrënoqethëse).

Në Stubëll kategoria e dy shtresave që përbëjnë kulturën intelektuale, shkrimtarët dhe intelektualët e sferave tjera, janë të shumtë. Nga gjiri i Stubllës, kanë dalur pena që njihen anë e kënd botës shqiptare, por edhe më gjërë, si Dr. Don Lush Gjergji, Dr. Don Gjergj Gjergji – Gashi, Prof. Dr. Engjëll Sedaj, Isak Ahmeti e të tjerë të gjeneratës së re që janë në këtë linjë. Kjo është njëmendësi *sui generis* për një popullsi të vogël që ka nxjerrë njerëz me përmasa mbarëkombëtare dhe tejkombëtare .

Stublla e Epërme ka shumë intelektualë. Vargu i tyre, në krashim me popullsinë, me shtrijren gjeografike, me rrethanat historike, është tejet i madh. Ngritja dhe shkollimi në Stubëll janë rrjedhojë e zhvillimeve të tërësishme për emancipim. Në dimensionet edukative, Stublla ruan kontinuitetin e krijuar nga të parët.

Paraqitja e temës së përkufizuar më lart kap dy segmente: në rend të parë intelektualët e shumtë, të cilët rrjedhin nga sfera religjioze; të cilët në Stubëll janë shembull dhe, të cilët, përveç veprimtarisë baritore, kurdoherë janë marrë në mënyrë shumë dinjitoze edhe me shkrimin shqip, rezultatet e veprave të të cilëve u takojnë shumë drejtimeve: historiografisë, religjionit, bibliografisë, letërsisë, etj. Po ashtu, fshatit Stubëll nuk i mungojnë edhe intelektualët e shumtë laikë, të cilët në kulturën e shkrimit kanë dhënë rezultate të çmueshme.

Kulturës së arsimit Stublla i ka dhanë Engjëll Zefin, veteranin e arsimit në Kosovë, fryt i të Shkollës së Shkodrës dhe çetës së klerikëve shkodranë.

Në kategorinë religjioze, nga e kaluara jo e largët, kujtohen me pietet të lartë dy meshtarë të kishës së Stubllës (Don Zef Ramaj dhe Don Dedë Ramaj), të cilët kujtohen kurdoherë për kontributin e tyre në ngritjen e vetëdijes sonë. Për arsye të rrethanave, nga këta nuk kemi diçka të shkruar, por dokumentet e shumta flasin, se këta dy pishtarë, me dije,


shqiptarizëm e edukatë të lartë qytetare, si dhe me qëllime të larta, kanë mishëruar përjetësisht binomin e shenjtë Atme e Fe, në thadrimin e tyre në pasardhësit.

Ndërsa, si veprimtari intelektuale, me përmasa të gjera, nga gjiri i Stubllës kemi figura të përmasave universale të veprimtarisë së gjithanshme intelektuale (Don Lush Gjergjin, intelektualin, humanistin e madh dhe biografën e suksesshëm të Nënë Terezës dhe Don Gjergj Gjergjin – Gashi, historiograf me dokumente të shumta të prezentuara për së pari herë në historiografinë shqiptare).

Prifti i devotshmëm dhe intelektual i vyer Don Gjergj Gjergji – Gashi, përveç veprimtarisë misonare, ka dhënë rezultate edhe në kërkimet historike, si në hulumtimin dhe sistematizimin e shumë dokumenteve arkivore, për periudha të ndryshme historike (veçanërisht për periudhën e Shtetit të Arbërit, për fenomenin e laramizmit, për periudhën e Skënderbeut dhe veçanërisht për periudhën e Martirëve të Karadaktit). Veprimtaria e tij shkencore, brenda historiografisë shqiptare, dallohet për stabilitet dhe argumentim të efektshëm. Kontributi i tij shquhet edhe në veprimtarinë shoqërore dhe politike (në proceset e dekompozimit të ish sistemit totalitar në Shqipëri, si dhe në procesin e liritimit të Kosovës nga zgjedha serbe).

Ndërsa një intelektual tjetër, i kalibrit të përmasave botërore, autor i rreth pesëdhjetë librave, është Don Lush Gjergji. Veprimtaria e tij është e fokusuar në shumë segmente: dallohet në dimensionet e aktiviteve humanitare (themelues dhe bartës kryesor i Shqoqatës Nënë Tereza). Në këtë kontekst, edhe roli i tij, në proceset politike në hapësirat shqiptare ka qenë fundamental. Në këtë

këndvështrim, duhet të theksohet edhe kontributi i tij në planin e Pajtitimit të Gjaqeve ndër shqiptarë, i cili së bashku me Anton Çettën dhe Imzot Nikë Prelën, ishte në ballë të kësaj ngjarjeje të madhe historike. Në planin ndërkombëtar, Don Lush Gjergji është anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Bashkimit Evropian. Në literaturën e përbotshme, Don Lush Gjergji është autor autoritativ në biografën e Nënë Terezës, librat e të cilit për këtë portret të madh, janë përkthyer në dhjetra gjuhë botërore. Rrjedhimisht, Don Lush Gjergji ka shkukur me mjaft shkathtësi edhe për femrën shqiptare, studimi i së cilit, është një indicie e re, krejtësisht e padiskutuar në letrat shqipe. Po ashtu një risi e veçantë e sjellur në letrat




shqipe nga ky burrë është gërsheti i psikologjisë dhe përshpirtërisë/spiritualitetit të krishterë; nga kjo fushë dallohen mbase dhjetë libra të vlerësuara si kryevepra, të shkruara edhe në gjuhë të huaja. Ky autor i madh, në hapësirat shqiptare, vlersohet lart edhe për kontributin e tij të gjithanshëm në sensibilizimin e nacionit. Diskutimet e tij publike për çështjen e Kosovës, për proceset në Kosovë, për kapërcyelljet shqiptare, në fund të shekullit XX, sfidat me të cilat ballafaqohet kombi, kanë qenë një katalizator për ndryshime pozitive.

Ndërsa po nga Stublla, ka dalur edhe Don Ndue Gergji, i cili krahas veprimtarisë baritore, merret intenzivisht edhe me përkthime dhe me shkrime nga fusha të ndryshme. Don Ndou, shkruan poezi, shkruan për familjen, për figura të spikatura botërore, për religjionin. Të një rëndësi të dorës së parë janë tekste të edukative-psikologjike.

Nga ky brez dhe një brez më i ri, kemi edhe shumë prifërinj, të cilët me veprimtarinë e tyre kanë kontribuar në ngritjen e kulturës shqiptare në tërësi dhe kishës sonë në veçanti. Në këtë plan vlen të përmenden Don Aleksadër Kola (*bashkëpunor disavjeçar i revistës Drita*), pastaj brezi i Don Marjan Demajt (*autor i një libri meditativ*), Don Marjan Ukajt (*autor i një monografie*), Don Izak Dodaj, Don Vinkë Palit (*shkruan poezi*), Don Ndue Ballabanit (*editor i disa librave dhe botues*), Don Albert Demajt (*bashkëpunor i revistave fetare*), Don Kristë Gjergjit, Don Albert Kristajt, Patër Marjan Lorencit OFM, Don Agim Qerkinit (*liturgjist*), Don Fatmir Koliqit (*shkruan artikuj shkencorë dhe përkthen nga kroatishtja dhe gjermanishtja*), Don Nikson Shabanit, Don Kolë Gjergjit (*bashkëpunor i revistave fetare*), Don Anton Ukajt.

Ndërsa, në kategorinë e laikëve, vlen të përmenden disa intelektualë, të cilët aktivisht merren me shkrime dhe kulturë shkrimi. Në këtë kontekst dallohet Engjëll Sedaj, autori i shumë studimeve me rëndësi për kulturën shqiptare, një intelektual i kalibrit të lartë. Sikurse në studimet letrare, njashtu edhe në raporet e letërsisë shqipe me Biblën, si dhe letërsinë antike, Sedaj ka dëshmuar përkushtim, dije të thellë e të gjithanëshme. Engjëll Sedaj është profesor i filologjisë në Universitetin e Prishtinës, njashtu është marrë dhe merret aktivisht edhe me çështje tjera shoqërore dhe politike.

Nga fshati i Stubllës ka dalur edhe shkrimtari Isak Ahmeti, veprimtar studioz dhe letrar. Emri i tij në letërsinë shqipe është i një rëndësie të veçantë. Ahmeti është autori i shumë studimeve me vlera të



dukshme në gjithë kulturën shqiptare. Merret me studime shkencore mbi të kaluarën e trevave tona, shkruan poezi, përkthen poezi nga gjuhë të huaja (gjermanisht dhe italisht) në shqip.



Tradita intelektuale e shkrimit në Stubëll vazhdon edhe në ditët e sotme, duke formësuar pishtarë të rinj në fusha të ndryshme të shkrimit. Kësaj tradite i përket edhe Engjëll Koliqi, poet dhe gazetar i disa gazetave dhe radiotëlvizioneve. Njashtu poeti Sarë Gjergji, me poezitë e tija është bërë zë origjinal në letrat shqipe. Vargëzimi i tij ngulitet thellë në traditën e stërllashtë të Tokës arbërore. Ai di t'i pikasë e nyjëzojë me mjeshtëri të gjitha ndjesitë, të thëna e të pathëna kombëtare.

Një varg emrash poetësh e poeteshash nga Stublla do të ishte i gjatë, ngase aty këndohet me pietet ndaj atdheut e kulturës së krishterë. Prej tyre që kanë botuar libra poezie do t'i dallojmë dy poetesha: Zahide Ukajn dhe Marie Nikollën. Zahidja është poete lirike. Poezitë e saja me disa përmbledhje shkoqisin dashurinë sublime për Stubllën, për stubllasit, kurse dhe Marie Nikolla, e cila është krejt e re, ka pasion të theksuar për poezinë.

Një brezi i ri i inelektualëve që shkrujanë nëpër lëmi të ndryshme me pasion; për të kaluarën shqiptare, për shkencat e letërsisë, arkivat dhe drejtën shqiptare dhe atë ndërkombëtare (Albert Ramaj, Zef Ahmeti dhe Ndue Ukaj).

Kategori e veçantë intelektualësh nga Stublla janë ata që nuk kanë kanë shkruar deri tash, por që në profesonet e tyre kontribuojnë dukshëm në aftësimin e në ngritjen e gjeneratave të reja. Ata ushtrojnë detyra të ndryshme profesionale, si *drejtorë shkollë, profesorë, mësues, pedagogë, juristë, arkitektë, mjekë* e shumë të tjerë studentë që studiojnë nëpër universitete shqiptare e në botën perëndimore dhe që, s'ka dyshim, po spikasin në formimin e tyre profesional.

Kultura intelektuale në Stubëll shkon natyrshëm nëpër binarët e saja e ngritet drejt kulmeve të saja. Aty ky ka lindur refleksioni i veçantë për të bukurën dhe të mirën shpirtërore dhe materiale, aty lindin pena për shpirtin e njëmendtë njerëzor.




3. TIPARET ETNOGRAFIKE TË STUBLLËS

Në rastet kur dëshirojmë ta njohim trashëgiminë etnokulturore të një vendi, kjo do të thotë se duhet diskutuar tepër gjerësisht shfaqjet dhe dukuritë e ndryshme shoqërore që i takojnë disiplinës shkencore të quajtur etnologji - antropologji kulturore e shoqërore. Me supozimin se shumë çështje të domosdoshme për një përfshirje informative janë shtruar nga koautorë të shumtë të kësaj monografie informative jubilarë të Stubllës së Epërme, si njërin ndër vendbanimet shumë karakteristike të Karadakut (më tutje Stublla), unë do të ndalem vetëm në disa problematika të kulturës popullore, si shprehja më e dallueshme e kulturës materiale, shpirtërore, shoqërore e artistike. Për arsye të natyrës së kësaj monografie, qasja ndaj problematikave gjegjëse do të jetë fare e përgjithësuar.

Për ta vështruar gjerësisht jetën e njeriut, është e logjikshme që të fillojmë me veprimtarinë ekonomike, pikërisht me bujqësinë e blegëtorinë si veprimtari bazë të ekzistencës. Theksojmë që në fillim se të dhënat e këtij shkrimi i referohen kryesisht kohës nga gjysma e dytë e shekullit XIX e këtej.

Historikisht është e njohur se bujqësia është e lashtë sa edhe vetë komuniteti i parë njerëzor. Poashtu janë të lashta edhe veglat e punës për punimin e tokës. Kështu p.sh. forma më primitive e parmendës është evidentuar në



*Plak stubllas
me plis
(vitet e 70-ta)*

*Të rinjtë stubllas
me qifteli
(vitet e 80-ta)*

Mesopotami dhe në Egjiptin e lashtë, dhe mendohet se i përket kohës së mijëvjeçarit të IV-III para Krishtit (Khs. S. Anamali, *Arkeologjia dhe bujqësia*, Tiranë 1980, f. 20; S. Shkurti, *Tradita bujqësore të shqiptarëve*, Tiranë 2002, f. 20). Ndërsa për fiset ilire si dëshmi e vjetër është vizatimi në buzët e një pitosi të drithit në rrethina të Korçës, i cili i përket shek. III para Krishtit (Khs.Ibidem).



Gjetjet arkeologjike, përkatësisht gjetja e drithërave të ruajtura në enë të ndryshme prej balte (Khs. S. Anamali, vep. e cit, fq. 20), pastaj shkrime dëshmidhënëse të autorëve antikë (Khs. A. Stipçeviq, *Ilirët dhe Iliria te autorët antikë*, Rilindja, Prishtinë 1979, f. 72-73; I njëjti, *Ilirët (historia, jeta, kultura)*, Rilindja, Prishtinë 1980, f. 140-141), e të tjera flasin bindshëm për njohjen e kulturave bujqësore, për veglat e punës për shtrirjen e gjerë dhe për zhvillimin e bujqësisë si veprimtari themelore ekonomike që në traditën pellazgo-ilire.

Në fshatin Stubëll, në kushte të një *bujqësie* ekstensive deri në kohën e pas Luftës së Dytë Botërore, në aspektin e agrikulturës më së tepërmi janë kultivuar elbi, gruri, misri e të tjera, ndërsa në aspektin arborikulturë, më të rëndësishmet ishin drunjtë frutorë, si mollët, dardhët, vishnjet, qershitë dhe të ashtuquajturat “kojsijat” e egra. Toka e punueshme ishte e paktë për ndonjë agrikulturë të madhe, prandaj pak kush e siguronte bukën nga toka. Kur flasin për të kaluarën, stubllanët rëndom informojnë se për ta siguruar ushqimin e vitit, një “yshyr”¹ e vilnin nga fusha (kupto drithëra buke), një të dytë nga shitja e pemëve dhe një “yshyr” të tretë e fitonin nga shitja e rakisë. Po të shënojmë se me rastin e shitjes së rakisë, të cilën e përpunonin vetë stubllasit, fitimi ishte një me tre, përkatësisht jepnin 100 kg. raki dhe merrnin 300 kg. drith, atëherë e kuptojmë drejt gatishmërinë për prodhimin e rakisë. Këtu nuk duhet harruar se stubllasit kishin dhe

1 Fjala turke *ösr*, *ösür*, ose arabe *usr* shpjegohet se është një lloj takse, e dhjeta që u mirrej bujqëve gjatë sundimit osman, shih te: A. Shkaliq, *Turcizmi u srpskohrvatskom-hrvatskosrpskom jeziku*, Svjetlost, Sarajevo 1973, te fjala *usr*, f. 634. Kjo fjalë me kohë ka marrë edhe kuptimin e prodhimit bujqësor që merret nga pemët, shi te: Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë 1980, te fjala *yshyr*, i , f. 2205

ende kanë mjaft familjarë me punë në fqinjësi e në botën e jashtme, të cilët poashtu ndihmonin dhe mbanin familjet që i kishin në Stubëll.

Veglat për t'i kryer punët në bujqësi ishin fare të thjeshta. Më e njohura dhe mjet bazë ishte parmenda, e cila këtu në Stubëll bëri jetë aktive deri në gjysmën e parë të shek. XX. Përveç parmendës çdo shtëpi kishte edhe veglat tjera të punës, që zakonisht i punonin vetë stubllasit, por edhe i blenin në tregun e Gjilanit e gjetiu. Stubllasit e kujtojnë kohën e viteve 1940-1950 kur parmenda e drunjtë ia lëshon vendin dalë ngadalë pllugut të hekurt, ndërsa traktori iu vjen vetëm në vitin 1960 e tutje. Dukuria e fillesës-rezistimi për të përdorur pllugin dhe më vonë-dukuria e huazimit të pllugut brenda lagjes e në katund, shfaqen si simbolika të veçanta kulturore e filozofike me konotime tepër domethënëse. Vetëm një zberthim: për filozofinë popullore parmenda e drunjtë “shton bereqetin”, ndërsa pllugu i hekurt ka efekt të kundërt etj.

Plak në ambient tipik fshati (1980)

Blegtoria si veprimtari e veçantë ekonomike, për stubllasit ishte veprimtari ndihmëse për bujqësinë dhe për jetesën e kësaj popullate në përgjithësi.

Stubllasit rëndom mbanin lopë, dhi, më pak dele, derra dhe kie, ose qe, dhe thuaja çdo shtëpi mbante edhe kuaj. Me bagëti stubllanët më tepër përplotësonin ushqimin, pastaj kryenin punët bujqësore, por kryenin edhe transportin dhe tregëtinë. Herë-herë edhe e shisnin ndonjë bagëti, në mënyrë që t'i plotësonin kërkesat për mallëra industriale e konsumuese që u mungonin.

Përveç këtyre veprimtarive bazë, në Stubëll ekzistenca jetësore ndihmohej edhe me veprimtari e aktivitete të tjera. Së pari stubllasit *njihen si muratorë* dhe si punëtorë me gurë e ndërtesues të shtëpive. Si mjeshtër shtëpishë janë treguar të besueshëm dhe të kërkuar, madje që në gjysmën e parë të shek. XX njiheshin në Kosovë, por edhe jashtë Kosovës, si në Serbi, në Maqedoni dhe në Evropë. Përveç muratorisë, stubllasit dinin edhe *mjeshtërinë e përpunimit të drurit*, përkatësisht *veglat e punës*, (parmenda, zgjedha, vllaqa, koshi, koleshniku, qerrja, pastaj saji si mjet pune për dimër, hambari); pastaj *enët*



e drunjëta (kaca, funa, tinarë, krojshe, lugë); *mobileri të thjeshtë* si shkomi, krevata, djepa, si dhe vekun ose vegjet e të tjera i punonin vetë për nevojat e veta, por ndonjëherë edhe me porosi për të tjerët. Poashtu punonin edhe disa *instrumente muzikore* e të tjera. Të gjitha këto ishin të rezervuara që t'i punojnë meshkujt, sakaq *punimi i qerepëve* si një poçeri e thjeshtë, ishte punë për femra. Na shfaqet pra kjo si një dukuri karakteristike në kulturën shqiptare. Rastet që *qerepët t'i punojnë femrat* i kemi vërejtur edhe gjetiu në mjedise rurale të Kosovës. Anipse kjo punë s'është aspak e lehtë, sidomos kur edhe dheun duhej bartur me krah - përkatësisht me duqë e me thasë, - femra ishte ajo që duhej kryer këtë punë.

Femrat stubllase, si edhe gjerësisht në kulturën shqiptare, shquhen edhe për *mjeshtërinë e endjes në vek*. Lashtërisht çdo nevojë shtëpiake plotësohej brenda ekonomisë shtëpiake. Stubllaset përgaditnin në vek zhgunin e leshtë, pëlhurën e lintë dhe më vonë të pambukët për veshje ose përdorëse të tjera, pastaj punonin gjithë shtrojën e mbulojën, si dhe shumë tekstile të tjera më të vogla. Shumë punesa të këtilla arrijnë edhe cilësinë artistike. Ergologjia tekstilore p.sh. e qilimave, mënyra, përkatësisht teknika e endjes së tyre në vek, si dhe raporti i përpjesëtimeve të motiveve brenda vetvetes në një qilim, shfaqet tepër karakteristik dhe intrigues. Ngjyrat



Sot pshjtjellakët janë rëndomësi për statusin shoqëror “plakat” (prill 2005)

dhe kompozimi i tyre i sukseshëm, zbatimi i ornamentimit domethëniesh përmbajtësore e të tjera, janë sa interesante aq edhe joshëse dhe përplot simbolizëm. Po ta analizojmë, fjala vjen, një qilim, të emërtuar sipas motivit ”me topa”, së pari do të mësojmë se motivi i një ”topi” të zbatuar në sfondin e qilimit është sa gjerë, aq edhe gjatë (në një ekzemplar që pata rastin ta shoh ishte përafërsisht me dimensione 55x55cm.). Në pyetjen sa është i madh ky qilim, përgjegjen do ta kemi: tri pollë me nga 6 ”topa”. Të tjerat janë për hulumtuesin. Karakteristikë tjetër e shtrrojeve stubllase është preferimi i sfondit me ngjyrë kryesisht të kuqe. Aspak nuk mbesin prapa as hiramat, dyshekët, çarçafët e të tjera, por edhe qëndisjet e punëdoret e vogla të punuara me grep ose me gjilpërë.

Si karakteristikë tjetër e veprimtarisë ekonomike për stubllasit dikur ishte edhe *veprimtaria e mullinjve me ujë*. Mullinjtë ishin jashtë Subllës, psh në Gërqar, Letnicë e gjetiu, prandaj mullisi duhej të udhëtonte për çdo ditë, ose me marrëveshje ndërmjet bashkëpronarëve e punëtorëve të një mulliri, qëndrohej në mulli me radhë nga disa ditë ose një javë. E shtruar kjo problematikë në aspektin e klasifikimit të zejeve, do të thotë se stubllanët ushtronin për vete dhe për të tjerët një nga zejet shërbyese-ushqimore (Khs. Për problematikën e zejtarisë të shihet te: D. Statovci, Zhvillimi historik i zejtarisë në KSAK, IAP, Prishtinë 1982, fq. 131, 186,190). Madje, për filozofinë dhe shoqërinë e asaj kohe, kjo zeje përfaqësonte prestigj, dhe, ç’ është e vërteta, me këtë zeje jetohej mirë. Atëbotë punohej me drith e jo me para. Stubllanët thonë se mullinjtë e tyre ishin aktivë deri në vitet e 80-ta të shek. XX, ndërsa sot kanë mbetur si artefakte, qoftë edhe si rrënoja që dëshmojnë për një aktivitet dikur të rëndësishëm dhe prestigjioz.

Kur flasim për etnokulturën e një vendi, gjithnjë do të njohim sa më shumë veçori etnografike. Disa syresh madje të pakapërcyeshme dhe tepër të rëndësishme.

Ta njohim tani *veshjen stubllase*. Po ta shtrojmë këtë problematikë në rrafshin e antropologjisë së simboleve, dhe kështu kulturën njerëzore ta vështrojmë si një sistem kuptimor dhe si entitet relativisht autonom (Khs. David Kingery, *A Role for Materials Science*, në: *Learning from Things*, ed. by W.D Kingery, Smithsonian Institutions, Washington and London 1996, f.175-180; Mary Le Cron Foster, *Symbolism: The Foundation of Culture*, në: *Companion Encyclopedia of Anthropology*, ed. by Tim Ingold, Routledge, London & New York 2002, fq.366-392), të ngritur mbi baza të mendësisë, të veprimtimit dhe të kreativitetit human njerëzor,



Stubllas që me krenari ende e mban plisin (prill 2005)

mësojmë për një ndërtim kompleks etnokulturor, por të zbërthyesëm. Kësaj radhe problematikën *veshje popullore* do ta vështrojmë në prizmin e teorive të reja shkencore me të cilat *problematika veshje kundrohet si simbolizëm dhe si kulturë* njëherësh. Së pari konstatojmë se veshja popullore stubllase, ashtu si edhe veshjet shqiptare në përgjithësi shquhen për strukturë të plotë për bartësit e të dy gjinive. Një kostum i plotë për meshkuj përbëhet nga: këmisha, tlinat, tirqit, jeleku, mitoni, xhurdia, gëzofi, çorapët, kallçinjët, mestet (shputat), opingat, shoka, marhama, plisi i bardhë dhe aksesorët si qysteku me sahat, çibuku, kutia e duhanit dhe armët. Materiali i ekonomisë shtëpiake, pastaj mënyra e ndërtimit të pjesëve të veshjes dhe e bartjes së tyre dëshmojnë se struktura e *kostumit të meshkujve* i takon *tipit të veshjes me tirq*, që është gjerësisht e njohur ndër shqiptarë. *Kostumi*

i femrave i përbërë nga : tlinat, këmisha, dimitë, jeleku, mitoni, “kasaku”, pshjtjellaku, çorapët, opingat, shamia si mbulesë koke dhe stoli e aksesorë të ndryshëm, me morfologjinë e petkave të veçanta tregojnë se i takon *tipit të veshjes me dimi*. I vështruar nga aspekte etnologjike e të antropologjisë kulturore, simbolizmi i artefakteve në kulturën dhe entitetin veshje, na dëshmon për një organizim provash komunikuese dhe informuese brenda strukturës dhe sistemit karakteristik të simboleve. Në përcaktimin kohë



Foto e femrave stubllase me pshjtjellakë (shtator 1993)



Pshjtjellak dhe këmishë e pëlhurës së vekut, për statusin "gra të reja" e qëndisur me rruaza në modelin "n'kerçe" (maj 2005)

statusin gra plaka. Kujtesa e plakave mba mend se para më tepër se gjysëm shekulli plakat mbanin mbi dimi edhe një shokë të leshtë, të punuar në vek, disi ngjashëm sikur është shoka e burrave, por kjo më e ngushtë. Për më tepër deklarojnë se shokën mbi dimi e ka bartë vetëm ndonjë plakë më "marakli". Ç'kemi tani në këtë dukuri? Për strukturën e veshjes me dimi petku i leshtë "shokë ose brez" shfaqet si ngarkesë e tepruar që dimitë "nuk e durojnë", sepse në veshjen e dimive si dekor mbi to vinte një lloj shalli i mëndafshit, që ndryshe quhej "kushak". Më pastaj, këmisha që bartet me dimi, madje edhe në kohën e sotme, për nga elementet e ndërtimit është e ngjashme me "dalmatikën ilire" dhe me këmishat që mbahen në tipin e veshjes me këmishë të gjatë e një ose dy pshjtjellakë (i parmi dhe i pasmi). Si duket, këtu mund të supozohet se shoka ose brezi i leshtë është dëshmi për një tip tjetër të veshjes dhe jo për tipin e veshjes me dimi.

dhe hapësirë struktura dhe morfologjia e petkave të veçanta tregojnë për shtrirjen e një veshjeje të këtillë, madje për të dy gjinitë, jo vetëm në Stubëll, por në Kosovë gjerësisht, në Shqipëri, dhe te shqiptarët në Serbi, në Mal të Zi në Maqedoni e gjetiu ku jetojnë shqiptarët. Materiali i pëlhurës së ekonomisë shtëpiake, si dhe ndërtimi i petkave të veçanta, p.sh. i këmishës së pëlhurës së bardhë të pambukët, ndërtuar nga shtati i pandërprerë tek supet e as në bel, me grykë të çelur në formë të shkronjës T, për të cilën stubllasit tregojnë se i paraprinte këmisha e lintë, dhe ngjashmëria e saj në prerje me "dalmatikën ilire" (Khs. Rr. Zojzi, Mbi veshjet tradicionale të popullit tonë, Studime historike, nr. 4, Tiranë 1965, f. 143; A. Gjergji, Mbi origjinën dhe lashtësinë e disa elementeve të veshjes popullore, Kultura popullore nr. 1, Tiranë 1980, fq. 66), pakontestueshëm dëshmojnë për lashtësi dhe vazhdimësi iliro-shqiptare. Ndërtimi i këmishës madje shfaqet i ngjashëm për të dy gjinitë.

Me qëllim nuk do të ndalemi në përimsime të tjera, por dëshirojmë të veçojmë diçka në strukturën e veshjes së dedikuar për *moshën dhe*

Kështu mund të mbetet vend që të mendohet se ndoshta këtu dikur femrat mbanin tipin e veshjes me këmishë të gjatë e dy futa (mbshtjellakë). Megjithatë këtu nevojiten ende hulumtime e studime serioze.

Pshjtjellakët e paluar të ruajtur si kujtim ndaj traditës

Çorapë të leshita për burra të punuara me modelin “n’pen t’madhe”

Pshjtjellak i leshitë për statusin shoqëror “vajza”

Të shikuara në një rrafsh më të gjerë raportet apo marrëdhëniet artefakt: e mirë kulturore në entitetin veshje, duke pasur në konsideratë se këto të mira i krijon njeriu, po bëjmë pak përpjekje të një zberthimi ndryshe të njohjes së veshjes. Komunikimi i raporteve të “lexueshme” magjike ose artistike të përdorimit të ngjyrave, të ornamentikës dhe të filozofisë së vendosjes së tyre në “pikat strategjike” të petkut, si dhe shfaqje të tjera kanë tregimin e vet. *Pshjtjellakët* e grave të reja stubllase shfaqen në mënyrë impozante me sfond ngjyreje të kuqe intensive, mbi të cilin vijnë brezaret ngjyrash të bardha ose ngjyrash të tjera, ndërsa motivet më të zgjedhura vendosen në të dy skajet ose “krenët” e pshtjellakut. Motivët mund të jenë; “n’ drandafila”, “n’ dalldysa”, “n’topa”, “n’lakuriqa”, “n’kryqa” etj. (Khs. D. Halimi - Statovci. Etnologjia Flet, IAP, Prishtinë 1988, f. 128, 133.). Motivët si këto “dekodohen” ose “lexohen” në filozofinë magjike të jenë të





Hiram i leshtë i punuar në modelin “n’kokorra” dhe “n’topa” (maj 2005)

Problematika e aksesorëve si dekor dhe si fuqi ekonomike e bartëses shfaqet çështje më vete. Edhe në raste kur familja është e rënduar nga skamja, megjithatë nusja duhet të ketë stoli, si vëthë, qafore, unaza, hallhale që këtu u thojnë edhe “rrokç”, që mund të ishin të argjendit, të arit ose rruaza të ndryshme. Filozofia e “të menduarit magjik” të kulturave të ndryshme njerëzore, aksesorët që mbahen në pikat “strategjike” të trupit të njeriut, veçmas dekorit i ergologjisë metalike, i shpjegon këto objekte si artefakte me fuqi mbrojtëse apotropike.

Duke dëshiruar të njohim sa më shumë koncepte të simbolizmit në kulturë dhe në entitetin veshje e Stubllës, do ta veçojmë për një moment *veshjen e destinuar për raste morti e zie*. Kultura popullore e kupton drejt filozofinë e jetës, dhe ka instrumentet e veta për ta shprehur perceptimin e vet. Për raste pikëllimi, përkatësisht për vdekjen e ndonjë anëtari të afërm të familjes, meshkujt lidhin shervete ose peshqir “pak më të vruktë”, ndërsa femrat lidhin shervete ose shami të zezë, por të paluar në diagonale e të bërë “dizgë” për ta lidhur për balli, madje mbi shaminë që e bart rëndom e në çdo rast. Kështu mbahet zi për një vit të tërë dhe pasi të kalojë ky afat, shkohet në varreza, bëhen nderime ndaj të vdekurit dhe “zgidhet kryet”, përkatësisht hiqet shenja e zisë. Ky simbolizëm i artefakteve tekstilore komunikon respektin për jetën dhe për vdekjen, përfillje për ngjarjet jetësore e shoqërore. Është e rëndësishme të theksojmë se i tërë ky sistem karakteristik i simbolizmit dhe i artefakteve, në këtë rast tekstilore, shfaqen si rrjedhojë e punës dhe e kreativitetit të njeriut, dhe, në anën tjetër, edhe si rrjedhojë e ndërgjegjes, filozofisë ose mendësisë së njeriut. Është ky pra një ansambël i tërë i elementeve të ndryshme të antropologjisë kulturore që tërheqin vëmendjen dhe kërkojnë studime.

Qilim i leshtë i punuar me modelin “n’topa”



Po ta apstraktojmë simbolizmin e artefakteve dhe për një moment t'i kundrojmë ca raporte që mund të “rrezatojnë“ nga veshja, si p.sh.: *qenia humane dhe veshja* dhe në anën tjetër raporti *veshja dhe ndërgjegja humane e shoqërore*, do të mësojmë realitete shumë interesante dhe të çuditërishtme, por të zbërthyeshme dhe plotësisht të arësyeshme për kohën dje, tërësisht të transformuar në kohën sot, e që ndoshta do të shfaqet fare ndryshe në kohën nesër. Në vitin 1991 pata rastin që në Stubëll të shënoj mendimet filozofike: “çejz pa pshallak s’ bëhet”, “grueja pa shami e pa pshallak, â marre”. Tani vonë, në prill të vitit 2005 shënova sa vijon: “dathun po, po pa plis s’ kemi shku” dhe një tjetër mendim: “Si ta lëshë shtëpinë tone e venin ton – mirë s’ka”. Filozofi të ndryshme, pra. Mendësia e ndjenjës së turpfit, na e përkujton funksionin tepër të lashtë dhe primar të mbshtjellakut si mbulesë e prehërit dhe si pjesë nga më të lashtat të zhvillimit të veshjes (Khs. K. Birket-Smith, Putovi kulture, Opća Etnologija, Zagreb 1961, fq. 185; A. Gjergji, Veshjet Shqiptare në Shekuj, Tiranë 1988, fq. 168). Ndërsa krenaria dhe pamungueshmëria e plisit të bardhë, sikur merr simbolikë identifikuese të burrërisë e të etnisë shqiptare. Edhe diçka çuditërisht simpatike, por edhe domethënëse: plisi i bardhë është përherë plis, ose kapuq i bardhë, ndërsa mbulesat tjera si beretat, kaqketat etj., për filozofinë popullore të moshuarëve janë “do farë harrnash”. Komenti këtu

do ta prishte bukurinë e një realiteti të ndërjegjes njerëzore e kombëtare. Megjithatë, kjo tani i takon më tepër gjeneratave të vjetra, të kaluarës, i takon historisë, ndërsa e reja hap rrugën drejt globalizimeve me Europën dhe botën. Ndërsa ndjenja e atdhedashurisë, e lidhjes me vendlindjen, bën që sot çdo familje që jeton në botën e jashtme, të ndërtojë shtëpi të re moderne në Stubëll dhe të kthejë këtu çdo verë, madje me gjithë familjen, t'i kalojë pushimet në vendlindje e të shmallet me vendasit.

Doket dhe zakonet familjare si një pjesë e kulturës popullore shpirtërore shfaqen me interes të veçantë për etnologjinë, por është e pamundur që të përfshijmë të gjithat në një shkrim informativ. Duke parafrazuar se dasma stubllane me të gjitha fazat e saj, si dhe shumë veprime, rituale e zakone shfaqen të rëndomta dhe të njëjta si gjithkund ndër shqiptarë, theksojmë se disa ceremoni marrin ngjyrimet fetare të krishtërit, por disa shfaqen për nuanca më ndryshe, ose më të begata se në rrafshin e përgjithshëm. Momenti i gëzimit të dasmës thuaja gjithkund ndër shqiptarë fillon me *ditën e brumit ose ditën e kulaçit*. (Khs. A. Dojaka, Ceremoniali i dasmës shqiptare, Etnografia Shqiptare nr. IX, Tiranë 1978, f. 132; D. D. Halimi-Statovci, vep. e cit., f. 120). Këtë bukë, ose kulaç të nuses rëndom e gatujnë vajzat, dhe për këtë rast lypset mbajtur plisin e bardhë në kokë. Në Stubëll deri vonë ky ritual ishte edhe më i ruajtur e më i begatë me praktika. Vajza që e gatuan kulaçin e nuses, jo që mban plisin e bardhë në kokë, por ajo vetë duhej marrë ujë nga kroni fare pafolë, detyrimisht duhej të vishej me kostumin e djalit që martohej dhe kishte për detyrë që me rastin e “thyerjes” së kulaçit të qëndronte në anën e dhëndrit, për t’i ndihmuar ta thejë copën sa më të madhe.

Veprimet që ushtrohen *me rastin e nisjes dhe të pritjes së krushqëve* në shtëpinë e dhëndrit janë dukuri tepër karakteristike dhe ushtrohen gjithkund ndër shqiptarë. Krushqit përcillen dhe priten duke u hedhur mbi kokë drithëra, madje ndonjëherë të përzier me sheqerka dhe ndonjë monedhë metali. Ndërkaq në Stubëll ky veprim “begatohet” dhe shfaqet i sinkretizuar me petkun fetar. Krushqit këtu spërkatën me “ujë të bekuar” dhe poashtu u hudhet edhe drith. Ritualet e këtilla flasin për kultin e bimësisë, kultin e metalit, kultin e ujit si kult pagan, por edhe për fenomenin “ujët e bekuar” si ndikim i krishtërit.

Si doke arkaike stubllasit tregojnë edhe për momentin kur nusja përcjellet nga shtëpia prindore, ajo së pari bën një rreth për rrotull “kerrit” të nuses e pastaj futet brenda (fenomeni i “rrethit të mbyllur”), ndërsa në momentin

kur vjen kerri i nuses në shtëpinë e djalit, në prag të dyerëve të oborrit nga brenda vendoset zgjedha e qeve në mënyrë që qerrja të kapërcejë mbi të. Pastaj kur nusen e vendosin për ta parë të pranishmit në dasëm, kishin kujdes që nusja të jetë me fytyrë nga dielli. Janë këto pra, si gjithkund në kulturën shqiptare, mbetëza arkaike të kultit të qenieve demoniake dhe të kultit të tokës (qetë e zgjedhës), të adhurimit të diellit etj.

Duke ecur nga një tipar etnokulturor në tjetrin, ta përmendim edhe *traditën muzikore*. Momentet e gëzimit, veçanërisht dasma gjithkund përcillen me muzikë. Stubllasit tregojnë se këndonin për raste të ndryshme, p.sh. kur ishin çoban, kur punonin në ara, kur luanin filxhana, por më së shumti në dasma. Nga instrumentet preferonin aerofonet, si fyellin dhe kavajtë, por gjithashtu njohin edhe kordofonet si çiftelinë e sharkinë, si dhe membranofonet si lodrat ose tupanin dhe defin. Fyejtë i punonin vetë, sidomos ata të shtogut. Çiftelinë e kanë punuar disa mjeshtër stubllas, por më tepër e kanë blerë në treg. Lodrat iu vinin nga Gjilani. Çmojnë posaçërisht kavajtë dhe tregojnë edhe për mjeshtër stubllas, të cilët i kanë punuar kavajtë, kanë muzikuar me ta dhe njëkohësisht edhe kanë kënduar.

Për sa u përket valleve në këtë moment nuk mund të thuhet shumë. Stubllasit njohin kërcimin në dyshe dhe kërcimin në valle “dorë-për-dorë” me lodër ose me tupan. Kështu kërcëjnë të dy gjinitë, por femrat më tepër preferojnë kërcimin me def.

Dukuri interesante etnokulturore padyshim se janë edhe *ushqimi popullor, mjekësia popullore, lojërat popullore* e të tjera. Bazë e ushqimit të përditshëm për periudhën e shtruar këtu, ishte buka dhe pastaj vinin ushqimet e tjera. Konstruksioni ose sistemi ushqimor shfaqet fare i dallueshëm dhe i ngjashëm me konstruksionin ushqimor të kulturës shqiptare. Kështu, edhe në Stubëll dallohet ushqimi mbi bazë të brumtë ose të qulltë (pite ose trajta të ndryshme); ushqimin mbi baza të qumshtit (bulmeti dhe prodhimet e qumështit); ushqimin mbi baza të bimësisë ose gjellë të ndryshme me perime dhe, pemë e pije të ndryshme. Gjithashtu si specifike të posaçme njohin edhe bukën, përkatësisht ushqimin ritual dhe ushqimin për destinime të posaçme.

Në fushën e *mjekësisë popullore* është karakteristike se stubllasit zbatonin zakone mjekuese ose kurative dhe shërimin me “medikamente lëndore”. Kështu p.sh. për shërimin e dijaresë së fëmijëve, për dhembje koke,

dhembje veshi, dhembje fyti etj., ”medikamentet” i përfitojnë, ose marrin lëndë të gatshme, barishte e të tjera sa vijon: krunde të gryta, brumë të nxehtë, peceta me raki, flegëra patatesh, krip, lloj barishte që e quajnë “bar pezmatimi” që nuk arritëm ta “dekodojmë” në këtë moment, pastaj qepë, fletë lakre e të tjera. Jeta në këto shpatije të Karadaku larg komunikacionit dhe komunikimit me botën dhe larg civilizimit e të arriturave të mjekësisë, ka bërë që stubllasit të luftojnë kundër sëmundjeve dhe për shëndetin e njerëzve, por edhe të kafshëve brenda mundësive që kishin dhe ashtu si dinin. Mund të themi se njohuritë veterinare popullore në Stubëll ishin modeste, por megjithatë kishte përpjekje edhe në këtë drejtim.

Lojërat popullore përfaqësojnë fushë të veçantë etnologjike, përkatësisht etnokoreologjike, por se kësaj radhe këtu do të mjaftohemi vetëm me një evidentim të thjeshtë. Koha e lirë për të rritur, e sidomos për fëmijë plotësohej me lojëra karakteresh të ndryshme. Të rriturit flasin me nostalgji për “lojën me filxhana”, veçmas momentet e fitimit dhe këngën e fitimtarëve. Për ta shprehë sa më mirë këtë ndjenjë deklarojnë se ata që humbin, rrinë ulur dhe “veç palohen” nga keqardhja dhe nga turpi. Teksti i këngëve që i këndojnë fitimtarët, përshkohet me përbuzje, fyerje sa lojtarët humbës djerësitëshin deri në maksimum. Megjithatë fundi ishte pajtues dhe mbrëmjen e kalonin duke biseduar për më të ndryshme të jetës, gostiteshin me pemë të ndryshme dhe mesnata i zinte me këngë e hare. Me shumë simpati kujtojnë edhe lojërat e fëmijëve, fjala vjen (ashtu si i quajnë vendasit): loja me “kutuba” (kupto boça të misrit), loja me top, loja me “guxh”, loja “klicka”, ose “kolicka” loja “shefëza”, loja “me plloqë”, loja “gurët përtpjetë” (lojë me pesë guralecë), loja “gurapesh” (rrasë për ta gjuajtur sa më larg) e të ngjashme.

Si dukuri etnografike nuk janë të pakta dhe të parëndësishme edhe shfaqjet e ndryshme të riteve të motmotit, të besimeve, bestytive e të veprimeve me rastin e dokeve e zakoneve të caktuara familjare e të tjera. Në shumë rite e praktika rituale hetohen mbijetesa të kulteve të ndryshme, të animizmit, të totemizmit e të tjera. Sado që janë të sinkretizuara me petkun fetar të krishterë, megjithatë në veprime të caktuara dallohet kulti i diellit, kulti i metalit, kulti i vatrës e i zjarrit, kulti i ujit, kulti i bimësisë e të tjera.

Janë të dallueshme dhe të dukshme edhe tiparet etnografike që i takojnë fushës së gjerë të *kulturës shoqërore*. Kodi etik dhe filozofia e “normave të sjelljes njerëzore” për stubllasit janë pjesë përbërëse të ndërgjegjes humane. Tregohet se kjo ndërgjegje ruan identitetin dhe individualitetin etnik e

kombëtar, çmon fjalën e dhënë, respekton familjen, prindin, përgjithësisht më të vjetrin, çmon lart dhe zbaton ndihmën njëri për tjetrin, përgjithësisht çmon dhe respekton rregullat e pashkruara të qëndrimeve dhe të sjelljeve ndaj jetës. Jeta stubllase e ka të njohur fare mirë dukurinë e familjes së madhe, dukurinë e servitutit, të pengut e të tjera. Rregullat e pashkruara të së Drejtës dokesore shqiptare ishin ato që dikur vepruan edhe në Stubëll dhe rregulluan çdo segment të jetës.

Antroponimia e Stubllës si dukuri etnokulturore shfaqet me një karakteristikë të veçantë. Është e njohur se emri, ose më gjerë antroponimia mban në vete shumë funksione e domethënie. Funksioni më i natyrshëm i emrit të njeriut është funksioni identifikues. Me emër vetanak njohim një personalitet të caktuar. Një individ, përkatësisht një njeri ose një qenie humane integrohet në shoqëri si i identifikuar me një emër të caktuar. Funksioni tjetër do të ishte vlera kulturore, historike dhe dokumentuese. Ka raste kur rrethanat historike p.sh., imponojnë dukurinë e dyemërsisë. Në Stubëll edhe sot vazhdojnë të jetojnë dyemërsitë dhe kështu dëshmojnë për mbijetoja të “laramanisë“ ose të kriptokatolicizmit të këtyre anëve. Cila është pasqyra e sotme e antroponimisë së Stubllës?! Gjatë qëndrimit hulumtues në prill të këtij viti hetova se ende ka raste kur një person mund të ketë dy emra: një të përkatësisë fetare islame dhe një të dytë të përkatësisë fetare të krishterë. Ose një individ mban një emër të krishterë, por me simpati vazhdon ta ruajë mbiemrin familjar islam etj. Më e bukura e kohës së re është dukuria se stubllasit e gjeneratave të reja mbajnë emra shqiptarë, të gurrës e të domethënies shqipe, por se mbiemrat e tyre simpatikisht vazhdojnë të komunikojnë histori, të komunikojnë ngjyrimë islamizmi ose krishtërimi, të komunikojnë kulturë njerëzore.

Tiparet etnokulturore janë shprehje e jetës së njeriut, përkatësisht të popullit, janë elemente të përpjekjeve optimiste njerëzore që rrezatojnë kulturë, e cila e përballoi kohën, mbajti kohën në vete, la gjurmët e veta në kohë dhe vazhdon të dëshmojë dhe të krijojë gjithnjë në pajtim me kohën. Të mirat kulturore, artefaktet lëndore-materiale, si dhe përmbajtjet shpirtërore shoqërore të një shoqërie janë përplot simbolizëm dhe komunikojnë realitete të ndryshme. Ato janë “aty” dhe na thërrasin t’i “ndjejmë“ kulturalisht dhe t’i shpjegojmë e jetësojmë shkencërisht. *Thesari kulturë është thesar që nuk shterret*, ky gjithnjë evoluon, sepse njeriu ka afësinë që gjithnjë të krijojë të mira kulturore. Sot shumë nga tiparet e diskutuara këtu tani më i takojnë të kaluarës, i takojnë historisë, por në mbetëza e arkaizma zënë vend edhe në ndërgjegjen bashkëkohore. Këto lypset për t’i

dalluar dhe për t'i kuptuar e shpjeguar drejt. Kultura e një etnie, e një vendi ose kultura e një shoqërie e një shoqërie njëherit është pjesë e kulturës njerëzore dhe botërore.

4. ARKITEKTURA DHE MJESHTËRITË

Zhvillimet dramatike shoqërore, martirizimi, ndërrimi i sistemeve (pushtuese) në dy shekujt e kaluar, si dhe dinamika e jetës, emigracioni, liria e mendimit dhe e ndërtimit në fillim të shekullit të ri, janë të përshkruara nga dy komponentë të vazhdueshëm të ndërtimit në Stubëll; atij të gurit dhe katrorit. Kur flasim për arkitekturën e Stubllës kemi të bëjmë në përgjithësi me mënyrën e ndërtimit të shtëpive të banimit dhe të objekteve ndihmëse brenda një oborri të banuar. Zakonisht, në oborrin tipik stubllan bënin pjesë një shtëpi banimi, plemja, hambari, dyert e oborrit dhe rrethoja e truallit. Të gjitha këto elemente “të thurura” me gurë gjatë historisë, formonin truallin e banuar stubllan. Derisa ndërtimi i plemes, hambarit dhe elementeve ndihmëse në shekullin 19 dhe deri në gjysmën e dytë të shekullit 20 mungonte për shkak të mundësive ekonomike, mungesa e këtyre objekteve ndihmëse në oborret stubllane nga fundi i shekullit 20 është pasojë e largimit të pronarëve nga jeta bujqësore dhe blegtorale si dhe përqendrimi i tyre vetëm në objektin e banimit – shtëpinë. Mungesa e objekteve ndihmëse dhe spikatja e objektit të banimit, gjithashtu mundohet të paraqesë transparencën e pronarit dhe begatinë e tij ekonomike.

SHTRIRJA

Vendbanimet stubllane shtrihen në pjesën perëndimore të Stubllavaqës. Shtëpitë e para ishin të ndërtuara rrëzë Stubllavaqës; nga burimi Shtruzh deri te Kisha e Vjetër dhe varrezat e fshatit. Shtimi i shtëpive rreth këtyre vendbanimeve të para, krijoi rrugën unazore që lidhte shumicën e shtëpive të para. Pjesa brenda dhe përreth unazës formon fshatin e atëhershëm, që edhe sot quhet “katun”. Rreth kësaj unaze sot shtrihen shtëpitë e lagjeve të vjetra Ramaj, Hysenaj, Ukaj, Demaj, Koliq dhe Ballaban. Vendbanimet rrëzë Stubllavaqës gjatë sundimit të Perandorisë Osmane ishin më të preferuara për shkak të reliefit kodrinor, rrugëve të papërshtatshme dhe përpjekjeve të banorëve të kësaj ane që të jenë sa më larg syrit të pushtuesve dhe t`i ruajnë traditat e tyre të ndaluara kulturore dhe fetare.

Pjesët e qendrës së sotshme të Stubllës, edhe pse më të rrafshta dhe më të përshtatshme për ndërtim, ishin vetëm toka bujqësore. Fshati, nga

*Rrëzë
Stubllavaqës,
lagja Hysenaj*



unaza e vjetër, kishte një zhvillim linear prej visesh më të larta kodrinore në drejtim të atyre më të ulëta. Ndërtimet përgjatë rrugës lineare apo gjarpërore që shpijnë në drejtim të Lumit të Letnicës, i japin fshatit një orientim krejt tjetër dhe një shtrirje jo të zakonshme – nga lart te poshtë. Mungesa e trojeve të mjaftueshme brenda dhe përreth unazës, si dhe trojet

*Pamje nga
qendra e sotshme*



e shumta dhe më të përshtatshme në viset më të ulëta, detyruan banorët që t'i shndërrojnë arat e tyre në troje banimi. Gradualisht, qendra e fshatit “rrëshqiti” dhe u përzien kufijtë e lagjeve. Kisha e Vjetër (Shkolla e Parë dhe Muzeu) si dhe Shkolla e Vjetër (objekt i rrënuar) tashmë janë pikat më të skajshme lindore dhe juglindore të fshatit. Kurse Kisha dhe Shkolla e Re janë ndërtuar me qindra metra më larg në drejtim perëndimor. Në të kaluarën Stublla kishte disa rrugë lidhëse dhe dalje në të gjitha fshatrat dhe qytetet rreth saj; p.sh. “Udha e Kumnovës” që shërbente si lidhje e fortë tregtie dhe punësimi me vendbanimet e Maqedonisë së sotshme. E vetmja rrugë që shpie sot në Stubëll, është ajo nga Lumi i Letnicës. Daljet tjera historike nga Stublla nuk janë më të rëndësishme dhe të rrahura.

NGA SHTËPIA NJËDHOMËSHE KATRORE DERI TE SHTËPIA ME SHUMË KATRORE (PERIUDHA NDËRMJET SHEKUJVE 15 – 20)

Sipas gojëdhënave dhe simbas gërmadhave të mbetura, shtëpitë e para në Stubëll ishin të ndërtuara nga një skelet druri, si konstrukcion primar, dhe nga thuprat e drurit apo, me vonë, edhe nga tullat e lloçit, të lyera po ashtu me lloç, si konstrukcion sekondar apo mbështjellës i skeletit. Mbi bazamentin apo mbi themelet, nga gurët ngrihej konstrukcioni skeletor i drurit. Lidhja ndërmjet veti e shtyllave apo trarëve të drunjte, bëhej me metoda zdrukthëtare dhe pa ndihmën e gozhdave. Pjesë e këtij skeleti ishte njëkohësisht edhe konstrukcioni i kulmit. Rrethanat e varfërisë dhe të pasigurisë, si dhe niveli arsimor, bënë që këto shtëpi të kenë përmasa të vogla dhe rrallë herë t'i plotësonin edhe kushtet minimale për strehim. Kushtet e banimit nuk kanë qenë fare të mëdha e shtjellimit para ose gjatë ndërtimit, por vetëm nevoja për strehim. Kur flitet për strehim, nga zanafilla e ndërtimeve në fshat e deri në vitet e gjashtëdhjeta të shekullit 20, bëhet fjalë për strehimin e njerëzve dhe të kafshëve shtëpiake. Dëshmitarët e kohës tregojnë edhe për shtëpitë njëdhomëshe që strehonin njëkohësisht njerëzit dhe kafshët. Kjo shtëpi-dhomë kishte përmasa të katrorit, për shembull 5 x 5 apo 4 x 4 metra dhe lartësi të atëhershme njëkatëshe rreth 2 metra, me një kulm në formë piramide mbi të. Mbi skeletin drunor të kulmit vendoseshin drunjte më të hollë ndihmës, pastaj kashta e thekrës dhe kashta tjera si mbulojë e fundit. Kjo mbulojë më vonë do të zëvendësohet me tjegulla (“qeremide magjupi”) të pjekura edhe nga disa tjegullarë stubllanë.



Konstruksioni i kulmit nga brenda

Materialet e përmendura të ndërtimit, edhe pse për kohën e tashme jo edhe aq të preferuara, siguronin një strehim elementar dhe kushte të mira klimatike gjatë gjithë vitit. Druri dhe lloçi, si përques të dobët termikë, nuk lejonin ngrohjen e dhomave gjatë verës dhe ftohjen e tyre gjatë dimrit dhe kështu kujdeseshin për temperatura optimale në dhoma. Prania e përherëshme e kafshëve në dhomat e fjetjes dhe të banimit, përveç që lironte një sasi të nxehtësisë gjatë dimrit, nuk ofronte përparësi për banuesit njerëz të shtëpisë. Kuptohet se gjatë stinës së verës dhe gjatë ditëve me mot të mirë, kafshët ishin jashtë shtëpisë, por prania e tyre në dhoma të banimit me kalimin e viteve konsiderohej si e tepërt. Në fillim, dhomat e kafshëve dhe të njerëzve ndaheshin nga korridori i shtëpisë. Katrori i shtëpisë njëdhomëshe pasqyrohet në anën tjetër të korridorit dhe kështu shtëpia njëdhomëshe merr formën e shtëpisë dydhomëshe me një korridor në

mes. Kjo shkallë e parë e zhvillimit apo e shumëzimit të katrorit do të shërbejë gjatë gjithë historisë së ndërtimit si model bazë për ngritjen dhe planifikimin e shtëpisë. Katrorët e fituar me korridor në mes, pasqyrohen edhe njëherë mbrapa, kështu fitohet baza me katër dhoma zakonisht nga 4 x 4 metra dhe me një korridor në mes me gjerësi afër 2 dhe gjatësi 8 metra. Bazës së zakonshme me përmasa të jashtme rreth 10 x 8 metra i shtohet edhe një tarracë në pjesë e përparme të shtëpisë, e quajtur edhe “hajat”. Në këtë pjesë të mbuluar, në shtëpitë dykatëshe, ishin të integruara edhe shkallët për në katin e dytë, që ishin edhe element dekorues i anës së përparme të shtëpisë. Nga katrori fillestar 4 x 4 zhvillohet një katror tipik i bazës së shtëpisë 10 x 10 metra. Shumëzimi i këtyre katrorëve përpos në rrafshin horizontal, më vonë zhvillohej edhe në rrafshin vertikal. Me përvetësimin e metodave të përpunimit të gurit, mjeshtërisë së muratorisë dhe me arritjen e materialeve tjera në përdorim, kati i shtëpisë kopjohet vertikalisht nën katin bazë, si bodrum, apo mbi të, si kat me dhoma të fjetjes.



*Shtëpi e vjetër
tradicionale e punuar
nga guri dhe druri*

Pragu, dera e hyrjes, oxhaku, shkallët dhe çardaku, punoheshin me shumë kujdes dhe pasion. Këto elemente të shtëpisë kanë edhe rëndësinë e tyre për traditën dhe folklorin. Ato në shumë raste kanë edhe kuptime simbolike dhe flasin shumë për pronarin. Ja disa fjalë popullore që kanë të bëjnë me këto pjesë të objektit:



*Ballkoni,
oxhaku*

“S`e kam kapërcye sod pragin” (Nuk kam dal sot nga shtëpia), “S`kam me ia shkel ma pragin” (Nuk do të shkojë më në shtëpi të tij), “Iu shkym pragi” (Iu shua hisja), “Si nusja n`çardak” (Diçka e bukur dhe e stolisur), “Dola n`çardak” (Dola për të pushuar, dola që të më shoh dikush), “Mos ia kqyr shkallt, po kqyrja oborrin” (Mos e vlerëso atë që ka trashëguar dikush, por atë që ka arritur ai vetë), “Shkoi n`derë t`mirë” (Një vajzë u martua në një familje të mirë), “Ia fiki derën” (E mori në qafë kënd), “Na jemi t`ni oxhaku” (Ne rrjedhim nga një familje).

Këto shtëpi kishin zakonisht orientim jug-veri, që do të thotë se kishin hyrje në anën e jugut. Nga dera e hyrjes dhe korridori në mes të shtëpisë kalohej në anën perëndimore ku ishin të vendosura dhoma e ditës dhe kuzhina. Ana jugore dhe perëndimore dihet se janë më të ndritura dhe më të nxehta, si anë të horizontit me më shumë orë me diell gjatë ditës. Pjesët me më pak diell gjatë ditës, si ana veriore, shfrytëzoheshin për dhomat ndihmëse apo për ta ruajtur bulmetin më të freskët, si “çarraniku” për shembull. Edhe pse pa rregullativa ligjore të ndërtimit dhe pa ndërtimtarë të shkolluar, mjeshtrit autodidaktë të Stubllës formuan standardet e veta të ndërtimit, mësuan nga përvojat e njëri-tjetrit, shfrytëzuan materialet dhe hapësirën në mënyrë mjaft racionale dhe shndërruan këtë vend të papërshtatshëm për banim në një vendbanim pitoresk.

SHTËPITË PREJ GURI

(PERIUDHA NGA FUNDI I SHEKULLIT 19 DERI NË FUND TË SHEKULLIT 20)

Vendosja e banorëve të parë rrëzë Stubllavaqës, përveç përparësive gjeo-strategjike, siç dëshmojnë historianët, solli më vonë edhe përparësi arkitektonike. Stubllavaça, përveç lëndës së parë, gurit të bardhë dhe të fortë, në pjesët e ulëta të saj dhuronte edhe dheun e përshtatshëm për ndërtim dhe furnizonte banorët me ujë të kthjellët nga burimet e saja të pashtershme. Rolin e saj si furnizues me lëndë të parë, ajo nuk e humbi asnjëherë gjatë historisë, përkundrazi, me zhvillimin e teknikës dhe të metodave të nxjerrjes dhe të përpunimit të gurit, rriteshin edhe kërkesat për këtë material të çmuar ndërtimor. Ndërtimi i shtëpisë prej Gurëve të Stubllavaqës do të shndërrohet në simbol qëndrese, sigurie dhe dëshmi e stabilitetit ekonomik për pronarët e këtyre shtëpive.

Ndërtimi i shtëpive të para me gurë të Stubllavaqës, edhe pse sipas planeve të ngjashme me ato të shtëpive nga druri, prapë se prapë ishte një arritje revolucionare e ndërtimit në Stubëll. Nga ky moment stubllanët do t`i qëndrojnë besnik gurit të Stubllavaqës dhe do t`i japin fshatit shtëpi dhe objekte të qëndrueshme, të bukura dhe të bardha. Guri bëhet material i



*Shtëpi e vogël
nga guri*

*Shtëpi e vjetër nga
guri; dykatëshe me
bodrum*



pandashëm i ndërtimit. Mbi bazat e dikurshme të shtëpive nga drunjtë dhe lloçi, apo duke u bazuar nga ato përvoja të kaluara, tani ngritën shtëpitë nga gurët. Skeleti i dikurshëm nga druri tani zëvendësohet me mure të trasha nga gurët. Gjerësia e tyre dhe stili i muratimit me gurë, gati nuk kanë ndryshuar fare gjatë historisë. Një mur guri ka edhe sot gjerësinë 0,5 metra. Druri, megjithatë, nuk mund të lihet anash si material i domosdoshëm ndërtimor. Pjesët

horizontale dhe të pjerrëta, si trarët ndërmjet dy kateve, trarët mbi dyer dhe dritare, shtyllat për çardak, konstruksioni i kulmit, edhe më tej ndërtoheshin nga druri.

Guri është material i fortë, i qëndrueshëm dhe i përpunueshëm, mirëpo vetëm si material për muret apo pjesët tjera vertikale të objektit. Ata pronarë që ia arritën të nxjerrin gurë të mjaftueshëm, filluan të ndërtojnë edhe objekte tjera ndihmëse në truallin e tyre. Ndarja definitive e njerëzve dhe kafshëve në objekte të veçanta, kërkonte edhe ndërtimin e plemes brenda truallit të shtëpisë. Edhe ndërtimi i plemeve kishte kaluar nëpër faza të ngjashme sikurse ndërtimi i shtëpive. Në fillim sigurohej vetëm një stallë për të gjitha llojet e kafshëve. Varësisht nga standardi dhe faza e ndërtimit, ato ishin të punuara nga druri apo guri. Me kalimin e kohës ndërtoheshin stalla të veçanta për secilin lloj të kafshëve. Më tutje mbi këto stalla, zakonisht të punuara nga muret e gurit, ngritej edhe një kat tjetër për ta ruajtur ushqimin e kafshëve gjatë dimrit. Kati ku ruhej ushqimi i kafshëve punohej nga skeleti i drunjtë, në mënyrë që tek plemja të mbushet dhe të zbrazet sa më lehtë me ushqim të kafshëve, si ky kat të ajroset më mirë gjatë stinëve të ndryshme. Kështu, trualli i banuar fitoi edhe një objekt të rëndësishëm për strehimin e kafshëve dhe për ushqimin e tyre. Në këtë kohë të ndërtimit me gurë, plemja ishte më e ngushtë se shtëpia, afër 4



*Oborr i vjetër;
shtëpia, hambari,
plemja, rrethoja*



*Relief
kulmor*

metra në përmasa të jashtme. Ajo kishte një gjatësi gati të ngjashme me shtëpinë, rreth 10 metra dhe zakonisht plemja e shtëpia qëndronin ballë për ballë njëra-tjetrës. Po ashtu, edhe lartësia e tyre ishte e ngjashme, nëse shtëpia ishte njëkatëshe edhe plemja ishte njëkatëshe. Nëse rritej numri i banorëve të shtëpisë dhe begatia e tyre ekonomike, atëherë rritej edhe numri i kafshëve shtëpiake dhe përmasat e plemes. Objekte tjera ndihmëse brenda oborrit ishin edhe hambari, dyert dhe rrethoja e oborrit. Edhe këtu guri ishte material i pashmangshëm ndërtimor dhe bashkë me objektet tjera më të mëdha, formonin një truall të qëndisur me gur dhe një pamje tipike të oborrit stubllan të asaj kohe.

FUTJA NË PËRDORIM E HEKURBETONIT DHE TULLAVE FABRIKATE (PERIUDHA NGA ÇEREKU I FUNDIT I SHEKULLIT 20)

Futja në përdorim e këtyre materialeve të reja ndërtimore, e zvogëloi sferën e përdorimit të gurit dhe drurit. Pjesët vertikale të objekteve punoheshin nga tullat fabrikate me madhësi dhe materiale të ndryshme. Ndërsa pjesët horizontale ndërtoheshin nga hekurbetoni. Hekurbetoni dhe tullat kombinoheshin në forma dhe pjesë të ndryshme të objektit. Sidomos pllakat e hekurbetonit ndërmjet kateve të shtëpisë ofronin një qëndrueshmëri dhe statikë të mirë për objektin. Mirëpo, stubllanët edhe pas këtyre përparimeve teknologjike, nuk ia kthyen shpinën gurit. Guri, deri më tash, ka mbetur material i pazëvendësueshëm për muratimin e bodrumeve në Stubëll. Edhe guri është një material që kombinohet shumë mirë sidomos me hekurbetonin. Shtëpi të shumta të ndërtuara edhe në dekadat e fundit, kanë mure të tëra nga guri. Pronarë të shtëpive kanë veshur me gurë muret dhe pjesët më të bukura të shtëpive të tyre. Po ashtu guri edhe tash haset në forma të ndryshme në oborret dhe shtëpitë stubllane; si dekorim i rrethojës së oborrit, dyerve të oborrit, arkës së pusit të ujtit, si oxhak dekorues në dhomat e ditës, etj. Përdorimi i hekurbetonit ka mundësuar edhe modifikimin apo largimin nga forma tradicionale e planit



Ndërtimet e reja

të shtëpisë. Përpjekjet e viteve të fundit për t'u larguar nga baza katrore dhe format kompakte të fasadave e kulmeve, me gjithë përdorimin e materialeve të reja dhe rritjes së standardit ekonomik të pronarëve, nuk kanë arritur të zhvillojnë një stil të ri arkitektonik dhe as t'i plotësojnë dëshirat e pronarëve. Mundësitë për zhvillimin e një stili të ri kanë dështuar në kopjimet që janë sjellë nga vendet e ndryshme, ku kanë punuar pronarët e shtëpive të reja. Aftësimi i kuadrove të reja në lëmenjtë e arkitekturës, ndërtimtarisë dhe muratorisë, ka sjellë viteve të fundit nevojën e ballafaqimit serioz të pronarëve me arkitektët e rinj dhe vetëdijesimin e popullatës për artin e ndërtimit. Shumë pronarë të rinj janë kthyer te tiparet që kanë treguar sukses gjatë historisë. Ata më nuk ndërtojnë pallate të vetëprezentimit, por i kushtojnë më shumë rëndësi racionalizmit dhe funksionalizmit në kombinim me estetikën tradicionale. Nga këto parime dhe nga këshillimet me arkitektët e rinj, mund të rezultojë edhe estetika e bazuar e objektit dhe realizimi i dëshirave personale të pronarit. Zhvillimet e reja, në Stubëll frymëzuan edhe ndërtimin e objekteve interesante arkitektonike; si shtëpi banimi, ambulanca dhe objekte te vogla shoqërore.

OBJEKTET INTERESANTE

*Kisha e Vjetër – Muze dhe Shkolla e Parë Shqipe në Kosovë
(Viti i ndërtimit 1896)*



*Kisha
e vjetër*

Themelimi dhe ndërtimi i Kishës së Vjetër (Shkollës së Parë Shqipe në Kosovë) është i lidhur ngushtë me angazhimin e Mësuesit të Parë Don Mikel Tarabulluzit. Në të njëjtin vit, kur ishte emëruar Famullitar i Letnicës, më 1896 ai fillon edhe ndërtimin e kishës, që do të shërbejë edhe si shkollë. Objekti, për shkak të rrethanave të atëhershme, është i “fshehur” dhe nuk ka pasur përmasa të një kisha të sotshme. Mirëpo rëndësia e tij historike dhe kombëtare e ka shndërruar në një muze dhe qendër kulturore për rrethin e Stubllës. Nga Legalizimi i Shkollës më 1905, kishës i shtohen gjithnjë pjesë të reja dhe i kushtohet kujdes të madh mirëmbajtjes dhe renovimit të saj. Trualli i Kishës së Vjetër sot është një qendër kulturore. Objekti i sotshëm, njëkohësisht edhe Muze i Fshatit, vizitohet sidomos në fund të muajit shtator, kur mbahet manifestimi tradicional vjetor “Takimet e don Mikelit”.



*Oborri i
Kishës së Vjetër*

*Kisha e Shën Jozefit – Kisha e Re
(Viti i ndërtimit 1969)*



*Ndërtimi i
Kambanorës së
Kishës*



Kisha e Re sot

Në krahasim me Kishën e Vjetër, ky objekt është shumë me i madh dhe më i shfaqur. Kisha e re ka një formë dhe një bazë klasike të kishave. Në mes të anijatave anësore ndihmëse më të vogla, ndodhet anijata qendrore që përmban pjesët kryesore të kishës. Orientimi jug-veri i anijatës qendrore ndan kishën simetrikisht në këtë drejtim. Dyert e hyrjes, vendi i korit dhe kambanorja

e kishës qëndrojnë njëra mbi tjetrën dhe përbëjnë pjesën e parë të anijatës qendrore. Hyrja qendrore nga jugu shpie në pjesën e fundit të kishës ku janë të vendosur pjesët kryesore të kishës altari, tabernakulli, pagzimorja dhe truporet. Pjesët qendrore të tri anijatave janë të parapara për ulëset e

pjesëmarrësve në meshë. Në pjesën jugore të anijatave ndihmëse, janë të vendosura rrëfyestoret, kurse në pjesën perëndimore sakristitë. Ndërtimi i kishës është rezultat i punës vullnetare të banorëve të Stubllës. Mjeshtërit e fshatit janë përkujdesur që t`i nxjerrin vetë gurët, t`i bartin, t`i gdhendin dhe ta ndërtojnë kishën. Punimi i kishës me përmasa të tilla të objektit me gurë aq të mëdhenj, ishte ndërtimi i parë i atij lloji.

Objektet tjera

Shkolla e tashme e fshatit është ndërtuar gjatë kohës së komunizmit (1980) dhe aktualisht funksionon si shkollë fillore dhe e mesme për nxënësit e Stubllës dhe të disa fshatrave përreth. Objektin e karakterizon arkitektura e zakonshme e kësaj kohe; mbi bazën kënddrejte janë të ngritura tetë klasat e shkollës dhe dhomat tjera të nevojshme të ndara në dy kate.

Po ashtu, edhe objektet e reja shoqërore, të ndërtuara viteve të fundit, si Ambulanca e Fshatit, Qendra Rinore, Skena e Takimeve të don Mikelit, Sheshii Fshatit, i japin vendbanimit një pamje bashkëkohore dhe janë rezultat i punës dhe i kontributeve të përbashkëta të banorëve dhe të famullitarit aktual, don Rrok Gjonlleshaj. Don Rroku ndjek rrugën e paraardhësve të tij, që nga don Mikeli, Don Lluka, Don Jaku, duke kontribuar kështu edhe në ngritjen e objekteve me rëndësi historike dhe kulturore për Stubllën. Projektues i objekteve të përmendura, me përjashtim të shkollës, është arkitekti vendor, Kristë Gjergji. Ai ka projektuar edhe shumë objekte tjera të banimit dhe është arkitekti i parë i arsimuar stubllan.

MJESHTËRITË

Nevoja e nxjerrjes, përpunimi dhe përdorimit të gurit, rezultoi me zhvillimin e mjeshtërisë së muratorisë, mjeshtri kjo që gjatë historisë do t`iu sjellë banorëve të fshatit sigurinë materiale. Profesione të mullisit dhe tjegullarit, edhe pse tashmë të tejkaluara, gjithashtu siguruan “bukën e gojës” dhe “një kulm mbi kokë”.

Muratorët

Mjeshtëria më e përhapur dhe më e zotuar nga stubllanët, është padyshim matoria. Përvetësimi i këtij profesioni ishte përqafuar nga banorët e këtushëm, për shkak të përparësive që sillte aftësimi për përpunimin dhe përdorimin e gurit të Stubllavaçës. Njohja e kësaj mjeshtërie për burrat stubllanë, ofronte, në radhë të parë, mundësinë e ndërtimit të një shtëpie për familjen e tyre. Më vonë, këtë mjeshtri ata do ta përdorin në shumë



*Një grup mjeshtresh
- gurëgëdhendës
nga Stublla*

vende të rajonit dhe Evropës. Muratorët stubllanë, sidomos pas Luftës së Dytë Botërore, aftësitë e mësura në vendlindje i bashkuan në grupe të mjeshtërve dhe kështu formuan ndërmarrje të vogla që ishin të kërkuara si në vendlindje ashtu dhe në vise të ndryshme të Kosovës dhe Maqedonisë. Ishin të pakët ata burra që nuk ishin të aftësuar për muratimin me gurë. Ata që përvetësonin këtë punë nuk e kishin fare vështirë të bëheshin muratorë të përgjithshëm. Muratorët stubllanë krijuan një lidhje të pandashme me gurin. Profesionin e tyre e “trashëgonin” prej prindërve apo te afërmeve dhe zotonin me përpikëri. Çdo shtëpi e re e ndërtuar me gurë ishte një mësim më tepër dhe çdo punëtor i ri ishte një ndihmë për brigadat e shumta të muratorëve që formoheshin në Stubëll. Edhe në gjysmën e dytë të shekullit 20 muratorët stubllanë fitojnë besimin e shumë udhëheqësve të ndërmarrjeve ndërtimore në Kosovë, Maqedoni, Zvicër, Austri, Gjermani e gjetiu. Shumë prej tyre janë ndërtimtarë dhe muratorë me pasion. Muratorët pleq flasin me orë të tëra për arritjet e tyre të kaluara në kushte të vështira ekonomike dhe teknologjike, kurse muratorët e rinj dëshmojnë cilësitë e tyre edhe me metodat dhe materialet e reja ndërtimore. Aftësitë e muratorit ata i përdorën në ngritjen dhe zbukurimin e shtëpive të tyre, të fqinjëve dhe të afërmeve të tyre dhe në përvetësimin e mëtutjeshëm të profesionit. Muratoria edhe sot nuk është profesion i lehtë dhe i paguar ashtu si duhet, mirëpo në rrethana historike të Stubllës është profesioni

që padyshim iu ka siguruar banorëve të fshatit ekzistencën ekonomike dhe një standard mesatar jetësor. Shuma e të ardhurave dhe punëve të kryera nga muratorët e Stubllës, është padyshim faktori më i rëndësishëm për gjendjen ekonomike të stubllanëve në vendlindje dhe diasporë.

*Mulliri i Letnicës,
tipik me mullinjtë
e dikurshëm të
Stubllës.*

Mullisët

Mullinjtë me ujë të stubllanëve gjatë viteve të gjashtëdhjeta dhe shtatëdhjeta të shekullit 20, shtriheshin përgjatë lumit të Letnicës, që nga fshati Gërçar e deri në Letnicë. Këta mullinj ishin një burim i sigurimit të bukës, por kërkonin edhe një punë të gjatë dhe të mundimshme gjatë sezonit të bluarjes së drithërave. Mullisët, së bashku me bagëtinë e tyre, qëndronin me javë të tëra pranë mullirit. Për këtë arsye mullinjtë kërkonin një punë dhe kujdes gjatë ndërtimit, sepse ata ishin edhe objekte sezonale të banimit për mullisët dhe kafshët e tyre. Mulliri kishte dhomën e bluarjes së drithërave, zakonisht ndaras për misër dhe grurë, pastaj dhomën e mullisit, që i shërbente për fjetje dhe pushim si dhe për ruajtjen e mullirit gjatë ditës,



si dhe një dhomë ndihmëse për drithëra dhe ruajtjen e gjësendeve tjera. Edhe ky profesion zhvillohej si një ndërmarrje familjare apo bashkim i punës së disa familjeve të afërta dhe “siguronte bukën” këtyre familjeve. Shuarja e mullinjve filloi me zgjerimin e rrjetit elektrik dhe me përhapjen e mullinjve elektrikë. Nga mullinjtë e dikurshëm stubllanë, sot nuk kanë mbetur as gërmadhat e tyre.




Një pjesë e madenëve të Stubllavaqës, prej nga është nxjerrur guri për latim dhe ndërtim.

kanë marrë formën e tyre të ngurtë, ndërsa byku është kujdesur që ato të mbeten në atë formë të qëndrueshme. Zakonisht këto tjegulla, të quajtura edhe “qeremide magjupit”, kanë pasur një gjatësi rreth 25-28 centimetra dhe një profil në formë gjysmëharku me diametër rreth 10-12 centimetra. Pjekja e tjegullave funksiononte si një ndërmarrje familjare dhe vetëm gjatë sezonës së përshtatshme me mot të mirë. Pas hyrjes në përdorim të tjegullave fabrikate nga çereku i fundit i shekullit 20, filloi edhe shuarja e furrave të tjegullave në fshat. Ndër furrat më të njohura dhe të mbetura në kujtim të banorëve të moshuar, është furra e tjegullave e Palës Gapit (Demaj). Një zbulim i veçantë është bërë në vitin 2000 edhe në oborrin e Gjon Gjergjit (Koliq). Ai, gjatë gropimit në oborrin e tij, ka hasur në një furrë shumë të vjetër tjegullash. Gërmadhat e këtij objekti në formë bodrumi me gjashtë harqe dhe prania e tjegullave në ato gërmadha, tregon për ekzistimin e një furre shumë të vjetër. Gjithashtu edhe gjetja e monedhës që datonte nga viti 1638, po në të njëjtin vend, tregon për zhvillimin e hershëm dhe mjaft profitabil të këtij profesioni në këto treva.

Tjegullarët

Profesioni i prodhuesit të tjegullave është njëri prej profesioneve më të hershme të praktikuara në Stubëll. Lëndë e parë, sikurse edhe në rastin e gurëve, e dhuronte natyra dhe ajo nuk ishte larg vendbanimeve. Dheu i përshtatshëm për tjegulla, që zakonisht është nxjerrë nga sipërfaqet e tokave rrëzë Stubllavaqës apo rrëzë pjesës së vjetër të fshatit, është përzier me ujë dhe pak byk të kashës. Lloçi është përzier mirë dhe format gjysmë të lëngëta janë vendosur mbi kallëpe në furra. Pas ndikimit të temperaturave të larta, tjegullat





VI

STUBLLA

THIRRJET SHENJTE NË STUBËLL

VI

Thirrjet shenjte në Stubëll

*Jezu Krishti thërret:
“Ejani mbas meje”! (Mt 4, 19)*

Famullia e Stubllës, e cila këtë vit (2005) po kremton 100-vjetorin e themelimit të saj, me plot të drejtë mund të quhet vend i zgjedhur i Zotit. Pikërisht me të Zoti u shërbye duke nxjerrë nga ai djem e vajza, të cilët do t’i kushtohen Atij dhe popullit me tërë jetën e vet. Në të njëjtën kohë, ky është një hir i madh i Zotit, i cili iu dhurua kësaj famullie. Stublla, edhe pse sikur dukej ishte e strukur mes maleve, megjithatë nuk do të mbetet një vend i parëndësishëm i kësaj ane, por e kundërta.

Sa për simbolikë, mund ta krahasojmë me një vend biblik, jo shumë të njohur, përderisa në të nuk ndodhi ngjarja më e rëndësishme për mbarë njerëzimin – Lindja e Jezu Krishtit: “E ti, o Betlehem, tokë e Judës, ti nuk je kurrsesi më i parëndësishmi ndër qytetet princore të Judës...” (Mt 2, 6a). Në këtë aspekt, edhe famullia e Stubllës, duke marrë parasysh se Zoti u shërbye me të duke i dhënë shumë meshtarë, rregulltarë e rregulltare, nuk mund të themi se është vend i parëndësishëm në historinë e popullit tonë. Viti 2005 marrë në përgjithësi, jo vetëm për Stubllën, por për gjithë shqiptarët, është i një rëndësie të veçantë. Këtë vit po përkujtojmë 600-vjetorin e lindjes së heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastriotit, si dhe 450-

vjetorin e veprës së parë shqipe të njohur deri më tani, “Meshari” i Gjon Buzukut.

Ky shkrim ka për qëllim të jetë një kontribut ynë i vogël, duke patur për trajtesë thirrjen shenjte, element ky i rëndësishëm, me të cilin edhe sot shpesh identifikohet famullia e Stubllës.

Për të pasur një pasqyrë sa më të gjerë në lidhje me thirrjen shenjte, jemi munduar të përfshijmë këtë element në aspekte të ndryshme, duke u bazuar në rend të parë në Shkrimin Shenjt. Kështu psh. në librin e Zanafillës hasim në komunikim të drejtpërdrejtë të Zotit me njeriun; pastaj Zoti komunikon me njerëzit përmes patriarkëve e profetëve, pra njerëzve të zgjedhur, të cilët i karakterizonte jeta e virtytshme. Kulminacioni i komunikimit të Zotit me njeriun arrihet në personin e Krishtit, i cili i thërret njerëzit ta ndjekin rrugën e tij. Me themelimin e sakramenteve Jezu Krishti, përpos tjerash, bën që thirrja shenjte ta ketë një orientim të qartë si dhe një kuptim të plotë të vetin. Më pas vëmendja jonë do të përqendrohet pikërisht në dërgimin apo misionin e shenjtit të apostujve për të përfunduar shkurtimisht me kontributin e klerikëve dhe motrave të nderit nga Stublla në vreshtin e Zotit. Para se të flasim mbi këto argumente, le të themi disa fjalë mbi thirrjen në përgjithësi.

FARA E MBJELLË NË TOKË TË MIRË

Sa herë që duam të flasim mbi çështjet që kanë të bëjnë me thirrjen shenjte, duhet theksuar se gjindemi para një misteri, mbi të cilin nuk mund të flasim sikur për disa faktorë ashtu thjeshtë të natyrshëm të thirrjes. Pa dashur të flasim mbi faktorët e pakapshëm të hirit të Zotit, duket sikur arsyet e natyrshme të thirrjes veprojnë në dy lëmi thelbësore të njeriut, si në mënyrë ashtu edhe në kohë të ndryshme. E para është sfera e zemrës (vullneti dhe ndjenja) ndërsa sfera tjetër përfshinë mendjen, intelektin e njeriut. Zemra është ajo që dëshiron diçka edhe pse nuk e kupton, ose nuk e kupton në masë të duhur atë që dëshiron. Mendja, në anën tjetër, pasi ta ketë njohur dëshirën e pranon atë dhe nxitë zemrën që të merr vendim. Kështu ndodh me zemrën e një fëmije apo të një të riu, i cili ka vullnet (është i nxehtë) për thirrje, por që ende nuk e ka kuptuar se çka do të thotë të jesh meshtar, rregulltar apo rregulltare. Gjithsesi nuk duhet të mungojë angazhimi që të përgatitet një terren i mirë që fara e mbjellë të hasë në tokë të mirë.

Një djalosh i vogël, i cili e sheh famullitarin e vet si njeri të dalluar në virtyte, i cili flet mirë në masë, është i dashur, i don fëmijët, patjetër që do të reflektojë pozitivisht tek ai fëmijë, i cili një ditë thotë :”edhe unë

do të bëhem si ai”. Njëjtë është edhe me vajzat, të cilat në motrën e nderit shohin një person të shkëlqyeshëm, të cilën e nderojnë të gjithë, është e afërt, e dashur dhe në shërbim të njerëzve, e gjithë kjo nxit në to vullnetin “edhe unë dua të bëhem motër e nderit”. Nëse ndalemi dhe mendojmë mbi këto argumente, e vërejmë se sa të thjeshtë që janë, po aq kanë rëndësi sa u përket thirrjeve të reja. Kjo argumentohet edhe me thirrjet e shumta në famullinë e Stabllës. Mirëpo, kjo vlen edhe për të gjitha vendet në përgjithësi. Pra, dëshmia e mirë e meshtarëve dhe në përgjithësi e njerëzve të kushtuar, është një nxitje e fuqishme që të rinjtë dhe të rejat të motivohen, t’i mposhtin frikën dhe dyshimet, të marrin guxim dhe të jenë të vendosur ta fillojnë këtë rrugë. Poashtu, edhe gjatë veprimtarisë pastorale, qoftë gjatë katekizimit, organizimit të takimeve dhe lutjeve për thirrje shenjte, kujdesit në formimin e ministrantëve etj., krijohet mundësia e re që të rinjtë dhe të rejat t’i njohin më mirë talentët e vet, por edhe të dijnë ta identifikojnë zërin e Zotit për t’u përcaktuar për këtë vendim të guximshëm që ta ndjekin Krishtin. Në po atë masë, familja dhe e gjithë bashkësia e krishterë duhet të jetë e angazhuar në promovimin e thirrjeve shenjte (Khs. PO 11; C.I.C., kan. 233, p.1).

HYJI THËRRET NË JETË

“Hyji është Hyj i të gjallëve, sepse të gjithë për të jetojnë” (Lk 20, 38). Eksistenca e secilit është fryt i dashurisë dhe fjalës në vepër të Atit qiellor. Edhe vetë akti i krijimit të njeriut ka një dinamikë apo apel të një thirrjeje në jetë. Njeriu vjen në botë prej dashurisë së madhe të Zotit, dashuri kjo e shprehur ndaj njeriut para se të ishte trajtuar në kraharorin amënor (Jer 1, 5; Is 49, 1. 5; Gal 1, 15).

Në Librin e Zanafillës mësojmë mbi krijimin e njeriut, por edhe mbi virtytet, me të cilat ai fiton dinjitetin e vet. Pra, është subjekt, i cili thirret në komunikim dhe bashkëpunim me Zotin. “*Hyji tha: Le ta bëjmë njeriun në shëmbëlltërinë dhe përngjasimin tonë...*” (Zan 1, 26). Edhe më tepër njeriu është i thirrur, pa marrë para sysh vogëlsinë dhe gjitha kufizimet tjera që e karakterizojnë atë në ekzistencën e vet, t’i përngjajë në jetë Krijuesit të vet. Në këtë perspektivë të thirrjes ka një gjë që duhet përjashtuar: se lindja jonë nuk është e rastësishme. Dashuria është kuptimi i plotë i jetës. Në këtë dashuri njeriu është i aftë ta njohë dhe ta pranojë thirrjen shenjte, të cilën, jo që e meritojmë në saje të veprave tona, por që na jepet në saje të vullnetit dhe hirit të Zotit (1 Tim 1, 9). Prandaj, me gjithë vetveten dhe gjatë gjithë jetës, duhet t’i përgjigjemi thirrjes së Zotit, duke mbajtur urdhërimet e tija (Urt 3, 1).



*Meshtarët e Stubllës
duke kremtuar
meshën shenjte në
kishën e shën Jozefit*

Një kujdes të madh ndaj njerëzimit Zoti e dëshmon vazhdimisht edhe përmes etërve e profetëve, duke mbajtur kështu një lidhje të ngushtë me të. Edhe në kohërat më të vështira (Shih Përmbytja, Zan 6, 5-7, 24) Zoti shërbehet me njerëzit e drejtë, që të mbijetojë krijesa e tij. Në rastin tjetër, Zoti thërret Abrahamin (Zan 12, 1-4) në një mision të ri. *“Unë e zgjedha Abrahamin që t’i mësojë bijtë e vet pas tij si dhe shtëpinë e vet e ta ndjekin udhën e Zotit, të bëjnë gjithë ç’është e mirë dhe e drejtë”* (Zan 18, 19). Në këtë mision ai e ka përkrahjen e vazhdueshme të Zotit. Mirëpo, kërkohet prej tij besnikëri dhe qëndresë e madhe duke kaluar nëpër sprova të mëdha. E gjithë kjo padyshim që i shpërblehet me premtimin dhe besëlidhjen, që do të del nga goja e Zotit: *“Abram, mos ki frikë! Unë jam mbrojtësi yt! Shpërblimi yt do të jetë shumë i madh!”* (Zan 15, 1).

Po në këtë kontekst, mund të vërehet kujdesi i Zotit për popullin e vet edhe te të gjithë profetët, posaqërisht te profeti i parë dhe më i madhi i BV, Moisiu. BR në të do të shohë prototipin e Jezusit profet. Zoti i zgjedh njerëzit për të arritur një qëllim të shenjtë, duke i angazhuar ata edhe kunder vullnetit të tyre. Kjo ndodh edhe me Moisiun i cili i përgjigjet Zotit: *“Më fal, o Zot, por ço dikënd tjetër!”* (Dal 4, 13). Me po të njëjtin ton dhe veprim do të reagojë edhe Jona profet (Krh. Jon 1).

Thirrja shenjte, të cilën Zoti ua drejton njerëzve, në fillim është krejt diçka personale. Kështu lexojmë edhe te Isaia profet: *“Të kam thirrë me emrin tënd...”* (Is 43,1), *“mos ki frikë, shërbëtori im Jakob, i dashuri im që vetë të kam zgjedhur”* (Is 44, 2b).

Thirrja i drejtohet një personi të caktuar. Mirëpo, qëllimi i thirrjes nuk është vetë personi. Në fakt, më tepër peshon misioni, të cilin Zoti ia beson një personi, se sa vetë personaliteti i tij. Nuk mund të mohohet fakti se njeriu mund dhe duhet të realizohet në thirrjen që i është besuar.

Kështu shkruan Jeremia profet: *“Fjala e Zotit më qe drejtuar e më tha: Para se të trajtoja në kraharorin amënor, të njoha e, para se të dilje nga gjiri amënor, të shenjtërova, të caktova të jesh profet i popujve* (Jer 1, 4-5).

Kjo thirrje e Zotit, të cilën e hasim edhe te Samueli (1 Sam 3), e te shumë profetë të tjerë, është dëshmi e mjaftueshme për ta kuptuar atë që Zoti dëshiron me popullin e vet. Padyshim, kulmi i këtij komunikimi në mes Zotit dhe njeriut do të ndodhë me Mishërimin e Fjalës së tij - Jezu Krishtit – Shpëtimtarit të botës.

“Mbasi Hyji herë mbas here dhe në mënyrë të ndryshme, në të kaluarën, u ka folur etërve tanë me anë të profetëve, së fundi, në këto ditë, na foli edhe neve me anë të Birit, të cilin e bëri trashëgimtarin e të gjitha sendeve, nëpër të cilin edhe e krijoi gjithësinë” (Heb 1, 1-2).

Jezu Krishti është i dërguar prej Atit që t’i thërrasë njerëzit. Dhe, çdo i thirrur nga ana e tij është një shenjë e Krishtit: në një mënyrë zemra e Tij, duart e Tija vazhdojnë të përkëdhelin të vegjlit, të shërojnë të sëmurët, të falin mëkatarët duke lejuar të kryqëzohet në kryq edhe më tutje prej dashurisë ndaj të gjithëve (Shih në dokumentin: *“Thirrjet e reja për një Evropë të re”*, Romë 1997).

DASHURIA MË E MADHE: TA JAPËSH JETËN

Jezu Krishti thërret: *“Ejani mbas meje”!* (Mt 4, 19) Në çka thërret Jezu Krishti? Që të ndiqet për së afërmi e atëherë do të mund të bëhemi dhe të veprojmë si Ai. Pra, Ai është shembulli se çfarë raporti duhet të kemi ndaj Atit tonë qiellor, por edhe ndaj njerëzve. Kjo do të thotë ta pranosh jetën si dhuratë të Zotit, por njëkohësisht duke e mohuar atë që më lirshëm të vihemi në ndjekjen e shembullit të Krishtit: *“Kush do ta ruajë jetën e vet, do ta bjerrë, kurse ai që e bjerr për shkak tëmin, do ta gjejë”* (Mt 16, 25). Te Jezu Krishti hasim në faktin unik që përbën kuptimin e plotë të dashurisë: dërgimin, misionin e tij të shenjtë. Ajo do të realizohet në kuptimin e plotë të fjalës pikërisht në kryq: *“Dashuria më e madhe që ndokush mund të tregojë është: të japë jetën e vet për miqtë e vet”* (Gjn 15, 13).

Çdo besimtar, në përgjithësi, është i thirrur t'i përngajë Jezu Krishtit në misionin e tij: “Sikurse më dërgoi mua Ati ashtu po ju dërgoj ju” (Gjn 20, 21) . Struktura e çdo thirrjeje, edhe më tepër pjekuria e saj, qëndron në vazhdimin e veprës së Jezu Krishtit në botë. Në këtë rrugëtim të thirrunit e kanë përkrahjen e tij, me fjalë tjera Krishti është ai, jo vetëm që thërret, por Ai ndihmon vazhdimisht në formimin e atyre që i thërret.

THIRRJA DHE DËRGIMI I APOSTUJVE

“Pastaj u ngjit në një mal e i thirri ata që deshë vetë. Ata shkuan tek ai. Dhe i emëroi të Dymbëdhjetët që të jenë me të e t'i dërgojë të predikojnë, e ta kenë pushtetin të dëbojnë djajtë” (Mk 3, 13-15). *“Të jenë me të”*: Në këto fjalë nuk është e vështirë të lexohet kujdesi i Jezu Krishtit ndaj apostujve për një formim sa më të mirë të thirrjes së tyre. Ai, pasi i thërret, e, para se t'i dërgojë, iu kushton kohë formimi më shumë se të tjerëve (Mt 13, 11) me qëllim që t'i përgatisë mirë për misionin që do t'ua besojë (Krh. PV 42).

Tema qendrore e predikimeve të Krishtit është Mbretëria e qiellit. Edhe pse BV nuk e njihë këtë koncept të jetës pas jetës, tashmë Jezu Krishti dëshiron që njerëzit ta shfrytëzojnë rastin e mirë, përderisa është Ai vetë me ta e ta kuptojnë urgjencën e njohjes, kthimit dhe pranimit të një koncepti të ri të të menduarit në raport ndaj Zotit. *“Koha u plotësua e Mbretëria e Hyjit është ngjat! Kthehuni e besoni Ungjillit!”* (Mk 1, 15).

Pastaj, në rastin konkret kur Krishti thërret nxënësit e parë (Krh. Mt 4, 18-22; Mk 1, 16-20; Lk 5, 1-11) bën përshtypje të thellë thirrja e çartë nga ana e Jezu Krishtit, i cili menjëherë iu tregon edhe arsytjen e thirrjes: “do t'ju bëj peshkatarë njerëzish”. Lirisht mund të themi se këto fjalë nxënësit menjëherë nuk i kishin kuptuar, por megjithatë ata vihen në ndekjen e tij, sepse kanë etje për gjëra të reja, aq më tepër në të shohin qëndrim bindës dhe autoritet. Pra, sa për fillim mjafton të lejosh të përshkojë fjala e atij që të don, pastaj gjërat, duke qenë në drejtim të duhur, zbulohen më mirë, pranohen më tepër dhe ashtu bëhen pjesë e pandashme e jetës së njeriut. Pra, sa rëndësi të madhe posaqërisht për njerëzit e kushtuar ka kjo gatishmëri e padyshim e nxënësve, të cilët: “Aty për aty i lanë rrjetat e shkuan pas tij”, do të tjerë “lanë të atin në lundër bashkë me mëditës dhe shkuan pas tij”. Padyshim, ky nxitim i nxënësve, apo ky përcaktim aq bindës i tyre në fillim do të kalojë nëpër sprova të mëdha. Ende në zemrat e nxënësve manifestohet në një masë të madhe ana emocionale: *“Atëherë Pjetri e ndau veças e filloi ta qortojë: Mos e thashtë Zoti, Zotëri! Ty s'do të ndodhë një gjë e tillë!”*; pastaj, mohimet tjera *“nuk e noh atë njeri”* (Mt 26, 69-74) etj. Mirëpo, krejt kjo do të përfundojë mirë, sepse dominon në nxënësit e

Krishtit mësimi apo ushqimi shpirtëror me të cilin ishin ushqyer. Dhe çka ndodh? Nuk ndodh dëshprimi i thellë sikur me Judën, i cili nuk e kishte pranuar këtë mësim, por pendimi me gjithë zemër, i cili meriton faljen. Atëherë Pjetri “*doli përjashta dhe qau me lot për faqe*” (Mt 26, 75b).

Dërgimi i të dymbëdhjetëve ka për qëllim vazhdimësinë e po asaj vepre, të cilën e filloi Jezu Krishti. “Gjatë udhëtimit predikoni: *Mbretëria e qiellit është ngjat! Shëroni të sëmurët, ngjallni të vedkurit... falas morët, falas edhe jepni!*” (Mt 10, 7-8).

Në këtë mision të shenjtë kërkohet një përcaktim shumë i vendosur. Nuk ka kompromis në zgjedhje. “*Kushdo, pra, pranon para njerëzve se është imi, edhe unë do ta pranoj para Atit tim që është në qiell, se jam i tij. E atij që më bie mohit para njerëzve, edhe unë do t'i bie mohit para Atit tim qiellor*” (Mt 10, 32-33). Krishti kërkon që të ndiqet në mënyrën e përsosur: “Shko shit çka ke e eja mbas meje!”, është fjala që e dëgjon djaloshi i pasur.

Jezu Krishti është kujdesur që të mos mbesim të pashpresë, “jetim” në aspektin shpirtëror pas vdekjes së tij. *Ai e mundi botën* (Gjn 16, 25...) prandaj na liroi nga e keqja, duke na e mundësuar një jetë të re, jetën me të: “*Jetoj, por jo më unë, në mua jeton Krishti*” (Gal 2, 20). Edhe më tej kështu do të dëshmojë shën Pali, i cili pasi e kishte kuptuar mirë atë çka Zoti kërkon prej tij, do të dëshmojë: “Sa për mua, mos e thashtë Zoti të mburrem me tjetër send, përveç me kryqin e Zotit tonë Jezu Krishtit” (Gal 6, 14). Edhe kjo dëshmi e shën Palit është një argument i fuqishëm i një përcaktimi sa më bindës në thirrje. Në këtë drejtim kemi shumë shembuj të mirë në ndjekjen e mësimëve të Jezu Krishtit, i cili do të premtojë dhe do të dërgojë Shpirtin e vet që t'i mbështesë të dashurit e vet të jetojnë për të. “*Dhe, ja, do ta dërgoj mbi ju Premtimin e Atit tim*” (Lk 24, 49). Kështu, ndërsa i bekonte të dashurit e vet, u nda prej tyre dhe u ngrit në qiell (Lk 24, 51). Këto janë vetëm disa prej dëshmimeve, të cilat kanë për qëllim të na mundësojnë një njohje më të mirë të kujdesit të Zotit ndaj njeriut, për të cilin erdhi në botë, ndërsa edhe më tepër këto dëshmi duhet të jenë frymëzim që edhe ne ta mbështesim jetën në Jezu Krishtin. Atëherë thirrja që na drejtohet do të hasë në tokë të frytshme e kjo do të mundësojë një realizim të plotë të krejt personalitetit tonë.

Pra, Krishti jeton me ne në bazë të premtimeve të tija, por në mënyrën më reale e takojmë gjatë kremtimit të sakramenteve shenjte, mbi të gjitha ne Euharisti. “*Dhe, ja, unë jam me ju gjithmonë - deri në të sosur të botës!*” (Mt 28, 20b). Ky është premtim i kthyer në realitet.

ZOJA E BEKUAR – NËNË DHE MODEL I THIRRJEVE SHENJTE

Ku ta gjejmë personin më të përshtatshëm që ta marrim si model të mirë të përgjigjes pa rezervë në thirrjen e Zotit? Padyshim nuk e kemi të vështirë këtë gjë, sepse, këtë përgjigje të përsosur e gjejmë në personin e Zojës së Bekuar.

Virgjëra e Nazaretit, që është edhe nëna jonë, padyshim që është për të gjithë ne shembulli më konkret se çfarë duhet të jetë përgjigja jonë në thirrjen që na drejton Zoti. Pra, prej saj mësojmë që me krejt jetën tonë t'i përgjigjemi thirrjes hyjnore. Shën Luka Ungjilltar, i cili më së shumti prej sinoptikëve flet për Zojën, sjell argumente të mjaftueshme për ta njohur butësinë amënore të saj. Gruan, e cila do të bëhet tempull i ri në të cilin do të banojë Zoti. Ajo duke qenë Nëna e Zotit, në të njëjtën kohë u bë nxënësja e parë e Tij. Ajo pranoi mbi vete ta bartë një pjesë të kryqit të Krishtit, duke u bërë kështu bashkëshëlbuese jona. Përgjigja e dhënë Zotit përmes engjëllit Gabriel është një përgjigje, e cila nuk mori fund me largimin e engjëllit prej pranisë së saj. Ajo “Po” e saj, e cila e miratoi Mishërimin e Zotit ishte një “Po” që duhej konkretizuar çdo ditë dhe në çdo rrethanë të jetës. Prandaj, për të gjithë ne është thirrje që ta kuptojmë mirë qëllimin e thirrjes që na drejton Zoti. Ai na thërret dhe kjo thirrje



Pikturë. Rembrandt van Rijn, Krishtit duke predikuar (rreth v. 1652)

duhet jetësuar në kuptimin e plotë të cilin ajo bart me vete. Të jemi të hapur ndaj Zotit dhe ndaj të afërmit ashtu si veproji Zoja. E hapur ndaj Zotit duke i besuar Fjalës së tij, por edhe në kujdes për të afërmit, sikur e vërejmë në dasmë në Kanë të Galileesë.

Posaqërisht jeta e çdo të kushtuari, duhet të jetë e karakterizuar krejtësisht nga këto dy komponente: nga Shërbimi ndaj Zotit dhe ndaj të afërmit. Në to përmblihet e gjithë dashuria dhe të gjitha urdhërimet.

NJË JETË E TËRË KUSHTUAR ZOTIT

Duke pasur para sysh kremtimin e këtij Jubileu të madh të famullisë së Stubllës, nuk mund të mos themi disa fjalë edhe për hirin e madh që përjetoj kjo famulli. Jemi dëshmitarë të një kujdesi të madh të Zotit, i cili, duke parë vuajtjet nëpër të cilat kaloj kjo popullatë, nuk e la pa e shpërblyer çdo lutje të kësaj popullate të devotshme, këtë përkushtim që ta dëshmoj Krishtin edhe në kushte e rrethana shumë të vështira. Aq më tepër, Zoti e shpërblei edhe çdo pikë gjaku të derdhun për shkak të besimit në Krishtin. Prandaj, Zoti u shërbye me këtë famulli që t'i japë popullit të vet meshtarë, rregulltarë e rregulltare – udhëheqës dhe edukatorë të popullit në realizimin e vullnetit të Zotit. Ata janë dëshmi e gjallë e shpërblimit të Zotit ndaj atyre që janë të palëkundshëm në fe dhe që i qëndrojnë besnik mësimit të tij.

Për një kohë të gjatë populli ynë përjetoj kalvare të ndryshme, kështuqë, fati i popullit ishte edhe fati i Kishës. Historikisht dihen persekutimet që përjetoj ky popull duke kaluar nëpër sprova dhe kryqe të cilat i përjetoj nga pushtues të ndryshëm.

Kur flasim për periudhën 100 vjeçare të famullisë së Stubllës, e kjo vlen edhe për të gjitha kohërat që kur u pranua krishterimi, duhet thënë se pikërisht Kisha ishte ajo e cila mbështeste popullatën në qëndrueshmëri për të ruajtur traditën dhe vlerat e veta fetare e kombëtare. Këtë mision të shenjtë, apo këtë dërgim, Kisha vazhdon ta kryej me përgjegjësi të madhe edhe në ditët tona sepse ajo është vepër e Krishtit – Kryemeshtar.

Të mësuar prej tij, si meshtarët apo rregulltarët, ashtu edhe motrat e nderit do të vihen jo vetëm në predikimin e Fjalës së Zotit, që ëshë një prej detyrave primare të tyre, por edhe në formimin dhe arsimimin e popullatës, me qëllim që mos të ketë stagnim në kohë.

Thirrjet shenjta nga Stublla duhet konsideruar si dhuratë të madhe të Zotit, dhe njëkohësisht, ato janë edhe një shpërblim i madh nga ana e Zotit për gjakun e derdhur të martirëve të shumtë të këtyre anëve. Vlen këtu të përmendet periudha e viteve 1846-1848, të cilën e karakterizon një

persekutim ndaj të krishterëve vetëm pse janë të krishterë.

Në këtë kontekst, me plotë të drejtë mundë të themi edhe ne fjalët e Tertulianit: “*Gjaku i martirëve është fara e të krishterëve*”.

Poashtu, thirrja shenjte është edhe fryt i lutjes, devotshmërisë, përkushtisë ndaj Zotit. Në këtë drejtim mund të pyesim: Si do të kishin qëndruar të palëkundshëm në fe të gjithë këta besimtarë, sikur të mos ishin të qëndrueshëm në lujte, të fortë në shpresë se Zoti do t'i shpëtojë?! Pra, Zoti nuk i harron vuajtjet e popullit të vet, por Ai kërkon që njerëzit të jenë të qëndrueshëm deri në fund.

Për sa i përket kontributit të meshtarëve të famullisë në fjalë, ai ishte dhe vazhdon të jetë i madh në lëmi të ndryshme: Në rend të parë, përkushtimi në jetën shpirtërore, duke qenë udhëheqës të tyre sipas shembullit të Bariut të Mirë (PO 6), por edhe në formimin intelektual të tyre përmes metodave të ndryshme që të arrihet një arsimim i mirëfilltë.

E njëjta gjë vlen edhe për motrat e nderit, të cilat me shumë kujdes angazhohen të punojnë qoftë me fëmijë, të rinj e të reja, duke mos harruar kurrë kujdesin ndaj të moshuarve. Vlen të përmendet kujdesi i tyre ndaj njerëzve, përpos atij shpirtëror, edhe ai shërbim me zemër ndaj të sëmurëve, qoftë me shërbimet nëpër qendrat ambulatore, qoftë me vizitat që i'u bëjnë edhe nëpër shtëpitë e tyre. Është e qartë se vetëm në



*Cosimo Rosselli,
Predikimi në mal,
freskë në kapelën
Sikstine (rreth v.
1481/82)*

shërbim dhe flijim me dashuri mund të kuptohet qëllimi i thirrjes. Nga Famullia e Stubllës dolën 29 meshtarë, prej tyre 22 janë të gjallë, dhe mbi 50 motra të nderit.

Sot, njerëzit e kushtuar Zotit nga kjo famulli, përpos në Kosovë, veprojnë edhe në Shqipëri e kudo në trojet shqiptare. Disa prej tyre veprojnë në Evropë e deri në SHBA. Gjithësesi, edhe kjo është dëshmi e mirë që kudo që jemi nëpër botë të mundë të ruajmë vlerat tona si popull, i cili e dëshiron të ardhmen e vet në paqe me Zotin. Pra, në këtë drejtim, edhe pse të shpërndarë nëpër botë, vazhdojnë ta kenë këtë përkujdesje nga ana e Kishës lokale.

NË PËRMBYLLJE

“Zotëri, na e dëfto Atin e na mjafton!” (Gjn 14, 8). Edhe pse jemi të përcaktuar në vendimin tonë për ta ndjekur shembullin e Krishtit, patjetër, kemi nevojë që vazhdimisht ta ushqejmë dhe formojmë thirrjen që na është besuar. Prandaj, uroj që edhe ky shkrim të jetë një ndihmesë e vogël në atë drejtim. Folëm mbi thirrjen si dhuratë e Zotit, hir me të cilin na pajisi Zoti. Në këtë vit (2005) kushtuar Euharistisë, ta lusim Zotin gjithmonë të qëndrojë me ne, si fuqia jonë më e madhe; që gjithmonë të kemi mundësi për ta kryer vullnesën e tij. Thirrja në shenjtëri, në jetë të virtytshme, është thirrje që i drejtohet çdo të krishteri, pa marrë para sysh gjendjen e tij në të cilën jeton. Qoftë në martesë, qoftë në jetë të kushtuar, secili në mënyrën e vet është i thirrur ta kryejë me përgjegjësi thirrjen që i është besuar.

Me rastin e këtij Jubileu, të gjithë ne të kushtuarit, duke marrë për shembull Mësuesin tonë, Jezu Krishtin, duhet të mundohemi që me plotë të drejtë t'i përsërisim fjalët e shën Palit: *“Prandaj, gjithkush le të na mbajë për shërbëtorë të Krishtit e për mbarështues të mistereve të Hyjit”* (1 Kor 4, 1)

E falënderojmë Zotin për këtë hir që i ka dhënë famullisë sonë, e me këtë, Kishës vendore dhe në përgjithësi asaj universale. E falënderojmë Zotin për të gjithë ata meshtarë, rregulltarë e rregulltare që kanë shërbye në këtë famulli dhe që me jetën e tyre ishin zëri i Zotit, i cili i thirri edhe shumë të rinj e të reja nga kjo famulli për të ndjekur udhën e Zotit. Bota moderne sot ka nevojë të madhe për thirrje të reja shenjta, prandaj e lusim Zotin *“të dërgojë korrtarë në të korrrat e veta”* (Mt 9, 38).

“E Atij, që, në saje të fuqisë që vepron në ne, mund të bëjë shumë më tepër se ne mund të kërkojmë ose edhe mund të mendojmë, Atij i qoftë Lavdia në Kishë e në Jezu Krishtin në të gjitha breznitë e jetës së jetëve.” (Ef 3, 20-21).

5 VJETORI
SHK
NËNA
TEREZE



ITAKIMET NË VJETORI
E DOM I LUMTURIMIT
MIKELIT TË NËNA
E LECCO 2004 TERE

VII

STUBLLA

STUBLLASIT NË MËRGATË

VII

Mërgata

Mërgimi nuk është dukuri e kohës bashkëkohore, por ajo ka ekzistuar qysh në fillimin e historisë. Sot ky fenomen është intensifikuar dhe ka marrë përmasa universale. Edhe Stublla ishte e përfshirë nga ky fenomen gjatë shekujve. Stubllasit herë ishin të detyruar të mërgonin, herë e lëshonin vendin për shkaqe personale dhe familjare.

Mërgimi është një ngarkesë e rëndë familjare, që në literaturën botërore quhet edhe si „live events“ (ngjarje kritike në jetë). Në të vërtetë, çdo ndryshim i rrethit përbën një sfidë, një lloj të ridefinimi apo të rishqyrtim të identitetit. Duke pasur para sysh se vendbanimi i ri, si ai i mëparshmi, i mbetur tanimë histori e kaluar, janë pjesë e identitetit të njeriut; ndërrimi i vendbanimit e detyron personin që të aktivizojë resurset e përshtatjes në vendin e ri, e, në të njëjtën kohë, mbetet nostalgjia për të humburën, mbete dhembja e shkëputjes nga vendbanimi i vjetër.

Ky fakt na detyron të themi se fati i shumë familjeve stubllase, kudo në vendbanimet e reja, në të cilat janë vendosur, ishte dhe është i lidhur ngusht me aftësinë e tejkalimit të sfidave në rrethet e reja, në mënyrën e re të jetesës, po ashtu edhe në përshtatjen e kushteve të punës, banimit, edukimit...

1. MËRGIMTARËT E PARË (SHEK. 19 DHE FILIMI I SHEK. 20)

Migrimi i parë masiv i stubllasve ishte ai në Turqi, në vitet 1846-48, i njohur si “Martirët e Karadaku”, që e kishte shkakuar dhunshëm Perandoria osmane, duke mos pranuar të vërtetën e shqiptarëve katolikë që ta praktikojnë publikisht fenë e tyre. Për këtë ngjarje janë bërë studime të veçanta dhe konsiderohet një kapitull i veçantë i stubllasëve.

Në fillim të shekullit 20 paraqiten lëvizje të stubllasve në drejtim të Australisë dhe Amerikës. Sipas gojëdhënave të fshatarëve, një grup i vogël i stubllasve migrojnë në Amerikë (rreth viteve 1905 deri në 1930 e ndoshta edhe më vonë), me qëllim të punësimit të përkohshëm për ta përmirësuar gjendjen e rëndë ekonomike familjare. Dihet se Marki i Zenelit kishte qëndruar në Amerikë rreth 5 vite (ndoshta edhe më tepër) dhe mandej kthehet në Stubëll, kurse me të hollat që i fiton, e ndërton shtëpinë e vet, e cila edhe sot është e pashkatërruar dhe konsidrohet një ndër shtëpitë më të vjetra në Stubëll. Por fatkeqësisht pjesa tjetër e të mërguarve (jo numër i madh), nuk kthehen më në vendlindje; njëri prej tyre – sipas dëshmisë së të kthyerit – kishte vdekur në vendin e punës në Amerikë dhe vorrosjet atje, sepse nuk kishin të holla që ta transferonin kufomën në vendlindje. Një ndër arsytet e moskthimit ishte edhe largësia e madhe gjeografike dhe pamundësitë për komunikime të shpeshta, në atë kohë, me familjarët. Ky edhe ishte shkaku që shumica e tyre të asimilohen dhe faktikisht nuk dihet më asgjë për ta.

Në kohën e Luftës së Dytë Botërore disa stubllas ishin të inkuadruar në ushtrinë (fashiste) e që me tërheqjen e saj, duket se janë vendosur në Gjermani e Austri, me çka ata humbin çdo gjurmë. Arsyet e moskthimit supozohet të kenë qenë më tepër të karakterit politik. Ndërsa lëvizjet e stubllasve brenda ish-Jugosllavisë kanë qenë “normale”, ku shkonin e punonin në vendet bregdetare, sidomos në Kroaci, sidomos në sezonat verore. Stubllasit kanë qenë mjeshtrë në ndërtimtari, e, sidomos, ishin të njohur si gurgdhendës shumë të mirë (edhe sot).

Si punëtorë të ndërtimtarisë shkonin e punonin edhe nëpër vende të tjera, si psh., pas viteve 50-ta në Libi, në Çekoslllovakë (Çekia dhe Sllovakia e sotme), më vonë edhe në Irak. Puna e tyre në këto vende ishte e përkohëshme dhe ky grup punëtorësh nuk kishte treguar interesim për t`u vendosur në këto vende.

2. ZANAFILLA E NJË MËRGATE TË VËRTETË STUBLLASE

Fluksi i mërgimit më serioz i popullatës stubllase në vendet perëndimore zhvillohet në vitet e 70-ta të shek. 20.

Personat që “nuk kishin fatin” për një punësim në vendlindje, fatin e tyre filluan ta kërkonin jashtë vendlindjes. Gjermania dhe Austria fillimisht ishin më të preferuarat. Gjithë kjo lëvizje e banorëve të Stubllës kryesisht bëhej për të përmirësuar gjendjen familjare, ekonomike në vendlindje. Kjo valë e emigrantëve me punë sezonale, pasi kthehen në vendlindje, sjellin me vete “risi” të lakmueshme, që nxitën edhe bashkëvendas tjerë ta marrin këtë rrugë. Më vonë fillon edhe Zvicra të jetë vend i preferuar për punë sezonale. Shumica që e zgjedhën këtë rrugë për ta siguruar ekzistencën, ishin punëtorë krahu, të cilët me kohë kualifikohen edhe si mjeshtër të mirë në fushën e ndërtimtarisë.

Këtyre njerëzve nuk u interesonte shumë mënyra e të jetuarit në vendet ku punonin dhe kishin njohuri të kufizuara për vendet e huaja. Pushimet i kalonin në vendlindje, duke punuar në përmirësimin e standardit të jetesës. Gruaja dhe fëmijët jetonin në vendlindje. Shumë fëmijë janë rritur për një kohë të gjatë pa babain e tyre, kurse nëna për ta ishte bërë njëkohësisht edhe “babë” edhe nënë.



*Mërgimtarët e
Stubllës në mërgim
(Çekoslovakia,
vitet 70-ta)*

Prindërit fillojnë të tregojnë në vendlindje për “bukuritë” e perëndimit. Ngritja e mirëqenies së tyre bëhet edhe arsye shtesë për ta zgjuar interesimin e rrethit për emigrim. Keqësimi i situatës në ish-Jugosllavi e shtyri edhe rininë të shijojë “bukuritë” e perëndimit. Vendlindja bëhet vend rreziku. Interesimi për ta braktisur vendlindjen, për t’iu bashkangjitur babës, gruas, të fejuarës, merr një kahje krejt të re që kalon në “privilegi” dhe dëshirë jete.

Kriza ekonomiko-politike dhe shpërthimi i luftërave në territorin e ish-Jugosllavisë ndikuan që numri i të mëgruarve të rritej me shpejtësi të madhe. Vendosja në vendet e reja ishte e përcjellur me sfida të reja dhe të paparamendueshme, si për prindërit, po ashtue dhe për fëmijët e familjarët e të tjerët, të cilët kishin pasur parafytyrime krejt ndryshe për “botën e re”.

3. SHKAQET DHE ARSYET E MËRGIMIT

Siç e pamë, motivet për emigrim që e shtyjnë njeriun të largohet nga vendlindja e vet, janë të ndryshme. Me këtë rast mund të bëjmë dallimin e dy llojeve të mërgimit, forma që bazohen në dëshirë dhe në nevojë të personit për të kontribuar në përmirësimin e situatës individuale dhe familjare, kurse forma e dytë është ajo e detyrueshmja, ku njeriu është i kërcënuar e i rrezikuar personalisht dhe familjarisht nga varfëria dhe nga shkaqet politiko-shoqërore në Kosovë dhe më gjerë.

Kurse më vonë, pra, viteve të 90-ta situata politike ndryshon dhe përkeqësohet rrënjësisht për shoqërinë kosovare, duke shkaktuar gati një “exodus” në heshtje drej vendeve perëndimore. Punëtorët që jetonin jashtë pa familje, vendosën që t’i merrnin tërë familjet e tyre me vete, për shkaqe të pasigurisë dhe të rrezikut. Shumica e të rinjve dëshironin të “iknin” nga vendi, sepse nuk shihnin më ardhmëri të mirë në vendin e vet. Për atë që kishite babanë jashtë, nuk paraqiste ndonjë problem, porse për ata që nuk kishin askënd jashtë, filluan makinacionet e ndryshme, si fejesat dhe martesat për interes, për vizë, ikja dhe largimi “i paligjshëm”, kuptohet, duke u ballafaquar me rreziqe të llojllojshme.

Sipas statistikave, më shumë se 50% të banorëve të fshatit të Stubllës e kanë lëshuar vendin e tyre dhe jetojnë diku jashtë. Pjesa më e madhe e tyre sot jetojnë dhe veprojnë në Zvicër, Itali, Gjermani, Austri, Kroaci, kurse një numër i vogël edhe në SHBA, Slloveni, Kanada, Francë e Australi.

Ngushtimi i perspektivës së rinisë dhe presioni që bëhej nga regjimi i instaluar serb në Kosovë, i shtynë një numër të madh të rinisë së Stubllës ta lëshojnë vendlindjen duke shpresuar për një jetë më të mirë. Rinia synonte

gjithnjë e më shumë mërgimin. Shumë prej tyre i ndërprejnë studimet dhe përfunduan në vende të ndryshme të Evropës, perspektiva e të cilëve ishte e hapur dhe e panjohur.

4. VEPRIMTARIA E MËRGIMTARËVE TË STUBLLËS SË EPËRME

Përkundër sfidave të kohës dhe fatit të të detyruarve për të mërguar, stubllasit shpejt u përpoqën që edhe në këto vende të integrohen dhe ta ndërtojnë ardhmërinë e tyre. Pa dyshim, fillimi ishte shumë i vështirë. Integrimi i gjeneratave të para të mërgimtarëve ka qenë jo i mjaftueshëm. Arsyeja kryesore qëndronte në faktin se ata kishin mërguar gjithnjë me shpresën se sa më shpejt do të ktheheshin, pa menduar fare për integrim në shoqëritë e reja.

Në mërgim stubllasit kanë qenë të detyruar, ashtu si edhe shqiptarët tjerë, të mendonin për një riorganizim të ri të dinamikës së jetës familjare dhe të punës, sidomos për të mirën e fëmijëve dhe të të rinjve, të mendonin për edukimin e tyre, të bënin përpjekje për afrim drejt normave dhe vlerave sipas atyre të vendit përkatës, të ri, aty ku tashmë jetonin, sidomos në raport me fëmijët edukatën e tyre.



*Mërgimtarë të
Stubllës në Lecco.
Takimet e Don
Mikelit 2004*

Edhe vështirësitë tjera, siç është njohja e mangët e kulturave të këtyre vendbanimeve të reja, ka ndikuar që jeta të jetë edhe më e vështirë. Fëmijët që e kishin ndërprerë shkollimin, duhej të sistemoheshin në këto vende perëndimore. Ata shumë shpejt e mësojnë gjuhën dhe iu përshtatën ambientit ku prindërit e tyre jetonin më parë. Kjo përshtatje tashmë kishte një rol të dyfishtë, urëlidhës mes familjes shqiptare dhe të huajve, nga njëra anë, si dhe “përkthyes” apo ndërmjetësues për njohjen dhe pranimin e kulturës dhe të qytetërimit perëndimor, nga ana tjetër.

Me rritjen e gjeneratave të reja integrimi i tyre në këto shoqëri, e ka lehtësuar jetën e tyre, mirëpo duke mos e harruar për asnjë çast vendlindjen. Kjo dëshmohet me vizitat e tyre të shumta në vendlindje, si dhe me anën e fejesave, martesave, festimeve të ndryshme, apo me anë të pushime verore në Stubëll. Në format tradicionale të organizimit familjar në emigracion, tashmë vërehen ndryshimet sociale. Këto ndryshime dallojnë nga tradicionalja, megjithëse nën vetëdije prindërit janë ende nën ndikimin e të kaluarës dhe të edukimit patriarkal.

Gjeneratat e reja që kanë kaluar nëpër këto vende, megjithë mundin edhe sfidat e mëdha me të cilat përballlohen, ia dalin që të sistemohen dhe ta ndërtojnë ardhmërinë e tyre, duke kryer zanate apo zeje dhe duke u aftësuar profesionalisht në lëmi tjera. Disa prej tyre ia dalin të depërtojnë edhe në universitete të ndryshme evropiane dhe kanë kanë siguruar punë të rëndësishme në institucione evropiane.

5. MËRGATA E STUBLLËS DHE KONTRIBUTI I SAJ PËR LIRINË E KOSOVËN

Ashtu si gjithë mërgata shqiptare e Kosovës, edhe të mërguarit stubllas kanë dhënë një kontribut të madh për Kosovën. Ky kontribut është bërë në kahje dhe në fusha të ndryshme. Kontributet e tyre shtrihen, në radhë të parë, në sigurimin e mirëqenies së vetë fshatit Stubëll. Këtu duhet të cekim, se infrastruktura kryesore në fshat është realizuar falë kontributit kryesor të dhënë nga mërgimtarët. Mandej ky kontribut shtrihet deri te aksionet e ndryshme në përkrahje të Kosovës dhe popullatës së saj, si financiare, ashtu edhe politike.

Me shpërthimin e luftës në Kosovë, mërgata stubllase ka derdhur shumta të mëdha të hollash për Kosovën. Aktivitetet e stubllasve nuk ishin të kufizuara vetëm në ndihmën që organizoheshin në kuadër të Kosovës, por edhe nëpër forma dhe mënyra të ndryshme, të shoqatave dhe të organizmave të tjerë dhe në kuadër të Misioneve Katolike Shqiptare në Perëndim, si dhe në kuadër të institucioneve tjera joshqiptare.

Solidariteti, humanizmi, patriotizmi i vërtetë i mërgatës së Stubllës, është dëshmuar gjithnjë. Bashkëpunimi dhe aftësia e vënies së kontakteve për sensibilizimin e çështjes së Kosovës me organet të ndryshme të shteteve ku ata punojnë, janë një dëshmi tjetër që e ngrit rolin e tyre dhe dëshirën për liri dhe atdhe. Kontribut të veçantë kanë dhënë dhe japin studentët tanë në botën e jashtme.

6. MËRGATA E STUBLLËS SOT

Ishte një kohë euforike, kur mendohej që mërgata stubllase dëshironte të kthehet në Kosovë pas përfundimit të luftës. Sot e vërejmë se ajo eufori ishte vetëm një iluzion, një dëshirë e paralizuar. Pasiguria, papunësia, mungesa e ligjeve, moszgjidhja e statusit përfundimtar të Kosovës, i ka frikësuar dhe gati i ka pamundësuar dhe mëtutje mërgimtarët që të marrin hapa për kthim në vendlindje, duke i mbajtur “peng”, në ankth dhe në ethe, në gjendjen as andej as këndeje, si dhe me krijimin e gjendjes konfliktuale në brendi.

*Mërgimtarët
e Stubllës në
Gjermani. Takime
familjare.*



Që dashuria ndaj vendlindjes të mos humbet dhe që mërgata e Stubllës të mos “shkëputet” përfundimisht nga vendlindja; ata kanë gjetur formën e tyre të organizimit në kuadër të Shoqatave integruese, humanitare e kulturore në Zvicër, Itali Gjermani, në kuadër të së cilave shoqata kanë hapur edhe fondin për ta ndihmuar vendlindjen dhe vetveten. Afrimi i mërgatës rreth Misioneve Katolike Shqiptare, rreth shoqatave dhe fondit, pos të tjerash, ka për qëllim ta mbajë të zgjuar dashurinë për atdheun, për vendlindjen e tyre, dhe ka një rëndësi dhe rol të madh në histori. Edhe aktivitetet tjera sportive-kulturore janë një element tjetër për takime, afrime, bashkime dhe bashkëpunime të mërgatës.

Për t`iu dhënë atyre ndjenjën e afërsisë dhe të përkatësisë së përbashkët, tani kur mundësitë teknike janë zhvilluar aq shumë, mërgata komunikon përmes masmediave elektronike (internetit). E kjo ka bërë që ata gjithnjë të jenë të informuar dhe të bashkuar .

Brezi i dytë i mërgimtarëve tanë tashmë janë shndërruar në një “simbiozë” shqiptaro-evropiane, më lehtë flasin gjuhët e huaja se gjuhën amtare, shqipe, dhe nga ky “dualizëm” mund të ketë mjaft elemente pozitive, por edhe negative.

E ardhmja do të dëshmojë sa jemi të aftë të jemi vetvetja, shqiptarë katolikë, por edhe sa dimë t`i marrim të mirat e të tjerëve, për një shoqëri të re në formim.



ISBN 9951-8660-0-X